

BIBLIOTEKA

814-32

N178

Bardhyl
Minxhozi

**NJE
LODER
PER
TE
RRITUR**

tregime

8JH-32
N178

BARDHYL MINXHOZI

NJË LODËR PËR TË RRITUR

Tregime



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

LENTET

Pastruesja e katit nuk mund ta kuptonte kurssesi përbajtjen e vërtetë të atyre letrave që gjeti në dhomën numër 18. Megjithkëtë, ajo e ndjeu se diçka jo e zakonshme fshihej në ata rrreshta. E pashë këtë në vështrimin ngulmues të saj, që sikur më thoshte: «Ja ç'na bëri ai mikut i ngushtë»... Po, mua më takonte ta mbaja atë shikim hetues e njëherit edhe kritik.

Ai kishte ardhur tek unë si gjithë bujtësit e tjerë. Mbante në duar dy valixhe të mëdha dhe në çast pata menduar se mos qe emëruar në ndonjë punë në qytetin tonë. Po qeshë gabuar. E nuk isha vetëm unë. Edhe të tjerë, apo e kishin parë të zbriste nga autobusi, e kishin emëruar në disa punëra. Dikush e kishte marrë për regjisoren e estradës, një tjetër për drejtor të komunales, një

tjetër trajnér të skuadrës së futbollit etj. etj. Si gjithmonë, unë kam privilegjin t'u jap fund i pari hamendjeve. Meqë jam sportelist në hotel, duan s'duan, të sapoardhurit janë të detyruar të regjistrohen e të tregojnë qendrën e punës, datëlindjen, vendlindjen etj.

Sidoqoftë, më bëri disi përshtypje kur, pasi më përshëndeti me mirësjellje, i sapoardhuri m'u lut t'i gjeja një dhomë të mirë, sepse do të qëndronte në qytetin tonë plot katërmëdhjetë ditë. E kuptoi habinë time dhe nxitoi të më sqaronte:

— Kam ardhur me leje të zakonshme. Dua të qetësohem. Këtë vit kam qenë i mbytur deri në fyt me punë. Vendosa t'i kaloj pushimet në një qytet të panjohur për mua dhe të largët. Thonë se largësia e madhe dhe e panjohura janë, deri në njëfarë mase, çlodhëse për të mbilodhurit. Për më tepër më kanë folur mirë për qytetin tuaj. Agroni, Agron Çanga më ka folur. Duhet ta njihni. Më duket se këtu ka lindur; ka kryer edhe shkollën 8-vjeçare.

— Po, me Agronin kemi qenë shokë fëmijërie, shokë shkolle, — i thashë unë. Pas këtij po himi ai u bë më i afërt me mua. Ndodh rëndom që njerëz të panjohur të afrohen nga një i njobur i përbashkët, madje me mua kjo ndodh shpesh, aq, sa një shoku im këtë e ka shpallur si sëmundjen time kryesore profesionale.

Nuk e mbaj mend se çfarë i thashë atë ditë ose dhe ndonjë ditë tjetër për shokun tim Agronin dhe qytetin tonë. Po që i kam folur mirë, për

këtë s'kam dyshim, se Agronin e kam të dashur, edhe qytetin po ashtu. Mirëpo, nga këto kopje let-rash që u gjendën në dhomën e tij, e shikoj se pas-kam bërë gabim të madh. Duhet të isha treguar më i mençur, të mos i hapesha pa e njohur atij, të cilit Tahsimi, kryekamerieri i vuri nofkën «leja e zakonshme». Këtë nofkë e mësuan të gjithë kli-entët e kafenesë, sepse, në të vërtetë, njerëzit u habitën disi me një tip të tillë, që vjen e kalon lejen e zakonshme në një qytet të largët, pa asnje të njohur, pa pasur asnje të afërm. Të kupto hemi, jo se qyteti ynë s'është tërheqës, por... Nuk është as pikë klimatike.

Megjithatë ai dukej se tregonte interes për të njohur qytetin. Takonte njerëz të ndryshëm, bisedonte me ta orë të tëra, ama edhe në dhomë mbyllej shpesh. Një ditë e prita dy orë, ndonëse vetë më kërkoi të shkonim në muzeun e qytetit. Siç më tha më pas, e kishte zënë gjumi. Më pas ka gënjer. Po, po, tanë e kuptoj se ai nuk ka fjetur asnje orë gjumë në qytetin tonë. Këto letra mjaftojnë për t'u bindur se ai, paskësh ardhur në qytetin tonë për shokun tim, Agronin. Për të shkruar të gjitha këto, mua do të më duheshin le-jet e pesëmbëdhjetë vjetve. Megjithatë nuk duhet lënë kjo punë kështu. Duhen vënë gjérat në vend, dhe, i frymëzuar nga një qëllim i madh, ni-sa të shkruaja.

Shoku drejtor i GTV-së,

Është hera e parë, pas përfundimit të shërbii-

mit ushtarak, që po shkruaj një letër. Por u detyrova nga një ngjarje e shëmtuar e punonjësit tuaj, që quhet Saimir Xhevi, ose, siç e thirrëm ne këtu, «leja e zakonshme». Ai paska qenë një njeri, jo, ose s'duhet të jetë njeri... .

Jo, nuk është gjë kështu. S'ia thënksam dot. Po më dalin fjalët e gruas. Ajo thotë se unë di të shkruaj vetëm emra, data e profesione. Njeriu u dashka të ushtrohet edhe për të shkruar letra. Se ja, vjen një ditë dhe të takon të ndeshesh me një-rëz si «leja e zakonshme». Se i ka shkruar bukur, dreqi, letrat e tij, bile me fjalët e mia. Nuk e di njeriu se ku e ka të mirën. Vjen tjetri nga ana e anës, e bën shok, i jep nja dy-tri kafe, të pyet ashtu kot; dhe ulet i shkruan historitë e tua sikur. të ishin të Napoleon Bonapartit. Nailja, pastruesja e katit, edhe po t'i ketë lexuar letrat e «lejes», nuk do t'i ketë shkuar ndër mend se ajo që shkruhet... ishte një ditë e bukur me diell, kur Agron Çanga, së bashku me një shokun e tij të ngushtë, futën në orën e mësimit një qen të tërbuar. Qëllimi ishte për të trembur mësuesen e muzikës, e cila i kishte shumë frikë qentë në përgjithësi, pale ata me shenja tërbimi. Agron Çanga ishte organizatori kryesor në këtë veprim të shëmtuar, që solli pasoja të dhimbshme për të ardhmen e mësueses, e cila edhe sot e kësaj dite ndodhet në një gjendje të pashërueshme psikike, duke shfaqur shenja alergjie ndaj të gjitha kafshëve me katër këmbë etj. etj. . është një gënjeshtër me brirë.

Unë nuk ia tregova kështu atij. Lëre pastaj që në qytetin tonë nuk mbahet mend të jetë tërbuar ndonjë qen, të paktën këto 25 vitet e fundit. Hej, bela, një kone e vogël ishte ajo që unë me Agro-nin e futëm në oborrin e shkollës. Kones akoma nuk i kishin dalë dhëmbët. Për këtë arsyë, qeni vetëm sa lehu nja pesë-gjashtë herë ashtu kot, si qen që qe, po mësuesja e muzikës, e pamësuar me kafshë të këtij lloji, u frikësua e mendoi se mos e kishin mësuar qenin për të sulmuar atë. Ishte kjo arsyjeja që na çoi në drejtori, ku na i zgjatën pak veshët me dashamirësi, me qëllim që të mos e përsëritnim më këtë «gabim pedagogjik», siç e përcaktoi drejtori ynë i shkollës. Me një fjalë, kjo është historia e qenit, për të cilin nuk e kuptoj përsë duhet njoftuar tani, pas një çerek shekulli, një zyrë kuadri.

Nejse, ai e bëri të vetën. Tani më takon mua të bëj timen. Duhet filluar edhe një herë nga e para:

Shoku drejtor i GTV-së,

*Nuk mbahet mend qëkurse e kam shkruar let-
rën e fundit, pra, duhet ta kuptoni se një problem
shumë i madh dhe i rëndësishëm më ka shtyrë
për t'ju nisur këtë letër. Punoj si sportelist në
hotel «Mimoza». Po, do të thoni ju, shoku drejtor,
cili është ky problem i rëndësishëm? Punonjësi
juaj, Saimir Xhevi, gjatë qëndrimit në hotelin
tonë ka kryer shumë veprime të shëmtuara. Për-
veç dy peshqirëve e dy sapunëve ai ka përvetë-*

suar, në dhomën nr. 18, katër jastekë, gjashtë batanie, tre dyshekë. Për këtë arsyе merrni masat e duhura...

Përsëri nuk më duket se ka dalë aq mirë. Natiqisht e kam të vështirë ta arrij «lejen e zakonshme», se atë e ndihmon edhe shkolla e madhe që ka bërë. Sikur të pushoj pak dhe të nis nga e para?! Jo, nuk duhet ndërprerë! Kjo punë kërkon vullnet e bindje të fortë, siç bëri ai, që këmbënguli katërmëbëdhjetë ditë me radhë. «Leja e zakonshme» kishte fantazi, po dhe unë do ta gjej! Bile ma merr mendja se kjo lloj fantazie nuk duhet t'i mungojë asnjë njeriu që di shkrim e këndim, mjafton që të njihet me letrat e «lejes së zakonshme».

.... Mësuesja e gjuhës hyri në klasë me regjistrin në dorë, por asnjeri nga nxënësit nuk lëvizi nga vendi. Ata kishin ulur kokat mbi banka. U foli me zë të lartë që të ngriheshin në këmbë. Përsëri asnjeri prej tyre nuk lëvizi. Kur e pa kështu, ajo përplasi njëherë fort takat e larta të këpucëve në dysheme duke turfulluar e drejt e në drejtori. Pas disa minutash në klasë erdhi drejtori, që njihej si njeri me autoritet. Edhe ai u foli nxënësve me zë të lartë, por edhe këtë herë nxënësit vazhduan të qëndronin si më parë, të ngurtësuar. Pas kësaj, drejtori dha urdhër që të thirreshin të gjithë prindërit në shkollë dhe të bëhej një mbledhje e zgjeruar urgjente e këshillit pe-

dagogjik. Ndërkohë në shkollë ishte marrë vesh lajmi se ç'po ndodhte në klasën e V-c. Njëri nga nxënësit e një klase tjeter guxoi të futej në klasë dhe të prekte njërin nga ata të klasës V-c. Ai u tmerrua kur pa që koka e tij nuk lëvizi fare. Doli me vrap nga klasa duke bërtitur: «E gjithë klasa V-c ka vdekur, klasa V-c ka vdekur!»

Kaç u desh që në gjithë qytetin të krijohej një alarm i vërtetë. Prindërit ndërkaq ishin njof-tuar dhe morën vesh lajmin e kobshëm gjatë rrugës për në shkollë. Nuk vonuan dhe aty ua mbërritën autoambulancat me sirenat e tyre të mprehta të alarmit. Tërë qyteti u ngrit në këmbë. Disa thanë se kishte rënë zjarr në shkollë. U panë të vraponin andej njerëz me kova e legenë në duar. Të tjerët, me kazma e lopata. Braktisën njerëzit punën. Mendoni ç'dëm ekonomik u shkaktua. Siç u mor vesh më vonë, të gjithë këtë zallamahi e kishte bërë Agron Çanga, i biri i farmacistit të qytetit. Ai, në një nga pushimet e orëve të mësimit, kur nxënësit po hanin mëngjesin, u tha shokëve të tij: «Kalamaj, kush do të hajë karamele të bardha?» Fëmijët e paditur nxituan, kush e kush të provonte karamelet e bardha, që nuk ishin tjeter, veç medikamente që të vinin në gjumë... Vetëm pas 13 orësh fëmijët u zgjuan nga ai gjumë tronditës dhe së bashku me ta dhe autori Agron Çanga. Ishte ky fakt që dhe vetë ai e kish përdorur ilaçin e gjumit, që e shpëtoi Agron Çangën nga përjashtimi përgjithmonë nga shkolla. Drejtoria e shkollës u mjaftua me një vërejtje të rëndë, ndër-

sa tē atit iu dha paralajmērim pēr pushim nga pu-na nga pērgjegjësi i farmacisë. Po braktisja ma-sive e punës bëri që plani i rrethit atë muaj tē mos realizohej. Është dhe kjo ndodhi që flet pēr një tē kaluar tē dyshimitë tē Agron Çangës, pēr shpirtin aventuresk tē tij, prandaj...

Më bukur s'ka si tē shkruhet kjo histori! E si ta kuuptojnë tē tjerët, kur edhe Nailja, pastrues-ja e hotelit, djali i së cilës ka qenë një nga ata që dremitën në klasë dhe që u ngritën pas dhjetë mi-nutash më ujë tē ftohtë, kishte vënë alarmin kur e lexi... Çudi e madhe! Nga dhjetë minuta gjumë, në 13 orë! Shto pastaj zjarrin, kovat, legenët, maledhjen urgjente tē këshillit pedagogjik, auto-ambulancat, mosrealizimin e planit si rreth etj... Tani e them me plot gojën se duhet shkruar një letër më e fortë pēr «lejen». Duhet shkruar pa-tjetër ndryshe, një letër më tronditëse:

Shokut drejtor tē GTV-së,

Unë që po ju shkruaj këtë letër jam i pari në fisin tim, që nga fillimi i shekullit e këtej, që po gatitem tē merrem me një problem tē një rëndësie tē madhe. Puna ime, si sportelist i parë në hotelin me emrin e bukur «Mimoza», më ka bërë shumë tē njohur, në tē gjitha anët e vendit.

Para disa kohësh, kur erdha në mëngjes në punë, më thanë se në dhomën nr. 18 ka hyrë një njeri që kishte ardhur ta kalonte lejen e zakon-shme te ne, në hotelin tonë. Ishte hera e parë që ndadhte një gjë e tillë. Bashkë me përgjegjësin

e hotelit e ndiem për detyrë ta «mirëseardhnik» zyrtarisht, ndaj shkuam e trokitëm për disa minuta në derën e asaj dhome, por i panjohuri nuk u bë i gjallë. Kjo na e shtoi shqetësimin. Kushedi si qe puna! Mos kishte vdekur nga ndonjë infarkt i papritur? Mos kish vrarë veten? Mos ish futur brenda për të kryer ndonjë veprim të lig? Ku s'na shkonte mendja. Sidoqoftë, thamë që gjëja më e mirë qe të lajmëronim policinë. Por, me sa duket, i ardhuri na kishte dëgjuar, se ende pa zbritur ne në fund të shkallëve na zuri për krahësh. Llafi i parë që i drejtoi përgjegjësi ishte: «Pse nuk e hape derën?» I ardhuri, duke mbledhur supet, me një pamje që të këpuste shpirtin, tha se nuk kishte dëgjuar, pasi po flinte. Dukej haptazi se po gënjente. Megjithëkëtë përgjegjësi ynë, që është tej mase zemërgjerë, edhe unë e besuam, madje ndiem në vetvete edhe një lloj kënaqësie të panjohur më parë. Një njeri nga një qytet tjetër kishte preferuar qytetin tonë për të kaluar pushimet! Kjo s'është pak. Ndaj dhe u përpoqëm ta mbajmë në pëllëmbë të dorës, gjatë katërmbe-dhjetëditëshit të qëndrimit. Po, me dhimbje e them, se tani, pas largimit të tij, në qytet tregohen gjëra të përbindshme për të që, fatkeqësisht, janë të vërteta. Ai kishte qenë gjarpër i vërtetë. Siç tregon punonjësja jonë, Naile Shkreta, personi në fjalë i ka propozuar për martesë, megjithëse ajo për dy vjet del në pension. Veç kësaj nga inventari që u bë, në praninë e një komisioni të posaçëm, doli se në dhomën e tij mungojnë: 1) Pasqy-

ra me kornizën e nikeluar. 2) Tavolina dhe dy karriget. 3) Krevati bashkë me sustën me tela çeliku special, 4) Dyshekë copë dy (2), 5) Batanije copë 6 (gjashtë) 6) lavamani me gjithë rubinet, 7) 22 (njëzet e dy) metra tub instalime hidrosantare, 8) muri në të djathtë bashkë me gjysmën e tavanit.

Ndaj po ju lajmërojmë, që, në bazë të rregullave në fuqi, të merrni masat e duhura ndaj punonjësit tuaj Saimir Xhevi për të mirën tonë të përgjithshme.

Me respekt, Demir Guri, sportelist i parë në hotel «Mimoza».

Më duket se nuk është keq. Çdo drejtor i botës do të ngrihej i alarmuar nga karrigia, kur të lexonte kështu për vartësin e vet. Pastaj mund të dyshonte te letra, sepse letërshkruesi ishte i panjohur për të e i trishtuar mund të ulej përsëri në karrige. Megjithatë sportelisti ndihej i lehtesar për vete, bile ndiente kënaqësi. «Do t'ia lexoj edhe gruas dhe jam i bindur që ajo do të mbetet gojëhapur dhe me siguri nuk do ta zërë gjumi nga gëzimi që burri i saj, më në fund, u bë aq i zotil sa të shkruajë një letër kaq tronditëse.» Pastaj përfytyroi lëvizjet. Se do të niste ai drejtori patjetër njerëz për të vërtetuar thëniet e Saimir Xhevít dhe letrën e sportelistit. «Po le t'i nisë. Nuk do të humbasin gjë. Do të njihen me të vjetrat e të rejat e qytetit tonë. Gjithashtu do të njihen dhe me mua», i dha karar me mendje sportelisti tepër i qetë.

DITËT E VRAPIMEVE TË MIA NË NATYRË

Autobusi urban qëndroi te stacioni pranë shtëpisë sime. Po të vrapoja pak, mund ta arrija, por unë nuk nxitoj dot e jo më të vrapoj. Një grua, bile aspak e hollë, me një lloj vrapimi të lehtë e arriti autobusin. Nuk e di ç'ndien ajo në ato çaste, mbasse mérzi që u detyrua të vraponte. Ndërsa mua, për shkak të saj, më kaploi një trishtim, një si zili.

Arrita te stacioni. Ai ishte i shkretë. Autobusi i kishte marrë të gjithë me vete. Kjo më bënte edhe më të mérzitur. Nuk kisha ndonjë punë me ngut. Po sidoqoftë të vjen inat kur të lë autobusi për hiçmosgjë, kur shikon që e arrijnë të gjitha moshat, edhe ajo grua aspak e hollë, e cila, me siguri, gjatë gjithë jetës së vet ka vrapuar v-

tëm për të kapur autobusin. Ndërsa unë, që njëherë e një kohë i jam përkushtuar vrapimit me një seriozitet të pasembullt, sot nuk mund të vrapoj. Autobusët sikur tallen me mua. Njerëzit nga xhamat e tyre sikur më shohin pothuaj me krenari. Po në djall të shkojë vrapimi. Do të vijë autobusi tjetër dhe unë do të hip i qetë «Le të vrapojë ai për mua», u përpoqa të qetësoja vreten, po s'qe e lehtë. Me sa duket heqja e së drejtës për të vrapuar nuk është aq e thjeshtë, sidomos kur ajo bëhet kundër dëshirës sate. U bënë katërmëdhjetë muaj, që unë nuk vrapoj. Jo për arsyeshëndetësore. Kjo përbën dramën time. Plot pesëmbëdhjetë muaj më parë lexova në një revistë shkencore një artikull për vrapimet në natyrë si një element i rëndësishëm për jetën. Po të mos e kisha lexuar artikullin, me siguri që nuk do të isha në këtë stacion. Po ja që e lexova. Me sa duket etja për t'u kulturuar nuk sjell gjithmonë dobi.

I kam gjithmonë të freskëta ditët e mia të vrapimeve në natyrë. Pothuaj një herë në dy net shikoja ëndrra të këndshme e njëkohësisht të çuditshme. Një herë, bile, u gdhiva kampion olimpik në garën e 100 metrave. Sidoqoftë, kur kthehesha nga krosi i mëngjesit, ndihesha i lehtë e i fuqishëm. Po këto, ditë të lumtura vazhduan shumë pak. Vetëm pesëmbëdhjetë ditë. Aty nga dita e tretë, tek po kthehesha nga parku pranë shtëpisë sime, (ku zhvilloja krosin), u gjenda përbalë me një komshiun tim. U përshëndetëm si za-

konisht. Pas kësaj ai më pyeti se nga po veja kështu me këtë lloj veshjeje, (pyeste për kostumin sportiv, që e kisha blerë enkas për të vrapuar). Unë iu përgjigja se kisha dalë për një kros të lehtë në park, dhe nxitova për në shtëpi. Po më bëri përshtypje ftyra e tjetrit, që shprehte habi. Dhe më erdhi keq që ai nuk e kishte lexuar artikullin për vrapimet në natyrë.

E njëjta skenë u përsërit edhe pas dy ditësh. Madje m'u duk se komshiu këtë radhë kishte dalë pikërisht për mua. Dhe ditën e shtatë të vrapimeve të mia në natyrë u shfaqën pengesat reale. Gruaja, me një shqetësim të vecantë, më kërkoi që të mos vrapoja më, sepse në pallat flitej se unë isha shumë i sëmurë dhe se, përveç të tjerave, mjeku më paskej këshilluar të bëja çdo mëngjes shëtitje në ajër të pastër për të qetësuar nervat. Ndërsa të tjerë thoshin se unë isha ndarë më time shoqe e nuk haja më në shtëpi. Çdo mëngjes shkoja për një «kos të lehtë» në restorantin pranë parkut. Drekën e haja në miensën e ndërmarrjes dhe për darkë pija vetëm një kafe në klubin e gjuetarëve. Kostumi im sportiv ishte një maskë për të fshehur grindjet tona familjare. Pra, përfundoi bashkëshortja ime, nuk kemi ndër mend të bëhem gazi i botës dhe të na mbetet vajza dyvjeçare e pamartuar për shkak të vrapimeve të tua në natyrë, që nuk kanë asnje vlerë.

Unë natyrisht ë kundërshtova duke thënë se nuk më interesonin këto shpisje dhe i shpjegova efektin e vrapimeve të rregullta në natyrë. Ato të

bëjnë të fuqishëm, të rritin shkathtësinë, të zgjatin jetën. Por ajo vazhdoi me të vetën, bile tha se «qysh se ke filluar të vraposh jo vetëm nuk je bërë më i shkathët, po je dembelosur aq, sa nuk blen më asgjë në dyqan. Pastaj, shtoi ajo, ti e di shumë mirë se tre xhaxhallarët e mi, që i kanë kaluar të shtatëdhjetat, janë shumë mirë me shëndet, pa vrapuar as dhe një centimetër gjatë gjithë jetës së tyre. Së fundi, po të ishte vërtet ashtu siç thua ti, atëherë përse njerëzit nëpër rrugë ecin normalisht dhe nuk vrapojnë?»

Ky argument më habiti pa masë. Nuk ma kishte marrë mendja kurrë që gruaja ime mund të arrinte në përgjithësimë të tilla. Për një çast mbylla sytë dhe u përpoqa të përfytyroja njerëzit e qytetit tonë duke vrapuar gjatë gjithë ditës nëpër rrugë, nëpër ndërmarrje, nëpër korridore, nëpër dhomat e shtëpive të tyre. I dhashë krahë mendimit dhe guxova të përfytyroja gjithnjë njerëzit e botës duke vrapuar. Me siguri që atletika si sport nuk do të ekzistonte. Mbase do të kishte një sport të një lloji tjetër, ku do të shquheshin ata që ecnin më ngadalë ose që do të zvarriteshin.

Vërtet, kur vrapimi ka aq të mira, me siguri që diku në galaktikat e tjera duhet të ketë patjetër një planet ku qenie të arsyeshme gjatë gjithë kohës vetëm vrapojnë. Nuk e mbajta, por ia thashë këtë hipotezë gruas dhe ajo, siç ishte, në këmbë, kërkoi një karrige dhe u ul e dërrmuar sikur kishte bërë garën e maratonës. Në çast përfytyrova edhe gruan duke vrapuar dhe nuk munda

ta mbaja të qeshurën. Gruaja u tremb dhe filloj nga pyetjet:

— Çfarë lidhje ka vrapimi, avantazhet e tij, me ekzistencën e disa qenieve të arsyeshme të një planeti tjetër? Pra, si arrite ti në përfundimin se përveç tokës ka dhe një planet tjetër, ku ka jetë dhe ku qeniet e arsyeshme në ndryshim me ato të tokës, që vrapojnë vetëm në disa raste, vrapojnë gjatë gjithë kohës?

— Nuk e thashë një gjë të tillë. Ti po i deformon fjalët e mia.

— Kush? Unë?

— Po, ti.

— Mirë atëherë, t'i marrim me radhë të gjitha fjalët. A the që më siguri në një galaktikë tjetër duhet të jetë një planet ku ka jetë?

— Po.

— Që atje janë disa qenie të arsyeshme që vrapojnë gjatë gjithë kohës.

— Po.

— Atëherë çfarë kam deformuar e harruar në fjalët që vetë the me gojën tënde?

— Ke harruar të thuash se qeniet e arsyeshme në planetin imagjinar vrapojnë gjatë gjithë kohës, sepse ato nuk janë të martuara!

— E di që të kanë bërë të mençur këto vrapimet!

— Natyrisht, këtë e kanë thënë shumë shekuj para teje grekët e vjetër.

Më pas, nën një heshtje të nderë, i lashë gruas në duar faqet me artikullin të hequra nga

revista. Kisha shumë shpresë që ajo të bindej **se** unë isha në rrugë të drejtë. Ajo e lexoi artiku-llin shumë e përqendruar dhe, pa ngritur kokën, tha me një zë të drobitur:

— Pse, kujton ti se unë nuk i besoj **shken-**cës?

— Nuk e kam vënë këtë asnjeherë në dyshim, — iu përgjigja disi me optimizëm se diçka **po** ndryshonte.

— Por e keqja është se tani, pas leximit **të** këtij artikulli interesant, po dyshoj jashtëzako-nisht për ty, — tha gruaja duke bërë me **gisht** nga unë.

— Për mua? — fola unë si i zënë në faj.

— Po. Pikërisht për ty. Dua të të pyes: përse nuk më ke thënë asnjeherë që të vrapojmë **së** bashku?

— Nuk e kam ditur se edhe ty të pëlqen **të** vraposh, ti i ke urryer vrapimet gjithmonë, — **u** përpoqa të mbrohesha duke menduar pasojet **e** mundshme të një krosi familjar.

— Po pse, unë nuk kam dëshirë që të më zgjatetjeta?

— Po mendova edhe për vajzën. Me kë do **të** rrijë, ajo nëse të dy do të vrapojmë çdo ditë?

— Po pse, ajo nuk ka dëshirë t'i shtohetjeta?

— Natyrisht që ka, — pohova duke **e** ndier se nuk kisha rrugëdalje tjetër.

— Po atëherë përse nuk ke këmbëngulur që të na merrje me vete në ato vrapimet e tua? Të na merrje me zor. Kupton, me zooor!

— Nuk po të kuptoj.

— Doemos nuk ke dëshirë që të më zgjatetjeta mua. Ti kërkon që të jetosh më gjatë se unë. Kjo është fare e qartë. Doemos, ëndërron të martohesh përsëri, me një gruà tjetër.

— Je në vete! Çfarë dërdëllis ashtu?

— Pse kërcen përpjetë, unë s'u mërzita kurti dërdëllisje për një planet ku ka njerëz, bile që vrapojnë diku në një galaktikë miliarda vjet drithë larg nesh.

Ishte e kotë të vazhdohej kjo bisedë, nga mëtë ashprat e jetës simë bashkëshortore. Megjithatë unë vazhdova të vrapoja disa mëngjese, ndonëse kur kthehesha në shtëpi më pritnin breshëri fjalësh, kritikash.

Një, dy, tri, katër ditë.

Gruaja s'ma varte më. Shpërfillja e saj zuri të më ngacmonte më shumë. Më dukej sikur gjithë qyteti e kishte marrë vesh veprimtarinë time sportive dhe grindjet me time shoqe. Vështrimet e njerëzvë më dukeshin sikur thoshin: ja, ky është ai vrapuesi i talentuár për moshat 33-40 vjeçë; ja, ky është ai që po ndahet nga e shoqja; ja, ky është ai që do t'i mbetet vajza pa martuar... Megjithëse pa entuziazmin e parë, vrapimet i vazhduva gjer në ditën kur një trajner atletike erdhi përtë më takuar në qendrën time të punës. Ishte hera e parë që e shihja. Po kjo nuk e pengoi atë të shfaqte konsideratën e tij për vullnetin tim në ushtrimin e vrapimeve në natyrë.

— Kur mora vesh veprimtarinë tënde të lav-

dërueshme, — vijoi ai, — të them të drejtën më erdhi keq. I bëra një kritikë të rreptë vetes: si nuk të kisha zbuluar më parë. Një atleti të vërtetë pikërisht kjo i duhet: vullneti dhe pasioni deri në sakrificë. Prandaj, duke u nisur nga të gjitha këto, të propozoj që të na bësh një bisedë me atletët e klubit tonë, sepse, ta themi midis nesh, kemi atletë që nuk i pëlqejnë vrapimet në natyrë...

Edhe kjo më duhej. Pastaj do t'u vinte ndoshta radha gazetave, radios, televizionit. Biseda me trajnerin e atletikës u vuri kapak vrapimeve të mia në natyrë e në rrugët e qytetit, bile dhe atyre për të kapur autobusin. Ja përsë tani ndodhem pikërisht bash në vendin ku do të hapet dera e autobusit që po vjen. Nuk dua as të shpejtoj hapat, nuk dua kurssesi të krijoj ndonjë keq-kuptim, se kam përsëri tendenca për të vrapuar.

NJË NGJARJE NË TREN

I gjithë vagoni numër 9 ishte i përgjumur nga rruga e gjatë dhe nga vapa kapitese. Kishte kohë që askush nuk fliste, e, në heshtje, priste me padurim mbërritjen. Konduktorja kaloi midis ndenjseve të vagonit duke u buzëqeshur udhëtarëve në mënyrë mekanike. Pikërisht pas ikjes së saj në vagon hyri një djalë, jo më shumë se tridhjetë vjeç, i veshur me shije. Ai eci midis ndenjseve duke parë disi me mospërfillje majtas e djathtas e pa i ardhur turp i shikonte njerëzit drejt e në sy. Udhëtarët, me syfë e përgjumur, ndoqën capitjen e tij. Papritur djali ndali te ndenjësja e parafundit, ku qenë ulur një grua e moshuar dhe një nuse e re. Ai me shumë mirësjellje u kërkoi një shishe kauçuku të bardhë, që qe mbi tryezën e vogël pranë dritares. Ato ia dhanë e djali me të në dorë u kthye dhe me hap të shpejtë eci nëpër vagon duke mos parë as majtas as djathtas. Një pjesë e udhëtarëve, megjithëse të përgjumur, e ndoqën disi të çuditur. Pas dhjetë minutash djali erdhi përsëri me shishen e bardhë në dorë dhe

shpejt u ndodh në ndenjësen e parafundit. Foli shumë pak me gruan e moshuar dhe u largua po me hap të nxituar. Kësaj here u duk qartë se ai djalë ishte vërtet i paraqitshëm dhe i veshur bukur. Trikoja golf bojëkafe u shkonte flokëve të tij gështenjë dhe e tregonte të ri. Kokat e përgjumura e përcollën djalin me triko golf me shikime të menduara dhe përsëri ranë nën ndikimin e përgjumjes kolektive, që shtohej nga lëkundja monotone e vagonit. Një burrë në ndenjësen numër 3, që gjatë gjithë kohës lexonte gazeten, (ku shedi për të satën herë), ngriti kokën dhe pa andej nga iku djali me triko golf. Pas pak, tha:

— Interesant.

Se çfarë donte të thoshte burri me atë fjalë nuk u mor vesh. Ai nuk dha asnje shpjegim tjetër dhe pas pak koka nisi t'i përkundej. Më vonë u dëgjua një grua, në ndenjësen numër 4, që po i thoshte një tjetre se atë djalin me triko golf diku e kishte parë, po se ku nuk i kujtohej. Kaq tha e pas disa çastesh dhe ajo uli kokën dhe nisi të flinte me shpresë se kështu treni do të arrinte më shpejt në stacion.

Nuk kaloi as gjysmë ore, kur në vagon hyri përsëri djali me triko golf. Ai eci shumë shpejt, pa kthyer kokën as majtas e as djathtas, me vështrimin në ndenjësen e parafundit. Disa prej udhëtarëve, që qenë zgjuar, nisën ta shikonin jo pa dyshim këtë djalë vërtet enigmatik. Djali mori përsëri shishen e bardhë prej kauçuku dhe bëri të dilte nga vagoni me të njëjtin nxitim, ashtu sikurse

hyri. Prania e tij sikur e gjallëroi vagonin. Ata që ishin zgjuar nisën të shikonin e të flisnin me njëri-tjetrin; ata që kishin dremitur u bënë esëll, mëdje dhë ata që ishin duke fjetur u zgjuan nga pëshpërimat e bashkudhëtarëve.

Më në fund djali me triko golf, me shishen në dorë, doli nga vagoni.

— Interesant, — tha përsëri burri që mbante gazetën.

— More, që e kam parë këtë njeri diku, kjo nuk ka diskutim, po se ku nuk më kujtohet, — foli sérish gruaja e ndenjëses numër 4. Tjetra përballë saj rrudhi buzët dhe tundte kokën shumë e çuditur. Pas pak tha shumë prerë:

— Me siguri që duhet të njihen qysh më parë, sepse nuk i shkohet tjetrit kaq serbes, apo jo?

— Po të njiheshin, — ndërhyri një burrë, — e nuk kishin përsë te ndaheshin nga njëri-tjetri.

— Të drejtë ka ky shoku, — u hodh një tjetër që sapo i kishte dalë gjumi, — po të njiheshin, nuk kishte pse ai djalë të vinte në vagon pas 5 orësh udhëtim.

— Unë them, — nisi të fliste një grua e moshuar, që shikonte gjatë gjithë kohës nga dritarja, megjithëse jashtë që errësirë e plotë, — se kjo puna e shishes është një sebep për të ardhur. Pastaj, mirë kishte nevojë për shishen një herë, po për së dyti pse erdhi?!

— Sa i guximshëm, xhanëm! Nuk i bën syri tërr nga gjithë këta njerëz! — tha një burrë një ndenjëse më tej. — E pashë unë që kur erdhi he-

rën e parë se ai djalë nuk vinte kotsëkoti në vagonin tonë. Një hall e kishte ai, — përfundoi ai, duke e hedhur vështrimin nga ndenjësja e parafundit, ku nusja e re kishte ulur kokën mbi duart dhe po flinte e qetë prej kohësh.

— Po t'i duhej patjetër një shishe e bardhë, përse erdhi pikërisht në vagonin tonë? Nuk ma merr mendja që i gjithë treni të ketë vetëm një shishe të tillë! — vazhdoi bisedën një tjetër, duke mbyllur sytë me nënkuptim. Po të gjitha bisedat u ndërprenë, sepse djali me triko golf hyri përsëri me shishen e bardhë prej kauçuku. Ai eci me hapa të shpejtë, seç bisedoi me gruan e moshuar dhe u largua duke përshëndetur lehtë me kokë. Nusja e re nuk e ngriti fare kokën. Megjithatë në ndenjëset numër 3 dhe 4 u pëshpërit se ajo nuk po flinte, po, për të mos rënë në sy, bënte sikur nuk i interesonte djali me triko golf. Pas pak dhe gruaja e moshuar uli kokën dhe nisi të flinte.

Treni vazhdonte të ecte me të njëjtin ritëm, po shumicës së udhëtarëve nuk u përkundeshin më kokat nga lodhja e dremitja. Ata pothuaj të gjithë qenë zgjuar. Djali me triko golf dhe shishja e bardhë i gjallëroi, saqë shumë prej tyre u habitën kur treni arriti, më së fundi, në stacion.

Kur vagoni numër 9 u boshatis, konduktorja u çudit kur vuri re që dy dy gratë e ndenjëses së parafundit vazhdonin të flinin. «Si ka mundësi që udhëtarët e tjerë nuk i paskan zgjuar», tha me vete ajo ndërsa po shkonte drejt tyre.

NJË HIJE MIDIS TYRE

— Sa e mirë je bërë sonte, Klara, — tha Fredi pas disa çastesh qetësie të nderë. Klara e pa disi e shpërqendruar të fejuarin dhe me një lëvizje të kokës e treti vështrimin diku pas tij. Fredi u step dhe në vend që të thoshte ndonjë fjalë i hondhi lehtas dorën mbi sup. Iu duk se supi i saj u drodh pakëz, ndryshe nga herët e tjera.

— Sa e mirë je bërë sonte, Klara!

Klara përsëri heshti. Vetëm hapat e tyre u dëgjuan mbi kalldrëmin e rruginave të parkut. Ai vendosi të mos fliste më, madje në shenjë proteste hoqi dorën nga supi i saj, që kësaj here u drodh vërtet shumë, po Fredi nuk pati fatin ta ndiente. «Ky është kulmi, tha me vete Klara. Edhe këtë e bëri. Nuk e kupton që është fajtor, që ka filluar të mos mendojë për mua si më parë. Dhe ç'është

më e çuditshmja hiqet sikur nuk ka ndodhur as gjë. E tmerrshme! Si do t'i vejë filli punës sonë. Ka edhe guximin të më thotë që jam bërë e mirë. Unë e mirë kam qenë.»

— Pra, qenkam bërë e mirë! — përsërithi ajo me zë të lartë. — Të isha e mirë e të më doje aq shumë, sa më thua, do të vije të më takoje më shpesh dhe jo një herë në dhjetë ditë.

Fredi deshi t'i fliste ashpër, po mendoi se arma më e mirë në këso rastesh ishte heshtja.

— Përse bën sikur nuk dëgjon, Fredi?!

— Pse, për mua ishin ato fjalë? — tha Fredi më një mospërfillje të shtirur, që e nervozoi edhe më shumë Klarën.

— Faleminderit, shoku Frederik!

Ata ecën një pjesë të mirë rruge pa i folur njëri-tjetrit, duke menduar secili në hesap të vët për ato gjëra që ishin thënë në grindje e sipër. Të dy e ndienin thellë, që nuk duhej të kishte ndodhur kështu dhe secili përpiqej të arsyetonte veprimet e veta.

— Fredi, ta marrim shtruar. A më premtovë se do të vije pardje?

— Po.

— Po përse nuk erdhe pra!

Ai nuk foli. Në të vërtetë këta muajt e fun-
dit po habitej me sjelljet e Klarës. Ajo qe bërë
më e ndjeshme dhe ishte gati të grindej në çdo
rast.

— Fredi, përse nuk flet?

— Klara! A nuk të sqarova se çfarë e papri-

tur më ndodhi. Nuk mundja të vija, sepse nuk kisha kujt t'ia dorëzoja punën.

— Ohu! Vetëm ty të dalin të papritura, vetëm ty të dalin mbledhje dhe vetëm në ndërmarrjen tuaj ndodhin avari pikërisht në çastet kur të fejuarit duhet të nisen për te të fejuarat e tyre. Vërtet e çuditshme, sepse të tjerëve nuk u ndodh kështu.

— Mjaft tani, se na mërzite me këtë avaz. Ç'hyjnë të tjerët këtu, xhanëm?

— Edhe hyjnë, sepse atyre nuk u ndodh kështu.

— Klara! Pa përsërile edhe një herë!

— Pse, kujton se të kam frikë? Ja, dëgjoje: të tjerëve nuk u dalin pengesa të papritura, mbledhje etj. Për shembull Gonit s'i ndodh kështu.

— Mjaft! E mora vesh, — bërtiti fort Fredi duke bërë shenjë me dorë të ndalonte. Dy të moshuar kthyen kokën si të trembur.

«Domethënë përséri ai», tha me vete Fredi dhe uli kokën. Vetëm një herë e kishte parë dhe nuk mund ta rikrijonte portretin e atij njeriu që po i nxinte jetën. Psherëtiu dhe iu bë sikur ai, si një hije, ishte bashkë me ta në këtë shëtitje. Diku midis tij dhe Klarës. U përpoq edhe një herë të sillte ndër mend fytyrën, sytë, gojën, veshët e tij, por ishte e pamundur. «Hijet nuk mund të riprodhohen me detaje. Ato janë të gjitha njëlloj», tha me vete Fredi.

Ata ecnin në krah të njëri-tjetrit dhe pothuaj kishin harruar se ishin bashkë. Klara mendon-

te ato net të lumtura, kur Fredi i saj kishte qenë më i dashur dhe më i mirë, kur vinte pothuaj me vrâp drejt e në fakultet dhe e priste te parmakët si një adoleshent çamarrok, ndërsa tani . . . «është bërë pakëz indiferent, pakëz i ftohtë? Përse nuk e kupton ai këtë?»

Kjo pyetje e mundonte Klarën prej disa muajsh.

Ndërsa Fredit i vinte të pëlciste kur mendonte se si kishte udhëtar me makina të rastit, madje ndihej më i lodhur se ndonjëherë tjetër, vetëm që të takonte Klarën. Kishte nxituar për tek ajo si gjithmonë, pa ndalur në asnjë stacion tjetër, por ajo e priti me breshëri vërejtjesh. Megjithëse ai qe përpjekur të shpjegohej, ajo s'térhiqej nga e saja. Njeriu, kur do të shkojë tek e fejuara, e gjen kohën. Niset edhe më këmbë. Shkurt, nuk të ka pëlqyer të vish dhe pikë. Dhe pastaj kishte sjellë model shembullin e Gonit, e të fejuarit të Florës, shoqes së saj të grupit. Sepse ai, Goni, sipas Klarës, megjithëse jetonte në një qytet njëqind kilometra më larg se Fredi, vinte në Tiranë, për të takuar të fejuarën, pothuaj dy herë në javë. Kurse Fredi i saj kishte përherë punë shumë.

Fredi në fillim ishte tallur me vajtjet e ardhjet e shpeshta të atij Gonit misterioz. Ai ose duhet të jetë pa punë, ishte shprehur ai, ose duhet të punojë furnitor në ndonjë ndërmarrje. Klara e pati kundërshtuar duke i thënë se ai ishte inxhinier dhe se punonte në byronë teknologjike të një uzine mekanike. Madje doli se ai, Goni, sa he-

rë që vinte në Tiranë, i sillte të fejuarës dhurata, triko varëse, këpucë, etj. etj., pa përmendur em- bëlsirat. Dhe, si për t'i vënë pikën muhabetit, ai Goni i Florës kishte dhe një zakon tjetër: hante e pinte vetëm në restorantet e kategorisë së parë.

Të gjitha këto i thoshte vetë Flora, në prani të të tëra shoqeve, të cilat e vështronin me dhembje Klarën e sikur thoshin: Hë, përsë nuk i bën edhe i fejuari yt këto. Hë, pra, përsë nuk i bën! Në këtë mënyrë ai Goni hyri midis çiftit si një hije, si një personazh gati më i rëndësishëm se vetë ata të dy.

Ndërkohë ata kishin dalë në shëtitoren kryesore të kryeqytetit. Zhurmat e njerëzve që shëtitnin i sollën disi në vete dy të fejuarit e mërzitur. Ora po i afrohej nëntës dhe, sipas zakonit, ata duhej të pinin ndonjë gotë birrë e pastaj Klara duhej të shkonte në konvikt.

Fredi thellë e ndiente se nuk kishte ndonjë gjë për t'u shqetësuar, po gjithsesi i vinte keq përsë të ndodhte kështu, përsë ata të grindeshin për diçka kaq të kotë në fund të fundit? Ndërsa Klara mendonte se po kërkonte diçka krejt të natyrshme: Fredi të vinte më shpesh. Ç'të keqe ka në këtë kërkësë? Në fund të fundit këtë e bënte për hir të dashurisë. Sa më shpesh të shihemi, aq më mirë për të dy. Atëherë përsë ai nuk përpinqet të vijë në Tiranë, siç bën, fundja, Goni i Florës. Edhe ai ka punë, po vjen. Edhe Fredi të gjejë mundësitë siç i gjen ai. Pse, më i zoti se Fredi është Goni i Florës?!

Ky lloj përfundimi i pëlqeu mjaft Klarës dhe ajo u ndie disi e lehtesar kur ata hynë në një brrari të kategorisë së dytë.

Kishin kohë pa ardhur në këtë lokal që, me gjithëse ishte afër qendrës, atyre nuk u pëlqente dhe aq. Fredi me Klarën po rrinin në këmbë te hyrja, sepse nuk dukej asnje vend i lirë. Po pas pak një dorë ua bëri me shenjë nga larg. Ajo i ftonte për te tryesa e tyre. Po ndodhët diçka vërtet e habitshme. Pikërisht në këtë lokal dhe në këtë mbrëmje të trishtuar Klarën me Fredin po i ftonte të uleshin në një tryezë me ta Goni i Florës. Fredi hezitoi për një çast, po Klara e tërroqi dhe ata u nisën drejt tyre. Kur arritën te tryesa, cifti tjetër qe ngritur në këmbë dhe kishte nisur të buzëqeshte. U panë në sy. Gratë u puthën sikur nuk qenë parë për shumë vite. Burrat i dhanë dorën njëri-tjetrit duke buzëqeshur lehtë. U ulën.

Për disa caste në tryezë sundoi një heshtje e tensionuar. Të dy ciftet nuk e ndienin veten mirë. Duhej thënë diçka që të kalohej kriza e fllimit. Flora nisi një bisedë që lidhej me një model të ri fustani. Askush nuk tregoi interes për modellin e ri. As Klara. Fredi mori menynë dhe nisi ta shihte listën e mezeve duke menduar më tepër se si do t'i shprazej Klarës për këtë takim idiot me atë që në mendjen e tij ishte një hije përcarëse.

Fredi ngriti kokën nga mënyja, të cilën nuk e lexoi fare dhe vendosi t'i fliste i pari Gonit të Florës.

— A është ndopak e ftohtë birra? — tha du-

ke parë më shumë nga Klara, e cila gati sa nuk i tha «ç'është kjo pyetje banale».

— Jo, sonte nuk i paskan ftohur dhe aq, — u përgjigj tjetri.

— Pse, vini shpeshnë këtë lokal? — tha disi me guxim Fredi, ndonëse Klara i dha një shenjë që të mos e bënte atë pyetje provokuese.

— Po, vijmë shpesh. Kemi gjetur karar me këtë lokal se njohim dhe një kamerier, i cili sonte paska pushim. Është dhe afër qendrës.

Ndërsa Goni i Florës po fliste, Fredi shikonte me bisht të syrit Klarën, për t'i dhënë të kuptonte se edhe ky Goni qenkësh një qenie po kaq e zakonshme si vetë ai, se edhe ai e conte të fejuarën në lokale mesatare dhe jo aq të shtrenjta. Klara bëri sikur nuk i kuptoï ato vështrime dhe ndërkaq mori menynë për të bërë dhe ajo sikur po merrej me diçka. Në tryezë u rivendos heshtja. Të katër e ndien se qe krijuar një boshllék, i cili nuk u mbush, edhe pse Flora hapi një bisedë tjetër pa ndonjë vlerë, edhe pse Klara tregoi një anekdotë që nuk bëri asnjeri për të qeshur, ndonëse buzët dhe dhëmbët e secilit imituan një si punë qeshjeje. Pas këtyre Flora nisi të shante disa lokale të kategorisë së parë në të cilat nuk mund të shkoje, sepse ka rënë fare cilësia e shërbimit etj., etj.

Ndërkokë kamerieri solli birrat dhe ata trokitën gotat dhe uruan për gëzime njëri-tjetrin.

— Me punë si ia çoni? — pyeti pas pak Fredi Gonin e Florës.

— Çka, nuk ia çoj keq. Po këta muajt e fundit kam qenë i zënë deri në grykë. Po vëmë një linjë të re në punë dhe s'kam pasur kohë të marr frymë. Bile edhe sonte kam ardhur krejt rastësisht, me një makinë që do të kthehet nesër në mëngjes. Nuk do të vija, po kisha një muaj pa ardhur. Ç't'i bësh, kështu e kanë punët, apo jo? — përfundoi ai si për t'u shfajësuar apo për të gjetur mbështetje për punët e tij. Por askush në tryezë nuk foli.

«Si, ju paskeni një muaj pa ardhur në Tiranë?» mendoi përsëri me vete Fredi, dhe pa me bisht të syrit nga Klara, por ajo kishte ulur sytë te menyja.

Darka kaloi bukur, aq, sa Fredi, si kurrë ndonjëherë, atë natë u bë llafazan i madh.

Ndërkaq Goni dhe Flora paguan dhe u larguan nga lokal. Bashkë me ta qenë larguar dhe bëmat e tyre, bashkë me ta qe larguar dhe ajo, hija në përsytyrimin e Fredit. Klara kishte ulur kokën.

— Klara, vërtet sonte je bërë shumë e mirë,
— tha Fredi dhe ajo për herë të parë qeshi atë
mbrëmje.

VDEKJA IME E PARË

Një rastësi e çuditshme: brenda një viti dy vdekje. Pas gjyshit shtatëdhjetenëntëvjeçar, krejt papritur vdiqa unë, në moshën tetë vjeçe. Fatkeqësitë e mëdha, si rregull, nuk e respektojnë radhën. Pra nuk paskam ardhur rastësish dhe kotsë kati në këtë botë, po pikërisht për të provuar sentanca kaq të thella dhe të lashta. E kjo nuk është pak për një jetë të shkurtër si kjo imja.

Megjithatë, akoma nuk po e besoj vdekjen time, sepse, kur vdiq gyshi, njerëzit qanë me ditë të tëra, atëherë qava dhe unë shumë, erdhën në shtëpinë tonë plot njerëz e telegramë ngushëllimi pa mbarim. Disa javë rresht shtëpia jonë binte erë kafeje. Ishte vërtet një gjë e dhimbshme. Kur se vdekja ime qenka diçka krejt tjetër. Asnjeli

nuk po vjen për të më qarë, asnë telegram dheasnë vizitë. I vetmi njeri që po ngashërehet përvdekjen time jam unë, ndërsa lotët po më mbarohen dhe fuqitë po më lënë.

Me sa mbaj mend, kur vdiq gjyshi thanë se ai vdiq papandehur. Lum si ai, u fol, nuk hoqi. Ndërsa mua më njoftuan. Po, po, më njoftuan, si i thonë, zyrtarisht, me qetësi dhe pa asnë shenjë alarmi, sikur po më nisnin për pushime. Dhe unë iu nënshtrova kësaj qetësie të frikshme dhe nuk e kundërshtova aspak vdekjen time. Mendova përnjë çast t'i thosha diçka babait, po ktheva mendje, sepse ai vetë më solli këtu, te kjo dhomë, që patjetër duhet të quhej «dhoma e vdekjes». Babai i di më mirë se unë këto punë. Nëna më ka thënë se prindërit dinë ç'bëjnë me fëmijët e tyre.

Ajo që më lajmëroi vdekjen time ishte një infermieri e gjatë, me flokë të lëshuar mbi supe dhe me një buzëqeshje të ëmbël. Më mori për dore dhe më solli në këtë dhomë. Pasi ndezi një dritë jeshile, më tha duke qeshur:

— Hej, ti, djalosh, qysh këtë çast je i vdekur. Me fjalë të tjera, tash e mbrapa nuk do të bësh detyra shkolle, nuk do të shkosh të blesh bukën në dyqan dhe të marrësh motrën nga kopshti. Pra, nuk do të kesh asnë detyrim ndaj kësaj bote. Hë, të pëlqen apo jo?!

Nuk qenë aq të këqija ato që tha ajo infermierja, po përse duheshin lidhur patjetër me vdekjen time?! Më mirë të jesh edhe i gjallë, edhe pa detyrime, sepse, kur je i gjallë, vete në kine-

ma, luan me top, ha bukë e ha akullore. Po ta kisha babanë pranë, mund tē sqarohesha fare mirë, por ai nuk mund tē jetë me mua, sepse eshtë i gjallë. Tē gjallët nuk rrinë dot me tē vdekurit, bile kanë frikë t'u rrinë pranë, t'i shohin. Kur isha i gjallë, pata parë një tē vdekur që më tmerroi. Tri javë më doli fytyra e tij e verdhë në ëndërr. Kështu do tē më shohin dhe mua në ëndërr babai, nëna, motra dhe shokët e klasës, tē cilët nuk besoj ta dinë që ka dhe vdekje tē tillë, tē lajmëruara.

Ç'është kjo zhurmë? Edhe pas vdekjes dëgjoka njeriu. E çuditshme! Në dhomë po lëviz një njeri. Ai me siguri më ka frikë mua, sepse po ecën fare ngadalë. Kush tē jetë?

— Hej, djalosh! Pa hapi sytë pak! Kemi harruar tē shënojmë moshën. Sa vjeç je?

— Tetë vjeç isha kur vdiqa, — fola unë duke pasur frikë tē hapja sytë se mos ndodhë ndonjë diçka e tmerrshme, si në përrallat e një mijë e një netve.

— Shumë mirë, — tha ajo duke qeshur. Nuk po e kuptoja këtë lloj vdekjeje. Infermierja fliste me mua si me një tē gjallë, bile ajo dhe qeshi si pa tē keq. Mbështetë mësuar me tē vdekurit. Pas pak ndjeva se po lëvizja si tē isha në një karrrocë me kushineta. Ndoshta po më nisin në varreza. E tmerrshme! Kaq e patijeta ime e shtrenjtë. E kisha menduar vdekjen time më interesante, më burrërore, me një pushkë në dorë apo me një shpatë gjigante që çante më dysh krokodilë apo luanë. Ç'është kjo vdekje kështu? Si e lejon babai

këtë? Atë me siguri e kanë mbuluar lötët. Ku ta dinte ai që vetë, me duart e tij, këtë mëngjes po më përcillte drejt vdekjes.

Po nëna? Si do ta priste lajmin? Megjithëse ishte disi fajtore, sepse pikërisht ajo i tha babait sot në mëngjes që unë isha me temperaturë. Prej alarmit të saj, babai, pa e zgjatur, më dërgoi drejt e në spitalin e qytetit tonë. Atje doktor Vidani dhe doktor Bastriu më vizituan me shumë kujdes, dhe, pasi vështruan njëri-tjetrin në një mënyrë të çuditshme, na thanë që të dilnim jashtë. Më pas thirrën vetëm babanë, i cili doli nga dhoma e mje-këve tepër i mërzitur dhe më tha, duke më përkëdhelur, se do të niseshim për në Tiranë, për një analizë që në spitalin e qytetit tonë nuk bëhej. Ndryshe nga babai, unë u gjëzova pa masë. Gjithmonë kam pasur qejf të shkoj në Tiranë! Kisha muaj që e ëndërroja një udhëtim të tillë. Po babai u zyrtësua shumë kur pa gjëzimin tim dhe unë, natyrisht, kisha arsyetë habitesha atëherë. Tani po e kuptoja që ai e dinte që unë do të vdisja. Gjatë rrugës herë pas hëre më vinte termometrin dhe seç bisedonte me doktorët, të cilët e dëgjonin me shumë vëmendje e shqetësim. Dhe tani... o, përsëndaloj karroca me kushineta? Mbasse kam arritur te vendvarrimi im. Duhet të ketë shumë njerëz. Sikur të hapja sytë, të paktën të shihja ç'nerëz kishin ardhur. Ç'mendoj dhe unë budallallëqe!

Të vdekurit nuk mund t'i hapin sytë.

— Hej, djalosh, hapi sytë! Për sot vdekja jote

mbaroi. — Ishte zëri i infermieres. Unë hapa sytë
dhe pashë i lemerisur, para meje qëndronte ba-
bai. Ai nuk qante, përkundrazi, po queshte si as-
njëherë tjetër. Më mori në krahë dhe më puthte.

— Baba! Ke qarë shumë ti?!

— Jo, nuk kam qarë fare.

— Po ku po shkojmë ne tanë?

— Në shtëpi, të keqen babi!

— Po mua ajo infermierja më tha se kam vde-
kur një herë.

— Ashtu është, ti vdiqe një herë dhe tanë u
ngjalle.

— Domethënë kjo ishte vdekja ime e parë, —
thashë duke qeshur, sepse, kur je fëmijë, nuk e
di tamam-tamam ç'është vdekja, ndaj dhe e ha-
rron menjëherë.

2

Tani djali është qetësuar. Kemi mbi dy orë që
udhëtojmë dhe Halimi, shoferi i autoambulancës,
ende nuk ka folur një fjallë. Edhe ai është i më-
zitur sikundër dhe unë. Qysh kur u nisëm ai don-
te të më thoshte diçka, por unë e kisha mendjen
te djali. Ishte hera e parë që na sëmurej dhe e vë-
rëta është se unë u alarmova shumë, mbasë ngaqë
nuk isha përgatitur, sepse çdo gjë ndodhi më një
shpejtësi të rrufeshme. Vidani dhe Bastriu sapo e
vizituan djalin vendosën ta nisin për në Tiranë.
Unë nuk mund të kundërshtoja. U nisëm me ur-

gjencë, ndonëse Halimi nuk e ngiste me aq nxitëm makinën. Herë pas here ai më shikonte, e unë i merrja ato shikime si një lloj dhembshurie, ndaj dhe rrëzoja menjëherë sytë përdhe.

Kur arritëm në Tiranë, aty nga ora njëmbëdhjetë, rrugët qenë plot me njërez dhe për herë të parë nuk më bëri hiç përshtypje gjallëria e kryeqytetit. Vidani i tha Halimit ta mbante makinën pranë një ndërtese pesëkatëshe se kishte një punë të tijën. Zbriti nga makina duke i thënë Bastriut se do të takoheshin në një vend që tanë nuk më kujtohet. Ne vazhduam rrugën dhe pas disa minutave arritëm te dera e spitalit.

Pritëm përjashta, derisa Bastriu bisedoi me një burrë që më vonë mora vesh se ishte shefi i pavijonit. Pas bisedës me të, djalin erdhi e mori një infermiere që dinte të qeshte shumë bukur e që djalit i hyri menjëherë në zemër, sepse i bindëj. Mbase dhe nga frika, po mua kështu më pëlqente më tepër të mendoja. Ajo më tha se përgjigja e analizës do të jepej nga ora një e drekës, ndaj u ula të prisja te disa stola përballë ndërtesës së spitalit. Ndërkohë Halimi që nisur për ta cuar mjek Bastriun në vendin ku e priste Vidani.

Minutat kalonin dhe unë shihja i përqendruar vetëm portën ku që futur djali. Atje hynin e dilnin shumë njërez, po djali ende nuk po dukej. Pashë orën dhe u habita që koha nuk kishte ecur fare. Në një çast mendova përse nuk ishin me mua mjek Vidani dhe Bastriu, mirëpo mendova se kaq që detyra e tyre; me djalin po merreshin

tani mjekët specialistë. Pas disa minutave të porta e pavijonit dallova infermieren. E njoha nga buzëqeshja. U ngrita dhe shkova me vrap tek ajo. Ajo më tha se analiza e djalit kishte dalë shumë mirë. Shefi, vazhdoi ajo, është duke përgatitur përgjigjen me shkrim. Nuk dija si ta falënderoja atë vajzë që më dha një lajm kaq të gëzuar. I shtrën-gova edhe një herë dorën. Ndërkohë pashë makinën e Halimit që hyri në oborr. Iu afrova, i thashë ç'më tha infermierja, po tek ai nuk pashë entuziazmin e zakonshëm që vërehet në këto raste. Halimi më dha vetëm dorën dhe në këtë veprim ndjeva diçka të panatyrshme. Më erdhi shumë keq, sepse me atë nuk po takohesha për herë të parë, me Halimin njiheshim prej vitesh.

— Unë e dija që kur u nisëm se djali yt nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, — tha ai krejt qetë.
— Si?! — pyeta unë i habitur. — Ti e ke ditur qysh kur u nisëm dhe nuk më ke treguar?

— Po, e kam ditur, po, gjithsesi, nuk kisha siguri, me shëndetin nuk bëhet shaka. Kështu prita që të sigurohesha. Pastaj unë nuk jam mjek.

U habita nga këto fjalë dhe nuk doja të besoja kurrsesi që dikush qe tallur me mua kaq keq. Atëherë Halimi më tregoi se si Vidani dhe Bastriu kishin dy ditë që përpinqeshin për të marrë një makinë për në Tiranë, dhe ja, më në fund, kishin gjetur si pretekst djalin tim.

Kjo sjellje më zemëroi pa masë. Më shkrepitë takoja e të bisedoja me shefin e pavijonit, që të siguroheshim përfundimisht.

Shefi i pavijonit na priti ngrohtë dhe përsëriti edhe një herë që djali nuk kishte ndonjë gjë për t'u shqetësuar.

— Djalin mund ta merrni që tani, — tha ai, — po përgjigjen me shkrim e kemi rregull t'ua japid vetëm mjekëve.

Më pas folëm ne. Shefi na dëgjoi me shumë vëmendje, me një ndjenjë habie të shprehur. Pasi e vizitoi edhe një herë djalin, na tha si me të qeshur:

— Besoj se do të na e lini djalin edhe një gjysmë ore në pavijonin tonë.

Ne nuk thamë jo, megjithëse nuk e kuptuam qëllimin e tij. Vetëm më vonë, kur ajo infermierja i tha djalit: «hej, djalosh, hapi sytë! Vdekja jote për sot mbároi», unë dhe Halimi morën vesh se çfarë kishte bërë shefi i pavijonit.

Jà tani djalin po e zë gjumi. Så bukur e tha: domethënë kjo ishte vdekja ime e parë.

3

Shefi qenka sot në formë. Më thirri në zyrë dhe më dha një urdhër të çuditshëm, gati të pabesueshëm për natyrën e tij të ekuilibruar. Ai, pagnritur kokën nga disa shkresurina, më tha:

— Atë djalin e vogël, që sapo i bëmë analizën, regjistroje si të vdekur.

— Si të vdekur?!

— Çfarë ka këtu pér t'u habitur? Spital jemi.

— Natyrisht, po djali është gjallë dhe si kokrra e mollës.

— Pikërisht se është i gjallë si kokrra e mollës unë them ta regjistrojmë si të vdekur.

— Doktor! Po kjo është në kundërshtim me të gjitha rregullat, ligjet. Nuk mund të bëhet!

— Mos u bëj merak. Unë do të firmos pér këtë shkelje rregulli, ti do të bësh vetëm formalitetet e nevojshme, sepse...

Dhe shefi më bindi pse duhej ta bënim këtë veprim të pazakontë. Pa e zgjatur, unë e mora djalin pér dore, e çova te dhoma e infermierisë dhe i thashë atij të shtrihej e të mbyllte sytë, sepse qysh në atë çast ai zyrtarisht quhej i vdekur. I shkreti djalosh! I mbylli sytë dhe nuk i hapi gjersa erdhë i ati, me sa duket nga frika. E lashë djalin ashtu të shtrirë dhe dola në korridor pér të dhënë lajmin e vdekjes së papritur. Duhej që çdo gjë të ishte e natyrshme. Ashtu si rastësisht i thashë rojës së katit që ai djali që sapo sollën vdiq. Ai nuk tha asgjë, vecse më pa si me dyshim. Me sa duket unë nuk e kisha thënë mirë lajmin e rremë. Ua thashë këtë lajm dhe disa shoqeve të tjera dhe në njëfarë mënyre u mor vesh se dikush kishte vdekur në pavijonin tonë. Vetëm pas kësaj fushatë vdekje-ndjellëse e nxora djalin nga dhoma e infermierisë të mbuluar me një çarçaf të bardhë, derisa i ati e mori në krahë dhe e nxori nga dera e prapme e pavijonit. I gjori djalë, sa u gëzua kur pa të atin! Sa lezeçm e tha: Baba, ke qarë shumë ti?! Jo,

nuk kam qarë fare, — iu përgjigj i ati. Po ku po shkojmë tani? Në shtëpi, të keqen babi!

— Po mua ajo teta infermierja më tha se unë kam vdekur një herë.

— Ashtu është, ti vdiqe një herë dhe u ngjallë, — i tha babai duke e puthur në faqe dhe në ballë.

E shkreta unë, do të më mbajë djali mend për keq! Po tani e kam më të vështirë. Shefi më ka thënë që të pres dy mjekët shoqërues. Ora po shkor tre dhe ata duhet të vijnë nga çasti në çast. Si do t'ua them atyre që djali ka vdekur. Gjithsesi ata janë mjekë.

Ja, ata po vijnë. Sec po bisedojnë me rojën e kosit. Të afrohem dhe të dëgjoj. Roja ua ka thënë lajmin.

— Duhet ta keni ngatërruar, — thotë njëri prej mjekëve me mospërfillje dhe që të dy vazhdojnë të ecin nëpër pavijon. Atyre nuk u bëri përshtypje lajmi, sepse nuk besojnë se bëhet fjalë për pacientin e tyre. Ja, po pyesin dhe një tjetër infermieri. Ajo nuk di gjë dhe po i orienton përt te dhoma ime. Ata po ecin drejt dhomës sime. Shohin brenda dhe unë natyrisht nuk jam aty. Njëri prej tyre po shikon orën. Në sytyrat e tyre nuk ka asnë shenjë alarmi. Ata janë të qetë. Ja, tani po pyesin një infermieri tjetër. Asaj i kam thënë dicka për djalin dhe ajo po u tregon atë që i kam thënë unë. Ata po i flasin infermieres me duar e me këmbë. Po i përshkruajnë paraqitjen fizike të djalit, por infermierja vetëm bën me ko-

kë në shenjë mohimi. Ajo largohet dhe ata të dy kanë mbetur të vetëm në mes të korridorit. Dukën të alarmuar. Njëri prej tyre po thotë diçka dhe të dy kanë kthyer kokën drejt meje. Njëri prej tyre më ka njobur.

— Mirëdita! Në mos gabohem, ju jeni ajo infermierja që jeni marrë me atë djalin e vogël që sollëm sot në mëngjes.

— Po, unë jam.

— A e dini se ku ndodhet, se duhet të nisemi. Kemi rrugë për të bërë. Pastaj na duhet edhe përgjigjja me shkrim e analizës.

— Pse, nuk e keni marrë vesh? Djali... djali ka disa orë që kë vdekur. — Ata më kanë ngulur sytë dhe nuk flasin. Mua po më dridhen gjunjët. Ç'm'u desh të hyja në këtë lodër. Më në fund njëri prej tyre kërkon të flasë:

— Ka vdekur, thatë? Nuk është e mundur. Ka vdekur... Si mund të vdesë njeriu kaq kolaj? E quditshme! Po si, xhanëm?!

Në të folurën e tij ka frikë, ka ankth, ka pasiguri.

— Në qoftë se nuk besoni, mund të shikoni shënimet e shefit në kartelë.

Tani po ndihem më e sigurt. Ata nxitojnë prapa meje përtë parë me sytë e tyre kartelën ose më saktë vdekjen. Unë nxjerr kartelën dhe ata po lexojnë ato që ka shkruar shefi. Të dy janë bërë meitë. Nuk kanë fuqi të lëvizin prej këtij vendi, madje kanë frikë dhe turp të më shohin drejt në sy.

— Më falni, po mua më duhet të iki, se përsot e mbarova punën.

Ata dalin në heshtje dhe nuk më thonë asnje fjalë. Unë jam duke ecur nëpër korridor dhe koka më dhemb shumë. O, sa shumë! Po më duhet ta mbaj veten. Nuk më ka ndodhur të ndihem kaq e këputur dhe e dërrmuar, megjithëse kam vite që punoj në spital.

As unë dhe as Vidani nuk dimë ç'të themi. Punët na janë ngatërruar aq këq, sa s'bëhet më. Gjithçka është çudit pa masë. Nuk mund ta besojmë që djali të ketë vdekur. Ai nuk kishte asgjë. Edhe temperaturën ia ulëm. Të vdesë tjetri tak-fak nga një bronshit i lehtë. E çuditshme! Vërtet e çuditshme! Ç'të bëjmë tanë? Nuk kemi ç'të bëjmë asgjë, veçse t'i nënshtrohemë fatit. Po ata, Halimi me të atin e djalit, përse janë zhdukur? Përse nuk na priten? Ç'them dhe unë! Më mirë që kanë ikur. Çfarë do t'i thoshim të atit ne?!

Jemi këtu në postë dhe po presim të flasim në telefon me spitalin e qytetit tonë. Mbështetur ka arritur atje, sepse këtu në spitalin e Tiranës nuk ndodhet. Vidani pyeti mjekun e morgut dhe ai e siguroi se sot nuk kishte hyrë atje ndonjë kusomë fëmije. Megjithëkëtë ai i dha leje Vidanit të shihte vetë brenda për të hequr merakun. Kontrolloi afër një orë, i shkreti Vidan, në

morg, po djali nuk ishte aty. Ndërsa unë ndoqa gati me vrap një djalë në oborrin e spitalit që i ngjante shumë pacientit tonë. Nga frika djali i panjohur nisi të vraponte. Më lodhi shumë derisa e arrita. Po gjithçka qe e kotë, ai nuk ishte djali që kërkoja. S'mjaftoi kjo, u desh të bëja fjalë dhe me nënën e atij djalit, e cila më kishte parë mua që ndiqja me vrap të birin.

U kthyem përsëri në pavijon. I pyetëm të gjitha infermieret dhe ato na e përsëritën se dali kishte vdekur. Kurse një grua na tha se e kishte parë një djalë të mbështjellë me një çarçaf të bardhë në krahët e një burri duke dalë nga dëra e pasme e pavijonit. Kur e pyetëm nëse ishte i vdekur apo i gjallë, ajo na tha se nuk dinte gjë të saktë, vetëm ishte e sigurt se ai burri qeshte me zë. Ky qe episodi me ngjethës që kemi dëgjuar sot. Me siguri që babai i djalit e ka marrë kufo-mën, ose më saktë e ka grabitur, dhe nga dhimbja duhet t'i ketë filluar ndonjë krizë nervore, sepse nuk kishte arsy që ai të dilte nga dera e pasme e pavijonit, ku hyjnë e dalin vetëm ata të personelit, duke qeshur, me djalin, të mbështjellë me çarçaf të bardhë, në krah.

O zot, ç'është ky hall që na gjeti sot!

— Vidan! Doli numri. Shko e flit ti!

— Jo, nuk mundem. Shko ti, Bastri. Je më i qetë dhe më i përmbajtur në këso rastesh.

— Alo! Spitali! Jam doktor Bastriu. Ka ardhur makina e Halimit aty në spital?... Ka ardhur, ë... Po Halimi ku është tanë? Po, mirë e

ke ti, në shtëpinë e tij duhet të jetë. Mirupafshim!

— Vidan, ata të spitalit nuk dinë gjë. Unë them të marrim një numër tjetër.

— Mirë e ke. Duhet të bisedojmë me ndonjë nga komshinjtë e familjes së djalit. Gjej një numëror.

— Shoqe, a mund të na lidhësh me një numër tjetër? Shpejt, të lutem, se ashtu kemi një hall!

5 — Bastriu nuk e di se çfarë kam hequr atje në morg. Edhe kur kam qenë student, nuk jäm trembur si sot nga të vdekurit. Infermierja e morgut më shoqëronte e habitur. Dhe kishte të drejtë të mendonte për mua ç'të donte, sepse veprimi im ishte i pakuptimit. Ajo më shpjegoi fare qartë që sot nuk kishte hyrë në morg kufoma e asnje fëmije, por unë ngula këmbë të hyja brenda. Ajo pranoi më tepër nga pamja ime e trembur, e alar muar, sesa nga arsyaja. Doja të bindesha deri në fund, sepse vdekja e djalit më duket disi misterioze, enigmatike. Megjithatë, të kontrollosh të vdekurit, pa dyshim është një lloj marrëzie. Ideja se po bëja një marrëzi më lëvizte brenda trupit, nga këmbët deri te koka, që po më plaste nga dhimbja. I vetmi mendim që koka ime mundi të mendonte gjatë kohës kur isha në morg ishte ai, që edhe unë, pas disa viteve, do të qëndroja i vdekur në një sallë të tillë të ftohtë. Prandaj, kur dola nga mor-

gu, m'u duk sikur më ndiqnin prapa të vdekurit, sikur dikush prej tyre më bërtiste: Ej, ti, këtu e ke vendin, përse ikën, përse ikën?! Cudi, vërtet e habitshme!

Djali ishte për bukuri në mëngjes. Megjithatë nuk përjashtohen të papriturat. Po përse të na ndodhin neve ato?! Si do të kthehem i nesër në spital? Çfarë do t'u themi kolegëve, se kur vdiq djali nuk ishim në spital dhe se nuk e kemi idenë se si u zhvillua sëmundja?!

Centralistja po i thotë Bastriut që numri nuk përgjigjet. Po, nuk ka dyshim që njerëzit e asaj shtëpie kanë vajtur për ngushëllim tek i vdekuri. Tani shumë njerëz janë grumbulluar atje dhe bisedojnë, qajnë, bërtasin. Kryesish për mua dhe Bastriun bisedojnë ata. Po, po, sonte ne jemi në qendër të bisedës, edhe nesër, edhe pas nesër, edhe..

—Vidan, të zuri gjumi?

— Jo, po mendoja me sy mbyllur.

— Eja të ikim, se po bëhet vonë. Të gjejmë ndonjë hotel.

— Mirë, ikim.

Nuk kemi ç'të bëjmë tjetër veçse të shtrihemi. Jemi të lodhur, të rraskapitur. Nesër na pret një udhëtim i llahtarshëm.

6

Sot kam kaluar një ditë mrekulli, një ditë me ngjarje që ngjasin vetëm në përralla. Para disa

orësh i vdekur e tani i gjallë, duke udhëtuar me një makinë të bardhë, bile në prehrin e babait, që akoma vazhdon të jetë i mërzitur. Kur t'ua tregoj shokëve, ata me siguri nuk do të më besojnë, do të vrapijnë te mësuesja dhe ajo do të më thotë: «Turp të kesh! Sa herë e kemi përsëritur në mësim se njerëzit vdesin vetëm një herë dhe nuk ngjallen më! S'bëhen shaka të tillë, kaq të rënda! Prandaj, ulu aty dhe të mos thuash më budalla-lleqe të tillë!

Mbase mësuesja ka parasysh vetëm njerëzit e qytetit tonë, se në Tiranë dhe në qytete të tjera të mëdha njerëzit patjetër duhet të vdesin dhe të ngjallen sa herë të duan. Nuk kâ si të jetë ndryshe, përderisa mua më ndodhi sot një gjë e tillë. Këtë ma tha infermierja, babai dhe xhaxhi Halimi. Përse duhet të më gënjejnë mua ata? Pastaj, kот e bëra unë gjithë këtë rrugë?

Nuk e kuptova hiç xhaxhi Halimin kur më tha: Tani e prapa ti je Kostandini i qytetit tonë. Vetëm me një ndryshim: ti po kthehesh në qytetin e familjen tënde jo me kalë, po me makinë. Por unë nuk e kam emrin Kostandin. Apo kur ngjallesh nga vdekja e parë të vënë emër tjetër? Kjo duhet të jetë. Ndërsa babai më tha se unë vdiqa me shaka. E çuditshme, si mund të vdesësh me shaka?! Vetëm në filma njerëzit vdesin me shaka.

DYZET MINUTA NËNKRYETAR

— Me siguri duhet të jetë ai burri me xhaketë blu, — tha njëri nga katër klientët e tryezës së thirrur «natyra e qetë», që e kishte marrë këtë emër ngaqë qe pranë një pikture të varur lart në mur, ku disa copa bostani të prera bënин thirrje për qetësi në lokalini plot zhurmë të qytezit tonë të vogël.

— Jo, more! Çfarë xhakete blu, — ndërhyri klienti i dytë duke parë, me një sy prej eksperti në drejtim të tryezës së qoshes, ku ndodhej burri me xhaketë blu. Pa e hequr vështrimin prej an-dej, ai konkludoi: — Mos flisnin kot së koti, burri me xhaketë bojëkafe është shumë më i përshtatshëm, më i paraqitshëm, më protokollar.

— Edhe mua kështu ma thotë mendja. Nuk mund të emërojnë nënkyretar komiteti një burrë me golf me vija, — tha klienti i tretë, që nuk shqu-

hej ndonjëherë për vëzhgime të holla. Po klienti i parë, që nuk ishte i një mendjeje me shokët e vet, disi me nervozizëm tha:

— Ohu! Përralla me mbret. Unë them se burri me xhaketë blu është nënkyretari i ri i komitetit dhe pikë. Po jua mbajti, e vëmë me nga një konjak «Skënderbeu» dhe e mbyllim këtë muhabet.

— Në rregull, e vëmë me bast, — thanë gati në një zë dy të tjerët.

Vetëm pas këtij kompromisi në tryezën e tyre ra heshtje. Prisnin me padurim Mirën, kamerieren, për ta pyetur se cili prej atyre dy burrave ishte nënkyretari i ri i komitetit.

— Mira, eja një minutë! — e thirri klienti i katërt, që vetëm kësisoj mundi të merrte pjesë në emërimin e nënkyretarit të ri. Po Mira u largua në anën tjetër të lokalit për t'u shërbyer klientëve të tjerë.

Ndërkaq të dy burrat e tryezës në qoshe, ose më saktë të tryezës së rezervuar, po pinin të qetë nga një limonadë me ujë Gline. Ata tërhoqën vëmendjen e tryezës «natyra e qetë» sa po zbritën nga një «Fiat» i kuq. Vetëm nga ky shkak ata nuk do të kishin rënë në sy të klientëve të rregullt të lokalit kryesor të qytetit tonë, dhe rrëth tyre nuk do të ngriheshin hamendësi me kaq rëndësi, sikur me të zbritur nga vetura nuk do të takoheshin përzemërsisht me shefin e seksionit të ndërtimit të Komitetit ekzekutiv të Rrethit. Dhe kjo ndodhi pikërisht ato ditë kur pritej emërimi i nënkyeta-

rit të ri të komitetit. Të gjitha këto mjaftuan që në tryezën «natyra e qetë» të nisnin debatet me temë: Cili është nënkyetari i ri i komitetit?

— Çfarë deshët ju? — pyeti befas Mira, pasi kishte marrë porositë e klientëve të tjerë.

— Përpara se të marrësh porosinë për katër konjakë «Skënderbeu», na trego se cili prej atyre dy burrave që po pinë limonadë te tavolina e rezervuar është nënkyetari i ri i komitetit?

Kamerierja për disa çaste u step dhe e habitur ktheu kokën nga tryeza e qoshes.

— Ai me xhaketë blu, apo ai me kafe?

Kamerierja u përkul disi dhe foli me një zë pak më të ulët e gati konspirativ:

— Pse, nënkyetarit të ri të komitetit i pas-kam shërbyer unë e shkreta? Po juve kush ju tha që është nënkyetari i ri?

Natyrisht pyetja e kamerieres mbeti pa përgjigje. Klientët e «natyrës së qetë» mbeten të cuditur nga fjalët e saj. Si na ndodhi kështu? pyes-nin ata vetveten dhe secilit i vinte shumë turp të pohonte dështimin. Kthyen kokat edhe një herë nga qoshja e lokalit dhe të katër menduan se ata të dy nuk e meritonin atë post, ata ishin njerëz krejt të zakonshëm, madje ata nuk dinin të qesh-nin, të bisedonin në mënyrë të kulturuar, bile, «bile ata nuk janë aspak seriozë», u shpreh kienti i katërt dhe, si për të përligjur hamendjet e shokëve, sepse ai për vete të tij nuk u kishte dhënë asnjë post burrave që kishin zënë vend në tryezën e rezervuar, shtoi:

— Nuk e kuptoj si lejohen njerëz dosido të ulen në atë tavolinë.

— Janë bërë njerëzit të paturpshëm, u ka plasur cipa fare, — foli duke shfryrë klienti i dytë, ai që kishte vënë bast për burrin me xhaketë bojë-kafe.

Pasi i bënë edhe disa vërejtje kamerieres që nuk tregonte hiç kujdes për t'i njohur klientët, e veçanërisht ata që padrejtësish ulen te tryezë e rezervuar, klientët e «natyrës së qetë» nisën një tjetër bisedë, më pak interesante, që, sipas klientit të katërt, ishte vulgare e monotone.

Si e mori pak veten, Mira fluturoi për te një tryezë ku e kërkonin me ngut dhe, kur arriti te banaku, nuk iu ndenj pa i treguar shoqes, Kalemës, çfarë i thanë ata të «natyrës së qetë». Kalemja u shqetësua shumë nga ky lajm, po njëkohësisht u çudit se si nuk e kishin marrë ende vesh se cili ishte nënkyetari i komitetit. Të qenë dhjetë veta edhe mund të ngatërrroheshe, po të mos e gjesh nënkyetarin e ri të komitetit midis dy veta e shtë njëlloj si të mbytesh në një gotë limonadë, tha me vete Kalemja. I hodhi një sy tryezës së rezervuar dhe nga larg asnjeri nuk i ngjau si nënkyetar komiteti, madje sipas saj, njëri prej tyre, ai me golfin vija-vija, duhej të qe shofer. Ja tha këtë mendim Mirës, mirëpo ajo e siguroi se shoferi priste jashtë, te vutura. Megjithatë Kalemja nuk ngurroi të pyeste disa klientë të tjera, po nuk mori ndonjë përgjigje të prerë. Sapo ajo pyeste, të gjithë kthenin kokën andej nga tryezë

ë rezervuar dhe pastaj thoshin pak a shumë kështu: «Ndoshta edhe mund të jetë njëri prej tyre; ne nuk dimë gjë, po ç'rëndësi ka kjo?» Megjithatë nuk u desh shumë kohë që klientët herë pas here të kthenin kokën andej nga qoshja e lokalit dhe secili të bënte hëmendësinë e vet: Cili ishte nën-kryetari i ri i komitetit midis atyre dy burrave që po pinin të qetë limonadën me ujë Gline?

Nuk vonoi e në lokal hyri shefi i sëksionit të ndërtimit, i cili u drejtua për nga tryezat e qoshes. Kalemja, që e njinte, i bëri shenjë dhe shefi, duke parë me kujdes majtas e djathtas, iu afrua Kalemes.

— Shef, di gjë ti për nën-kryetarin e ri të komitetit, sepse na thanë se është ulur atje, te tavolina e rezervuar. Cili është nga ata dy burrat?

Ndërkojë shefi kishte kthyer kokën andej nga i tha Kalemja dhe nuk po u besonte syve. «Si! Gimi ose Berti nën-kryetar komiteti», tha me vete dhe, si mblodhi buzët, pa thënë asnjë fjalë, u çapit drejt tyre. Gjatë atyre pak mëtrave rrugë ai solli ndër mend ardhjen e tyre me shërbim në qytet, takimin e tij me ta, bisedën e shpejtë, por as gjë s'e kishte ngarë të mendonte për një emërim të ri; më në fund i erdhën nëpër mend vitet studentore. «Vërtet? mendoi, megjithatë, përderisa është hapur fjalë, diçka duhet të ketë.»

— Ky duhet ta dijë me siguri, përderisa po shkon atje, — foli klienti i dytë i «nëtyrës së qetë», duke zgjuar te shokët e tij kureshtjen e parë.

— E kam thënë me kohë unë që ky shefi i

ndërtimit do të bëjë përpara. Ja, pa filluar akoma punë nënkyretari i ri, ia gjen anën, — tha klienti i tretë.

— Mos u nxiton! Të shohim kë do të takojë në fillim, — u hodh klienti i parë.

Mirëpo dy burrat e tryezës së qoshes ngritën vetëm kokat për të pritur të sapoardhurin. Njëri prej tyre, ai me xhaketë bojëkafe, i rregulloi karrigen, ndërsa tjetri i ofroi një paketë me cigare. Ata nuk ia zgjatën duart njëri-tjetrit, sepse qenë takuar para se të hynin në lokal, kështu që klientët e «natyrës së qetë» nuk e shuan dot kureshtjen.

Ku ta dinin ata se edhe vetë shefit i kishte hyrë krimbi nga fjalët e Kalemes, dhe, megjithëse kishte disa minuta që bisedonte në tryezën e rezervuar, nuk po merrete vesh asgjë. Një çast i bëhej si nënkyretar Gimi dhe më pas Berti. Të pyeste hapur, i vinte zor. Mund të merrej edhe për keq pyetja e tij. Pastaj, kujt t'ia drejtonte pyetjen. Të dyve njëkohësisht? Kjo nuk kishte kuptim. Po sikur të mos qe asnjëri nënkyretari i ri i komitetit?

Megjithatë shefi bëri disa përpjekje për të nxjerrë në dritë të vërtetën. Ai hapi biseda përfusha të ndryshme të ekonomisë, pikërisht ato që mbulonte nënkyretari. Bashkëbiseduesit nuk trguan ndonjë interes të veçantë, të paktën interesin e një nënkyretari të sapoemëruar. Pas një heshjeje të shkurtër burri me xhaketë bojëkafe pyeti:

— Në ç'kategori e keni skuadrën e futbollit?

— Në kategorinë e tretë, megjithëse këtë vit kemi shumë shpresë të hyjmë në kategorinë e dytë, prandaj dhe punimet në stadiumin e ri të qytetit i kemi përvjetuar. Stadiumi do të kishte përfunduar qysh vitin e kaluar, po nuk kishim fonde të mjaftueshme, — u shpjegua shefi me nxitim, sepse ndjeu se më në fund kishte kapur një fill që mund ta çonte tek e vërteta. Pra, mendoi ai, Gimi kà mundësi të jetë nënkyetari i ri.

— Po si ka mundësi të fillojë një objekt me kaq rëndësi pa plan të plotë fondesh financiare, — ndërhyri burri me xhaketë blu, Berti. Shefi ktheu kokën nga ai disi i habitur për ndërhyrjen, sepse nuk i takonte atij, po Gimit, që më mendjen e tij sapo u emërua nënkyetar, të pyeste.

— Në fakt ky objekt ka filluar para se unë të vija në seksion dhe nuk e di me saktësi se si është menduar atëherë nga shokët drejtues. Me sa më kujtohet, shoku Zamir, ish-nënkyetari i komitetit, është marrë drejtpërdrejt me këtë problem, — sqaroi shefi, pa iu drejtuar asnjërit, këtë radhë me shpresa të humbura.

Edhe pas këtij provokimi të dy burrat nuk dhanë ndonjë shenjë. Në tryezë u vendos përsëri qetësia. Pas pak thirrën kamerieren, e cila erdhi shumë shpejt, sikur këtë çast po priste. Shefi bëri përpjekje të paguante, po të dy burrat nuk e lanë. Veprimi i shefit, i cili i gjeti burrat në tryezë, u komentua si servilizëm nga klientët e «natyrës së qetë».

Para lokalit priste vetura. Dy burrat u për-

shëndetën me shefin dhe hipën në veturë; e cila u nis me shpejtësi, së bashku me enigmën, siç do të thoshte më vonë klienti i katërt i tryezës «natyra e qetë». Shefi ndoqi disa çaste largimin e veturës dhe bëri të kthehej nga shëtitorja, po një zë i panjohur e ndali në vend:

— Shoku shef, e përcollët nënkyetarin e ri të komitetit, — kishte folur klienti i dytë i «natyrës së qetë», të cilët qenë vënë në ndjekje të shefit me qëllim që të zgjidhnin bastin. Shefi u hodi një shikim të katër burrave dhe u kujtua se qenë klientët e rregullt të «natyrës së qetë» dhe si me mospërfillje pyeti:

— Pse, ju e dini se cili ishte nga ata të dy nënkyetari i ri i komitetit?!

— Pse, edhe ju, shoku shef, nuk e dini? — gati nuk bërtiti klienti i parë, ai që kishte vënë bast për burrin me xhaketë blu, dhe pa nga tre shokët e tij me një pikëllim fëmijnor, tamam sikur dikush padrejtësisht t'u kishte prishur lodrën. Shefi mbeti një çast i hutuar nga ky reagim, pas pak gjeti forca të largohej nga ai vend.

«Fiat!» qe zhdukur dhe shefi mendoi se ata të dy, burri me xhaketë bojëkafe dhe ai me xhaketë blu, me siguri nuk do ta merrnin vesh kurrë se rastësisht një ditë, të paktën njëri prej tyre ishte emëruar dyzet minuta nënkyetar i komitetit në qytetin tonë.

NË VEND TË NJË ËNDRRE

Vërteq që ngjanin me personazhet e Zhyll Verrit. Ashtu në rresht, njëri pas tjetrit, ata e cni sïkur po shkonin në qendër të tokës. Në atë treçerek errësire ishte tepër e vështirë, në mos e pamundur, të dalloje fytyrën, sytë, hundët dhe në përgjithësi konturet e plota të ndonjërit. Ata e cni në krah të njëri-tjetrit dhe bisedat midis tyre jehonin si pëshpërima të një procesioni kishtar.

Vendi ku do të mbahej kongresi i sivjetshëm i tyre ishte caktuar 150 metra më thellë sesa vitin e kaluar. Pra marshimi do të ishte më i gjatë, më i vështirë, po kjo nuk i pengoi dhe delegatët e vjetër të ndërmerrnin këtë udhëtim të pazakontë e shumë të dëmshëm për shëndetin.

Delegatët e kongresit të shkesëve zbritin në thellësi të tokës të përbajtur e njëkohësisht të

sigurt për udhëtimin e tyre. Ndoshta pas disa dekadash ata mund të gjendeshin pranë objekteve me rëndësi të madhe arkeologjike, por askujt nuk do t'i shkonte ndër mend të ndalonte, qoftë edhe për disa çaste, për t'i vrojtuar, ashtu siç nuk u bëjnë përshtypje ato objekte urithëve apo laku-riqëve të natës. Ah! Këta njerëz u ngjanin më tepër laku-riqëve të natës sesa personazheve të Zhyl Vernit. Që në fëmijëri më kanë tërhequr këto kafshë që i vret drita e diellit.

Delegatët — laku-riqë nate vazhdonin të zbritnin thellë e më thellë. Ndërsa unë, që e kisha për herë të parë, mezi prisja që të arrinim sa më shpejt që të ishte e mundur në sallën nëntokësore, ku do të mbahej kongresi. Krahas dëshirës për të parë fytyrat e kësaj kolonie nëntokësore, më shumë doja të dëgjoja se çfarë thuhej në një kongres shkësësh. Më lindi një shqetësim se mos punimet do të zhvilloheshin në errësirë. Kështu dhe gjithë mundimi do të më shkonte kot; do të më shkonin kot gjithë ato përpjekje për të falsifikuar dokumentet, për të gjetur një njeri garant etj. Sidoqoftë shpresoja se këta njerëz nuk ishin aq të çmendur sa ta zhvillonin kongresin në errësirë të plotë.

Ecja me kujdes se mos përplasësha me ndonjë shkëmb apo mos rrëzohesha në ndonjë gropë, e pse jo, dhe në ndonjë humnerë nëntokësore. Para meje ecnin dy veta, që nga zëri kuptohej se ishin burra. Ata e dinin mirë rrugën sepse gjatë gjithë kohës bisedonin me njëri-tjetrin pa e pasur ašpak menjen tek ajo. Nga copërat e bisedës dy

burrat duhej të ishin të shkolluar. Ajo që më ngacmoi më tepër ishte emri i një shpikësi apo shkençëtari të njojur. Iu afrova më shumë dy buriave dhe ata seç thanë për motorë me djegie të brëndshme. Nga ky çast biseda s'm'u duk interesante dhe ngadalësova hapat për t'iu afrovar ndonjë grupi më të këndshëm. Po çuditërisht dhe dy burrat gati ndalën në vend, sikur më prisnin pikërisht mua. Unë nuk e bëra veten dhë u kalova fare pranë. Ndjeva se ata të dy më ndoqën dhe seç i thanë njëri-tjetrit. Isha i sigurt që nuk më njohen, ashtu siç nuk i njoha dhe unë ata. Errësira ishte aleati i përbashkët i të gjithë delegatëve të këtij kongresi.

Unë vazhdova të ecja dhe pothuaj nuk po mendova për asgjë. Parakaloja dhe më parakalonin delegatë — lakuriqë nate. Një grua (e njoha nga zëri) seç thoshte diçka rrëth qilimave persianë. M'u duk si e zemëruar me dikë. Ndërkohë më parakaluan dy burra. Nuk do t'i kisha njojur nëse nuk do të dëgjoja përsëri fjalët «... djegie të brendshme».

Kolona nëntokësore po grumbullohej në një si punë sheshi. Pëshpërimat tashmë u kthyen në një zhurmë të padurueshme. Nga një altoparlant u dëgjua një zë, i cili njoftonte se pas njëzet minutash do të fillonte kongresi. Prandaj, vazhdoi zëri, delegatët duhej të përgatiteshin menjëherë. «Kabinat janë gati», përfundoi zëri.

Njerëzit filluan të lëviznin në drejtime të ndryshme. Unë nuk dija ç'të bëja, nga të shkoja.

Ndjeva një frikë të vërtetë. Mund të mbetesha i vetëm në mes të errësirës, ndaj pothuaj vrapova pas një grupei që po lëvizte disi më ngadalë se të tjerët. Kur iu afrova e kuptova se ishin të mos shuar. Njëri prej tyre ndaloi dhe u kthye majtas. Unë vetëm dëgjova një zhurmë që më kujtoi hapjen e një porte. Këto duhet të jenë kabinat, mendova më vete dhe vazhdova rrugën. Heshtja ishte vërtet e frikshme, sidomos kur ndërpritej nga zhurma e hapjeve të disa dyerve enigmatike. Pas çdo tre-katër metrave zhdukej një njeri. Vetëm kaq mjaftonte për të të kujtuar filmat e Hickokut. Po nuk pata kohë të mendoja përfilmat sepse një burrë më tregoi një drejtim nga duhej të shkoja. Unë nuk kundërshtova dhe lëviza si i stepur drejt një hapësire pa formë.

Pas disa metrash duart prekën një masë të madhe hekuri, ajo ishte një portë e vërtetë prej hekuri. E shtyva dhe hyra brenda. Mu duk sikur isha përsëri jashtë. Edhe pas kësaj porte sundonte errësirë. Kërkova me dorë çelësin për të ndezur dritën Ishte më tepër një veprim instinktiv sesa i logjikshëm në këto kushte nëntokësore.

M'u kujtuq se në xhepin e majtë të xhaketës kisha shkëpësen. Isha shumë kureshtar të shikoja se ç'ishte kjo dhomë në thellësi të tokës. Po dhe nuk më mbante të bëja dritë. Fillova të lëvizja nëpër këtë dhomë, që zëri i altoparlantit e quajti kabinë, me duart përpara, se mos përplasesha me ndonjë objekt. Dhe vërtet, sapo bëra hapin e parë, duart prekën diçka në formë rafti. Pas disa se-

kondash gjeta një dorezë dhe e tërroqa. Dicka u hap dhe u ndez një dritë e zbehtë që reflektonte në një pasqyrë. Pashë ftyrën time dhe e njoha. M'u duk e çuditshme kjo ndjesi. Po gjithë ai udhëtim në errësirë të bënte të harroje dhe ftyrën tënde. Pas këtij meditimi sytë zunë të mësoheshin me ndriçimin e zbehtë të kabinës; zura të shikoja përreth. Më bënë përshtypje disa pajisje që nuk i kisha parë ndonjëherë dhe që me siguri nuk do t'i shihja përsëri. Nuk dukeshin as si pajisje elektrike, as dhe si mekanike. S'e vrava shumë mendjen, po gjeta një si stol dhe u ula që të merrja veten nga ajo rrugë e vështirë dhe e lodhshme.

Pas pak altoparlanti dha përsëri sinjalin. «Përgatitjet mbaruan, — tha zëri, — të gjithë të nisen drejt sallës!» Dhe delegatët — lakuriqë nate filluan të dilnin nga kabinat e tyre. Dola dhe unë, po një dritë verbuese më miu menjëherë dhe me duart te sytë qëndrova në hyrjen e dhomës enigmatike. Nuk shihja asgjë, pastaj dalëngadalë sytë nisën të më mësoheshin me ndriçimin dhe bëra të ecja në grumbullin e njerëzve. Ishte pothuaj e pamundur të ecje normalisht. Ata nuk ishin më njerëz. Të gjithë ishin përcudnuar në mënyra të për origjinale. Menjëherë më shkoi mendja te veglat e raftit të kabinës. Nisa të ndieja një si frikë nga këta njerëz të përcudnuar. Ja, para meje kaloi një njeri të cilit i mungonte çereku i kokës. Fliste e qeshte me të madhe me një tjetër pa gjysmën e nefullës e thuajse pa hundë. Ndërsa rrotullloja sytë, vura re se të gjithëve u mungonte dic-

ka nga pjesët e fytyrës. U tremba kur mendova se unë nuk i kisha bërë asgjë fytyrës sime. «Me siguri do të më marrin për të çmendur.» Dhe kështu ndodhi vërtet. Më shikonin mua dhe qeshnin e qeshnin me njëri-tjetrin. Mora rrugën për në sallë dhe nxitova të zija vend.

I ulur sikur e mora veten dhe u mësova me pamjet e këtyre njerëzve të gjymtuar, ndonëse ndjeja disi siklet kur mendoja se kush do të zinte vend pranë meje.

Ai që m'u ël pranë ishte një mesoburrë që kishte hequr me shumë elegancë gjysmën e hundës. U mundova ta rikrijoja në mendjen time këtë njëri me hundë të plotë. Po çdo gjë ishte e kotë. Hunga është e rëndësishme dhe përcakton tiparet dalluese të çdo individi. Ndjeva se do të lodhesha tek përpinqesha ta plotësoja fytyrën e fqinjët, i cili nuk ma fishkëlleu në fillim, po më pas ngriu i téri. Rastësisht kishte vënë re fytyrën time të plotë, kishte parë një njeri të identifikuar. U mata ta përshëndetja. Ai vazhdonte të qëndronte i ngurtësuar dhe e ndjeva se, sikur një shekull të qëndronim pranë njëri-tjetrit, ai nuk do t'i përgjigjej përshëndetjes sime. Pas disa sekondash vura re që ai s'po ndihej mirë, sikur donte të largohej.

Dhe pikërisht në këtë çast unë ndjeva që diku e kisha njojur, diku i kisha parë sytë e tij. Megjithëse emrin s'po ia kujtoja. Ndërsa ai natyrisht më kishte njojur dhe ndaj nuk ishte i qetë. Thellë në shpirt më kapi një trishtim i fuqishëm.

— I lirë është ky vend? — ishte zëri i një

gruaje, që ma bënte këtë pyetje në formë kërkesë. Unë nuk thashë as «po» as «jo». Dhe gruaja u ul e qetë pranë meje, sikur të ishte një e njohur e vjetër. I hodha një shikim të shpejtë fytyrës së saj.

I mungonin vetullat dhe një e treta e flokëve, kështu që nuk mund të gjykoje për bukurinë mbittokësore të saj. Në këtë kongres bukuria njerëzore ishte nga gjërat më të pavlefshme. Vecse zërin e kishte të embël e lozonjar. Ajo më pa që po tre goja një lloj interesë dhe më përshëndeti. Edhe unë bëra të njëjtën gjë dhe menjëherë vendosa të hyja në bisedë me të. Në fillim ngurrova disi, jo se ishte femër, po nuk dija ç'lloj bisedash ishin tradicionale në këto kongrese.

— Ju lutem, sa e keni orën? — fola me një lloj pasigurie. Ajo qeshi. M'u duk tepër e shëmtuar. Nuk kisha parë grua apo vajzë të qeshte në atë mënyrë. Ndoshta ndikonte dhe mungesa e flokëve dhe vetullave.

— Po ju duhet ta dini, — foli ajo, — se këtu s'lejohet mbajtja e sahatëve. Gjatë punimeve të kongresit asnjëri nuk e di sa është ora. Është një rregull i vjetër, ndoshta që nga kongresi i parë. A, ju jeni i ri!

— Po, — u përgjigja dhe hodha vështrimin nga salla si për të gjetur ndonjë më të ri se vetja ime.

— Vec kësaj, — vazhdoi bisedën ajo, — ju duhet të jeni dhe i painstruktuar saktë nga komisioni përgatitor.

Nga mënyra se si i tha këto fjalë dhe vështrimi, e kuptova se e kishte fjalën për mosgjymtimin e fytyrës sëmë. Nuk e dhashë vëten dhe i thashë diçka që nuk më kishte shkuar asnijëherë ndër mend.

— Ju kuptoj, kolege, se çfarë doni të thoni, por unë bëj përjashtim nga të tjerët. Në jetën e përditshme, mbitokësore, më mungojnë të dy veshët dhe jam krejt tullac. Kështu që me këtë rast solemn u detyrova të vija pjesët që më mungonin.

— Çudi, bëja be që i kishit tuajat, çudi, — tha ajo.

— Edhe ju nuk dukeni fare një grua e bukur, bile... Vetëm zëri ju tradhton. Natyrisht dhe fus-tani ju shpalos një trup të bukur, — fola unë. Ajo u hoq sikur nuk i bëri përshtypje komplimenti im dhe më tërhoqi vëmendjen të shikoja diku përpara. Disa projektorë kishin ndriçuar një vend në krye të sallës. «Ky duhet të jetë presidiumi», tha-shtë me vete, megjithëse nuk pashtë as karrige e as tavolina. Nuk kaloi shumë kohë dhe në vendin e ndriçuar u ngjitën disa veta me portrete në duar. Gruaja pa vetullat dhe një të tretë e flokëve po ndiqte më një interes të veçantë vendosjen e atyre fotografive. Madje ajo ishtë në një lloj ankthi sikur priste që në ato çaste të ndodhët diçka shumë e rëndësishme. Ndërsa unë qëndrojë krejt in-diferent dhe nuk po kuptoja asgjë se c'përfaqëso-nin ato fotografi në atë kongres shkësësh.

— Nuk e paskan vendosur dhe këtë herë, — tha ajo, pa iu drejtuar askujt. Në fjalët e saj ndi-

hej një keqardhje e dukshme e njëkohësisht intresante për të kuptuar mekanizmin e punimeve të kongresit të shkesëve. Ndoshta ajo priste që të vendosej fotografia e ndonjë të afërmë apo të njohuri të saj. Po të ishte kështu, atëherë unë kisha pranë një person që bënte pjesë në rrethet e larta të shkesëve.

— Mos prisnit portretin e burrit tuaj?

— Jo, — u përgjigj ajo prerë.

— Të babait?

— Jo!

— Atëherë të të dashurit tuaj, — vazhdova unë më tepër për ta ngacmuar. Po në çast ajo u kthyte nga unë dhe më pa me egërsi të vërtetë.

E kuptova që e kisha shkelur. Tamam kur po bëhej gati të fillonte kongresi i shkesëve unë, si pa të keq, përmenda atë fjalë të kobshme e tragjike, e cila qysh në kongresin e parë ishte quajtur e jashtëligjshme. Këtë ma tha dhe ajo. Bile më pas, si një ciceron, filloi të tregonët në një mënyrë krejt kaotike për pasojat e dashurisë së saj të parë dhe të fundit. Që nga ajo kohë ajo vuante nga një pagjumësi kronikë, e në ato raste kur i qellonte ta zinte gjumi, shihte ëndrra të frikshme.

Më bëhet sikur ngjitem në tarracën e pallatit ku banoj e shoh fytyrën e pafajshme të shoqes sime të gjimnazit që, për t'i dhënë fund vetes, hidhet nga katër i pestë i pallatit përballë. Bukuria e saj u vra, u dënuia pa mëshirë nga diçka abstrakte, nga diçka e pakapshme, fluide. Më ngjethet

mishtë, më vjen të bërtas: «Kapeni dashurinë, kapeni, se ajo e vras, kapeni!». Po nuk flas. Askush nuk flet. Flasin më vonë dhe e di ç'thonë: ajo ishte një budallaqe dhe vetëm kaq. Por unë them me bindje se atë e ka vrarë dashuria. Po kush të beson, kush të dëgjon? Në fund të fundit ku ta denoncosh? Ajo është e pakapshme, ajo nuk ekziston. Më çuditni që ju keni guximin të më flisni për dashuri e të dashuruar tani në fund të shekullit të njëzetë. Për mua, dashuria është një mbeturinë primitive e njerëzimit, një ekzotikë tepër e largët, e mijëra vjetve më parë, kur njerëzit nuk kishin me ç'të merreshin, kur nuk ekzistonin mjetet e komunikimit masiv, televizioni, kirëmaja, avionët dhe, në përgjithë, të gjitha zbatimet e motorëve me djegie të brendshme. Sot ajo, dashuria, nuk është veçse një trillim i disa shkrirtarëve imoralë..., e mbylli ligjëratën fqinja. Nuk e zgjata. Jo se nuk kisha kundërargumente, po sepse në sallë papritur ishte vendosur qetësia. Kushedi fjalët e miâ mund tâ bënин tê qeshë gruan pa vetullat e pa një tê tretën e flokëve dhe s'desha tê têrheqja vëmendjen e të tjerëve.

Por ajo nuk kishte ndër mënd tê qeshë. Diskush kishte marrë fjalën. Nga zëri duhej tê ishte grua. Fliste me zemërim, me ton shumë tê lartë. Ishte larg dhe nuk dalloja dot se ç'pjesë e fytyrës i mungonte. Ajo filloi tê pyeste me ngulm kongresistët pse në sfond (që unë e quajta presidium) mungonte një fotografi e cila për vite me radhë kishte qenë në vendin e nderit. Folësja nuk ishte

aspak dakord me këtë vendim të komisionit përgatitor. Fqinja ime e dëgjonte me vëmendje, po me një përcëmim të dukshëm. — Kjo ka rrjedhur fare, — tha pa iu drejtuar askujt — gjithë jetën arkaik e primitiv mbeti ky zë. Ka disa kongrese rresht që kërkon të vendoset fotografua e shpikësit të qilimit me lesh.

— Ah! Nuk është fjala për ndonjë shpikës të qilimit fluturues, — ndërhyra unë me një naivitet të shtirë.

— Jo, mor vëlla, — vazhdoi fqinja ime me një zë të lodhur, — të qilimave që kanë qenë shtruar në të gjitha shtëpitë e botës. Me shumë të drejtë ajo fotografi u hoq, sepse nuk kishte kuptim të qëndronte në krye të kongresit tonë, kur sot janë në modë dhe në përdorim të gjerë tapet sintetike.

Ndërkaq gruaja e qilimit ishte ulur dhe fjalën e kishte marrë një burrë. Ishte pikërisht zëri i atij që më kishte kallur datën me të qeshurën e fuqishme. Nuk mund ta merrja me mend se si një njeri me gjysmënofulle mund të qeshte e të fliste aq lirshëm. Fqinja u përqendrua e tëra për të dëgjuar fjalën e atij që fliste, i cili po shpjegonte gjerë e gjatë se kishte ardhur koha që kongresin e shkësëvë ta mëderonte edhe portretin i autorit të shpikjes së motorit me djégie të brendshme.

Inxhinier është ky që flet? — pyeta kongresisten që kisha pranë.

— Më duket se është një nga doktorët e shkencave teknike që flet pothuaj në çdo kongres.

Por ndoshta edhe gabohem. Rëndësi ka që edhe fotografia e shpikësit të motorit me djegie të brendshme do të vendoset përfundimisht në presidiumin e kongrëseve tona.

— Çdo gjë është e qartë, — thashë pothuaj me vete, dhe fillova të vështroja me radhë fotografitë që ishin vendosur në presidiumin pa njërej të këtij kongresi. Fytyrat e tyre ishin të qeta, të pagjymtuara. Asnjë shenjë shqetësimi nuk vërehej në portretet e shpikësve të mëdhenj. Pikërisht kjo gjendje i bënte këta viktima të një komploti shumëvjeçar të përgatitur me kujdes. E megjithatë ata nuk e dinin se ku ndodheshin dhe çfarë funksioni po kryenin në këto çaste dhe për çfarë qëllimesh po përdorej fama e tyre e ngri-tur nga përpjekje mbinjerëzore.

Në sallë shpërthyen duartrokositjet. Me shumicë votash portreti i shpikësit të motorit me djegie të brendshme kishte fituar të drejtën për t'u vendosur në presidiumin e nderit. Seanca e parë e kongresit kishte përfunduar dhe të gjithë u ngri-tën për të bërë një pushim të shkurtër. Unë nuk lëviza nga vendi. Salla u boshatis. Mbylla sytë dhe kisha dëshirë të mos i shikoja ato drita shumëngjyrëshe që ndriçonin sallën e këtij kongresi shkesësh. Po nga sytë nuk më shqiteshin portretet e shpikësve të mëdhenj. Papritur më shkrepi një mëndim. Fillova të kërkoja një telefon.

U ngrita nga karrigia dhe fillova të ecja drejt portreteve. Më kishte lindur një dëshirë krejt e çuditshme e njëkohësisht absurde: desha të flisja

me fotografitë, desha t'u tregoja atyre se edhe ata ishin të gjyntuar, të përcudnuar si gjithë delegatët e këtij kongresi. Por ama nuk kishin faj. Domosdo që nuk kishin faj.

Nuk dëgjova asgjë se ç'u tha në seancat e mëpasshme të kongresit të shkesëve derisa ai i mbylli punimet e tij. Delegatët, pas rivedosjes së pjesëve të hequra përkohësisht nga kokat e tyre, përsëri në errësirë të plotë po ngjitejshin për në sipërfaqë të tokës, me kënaqësinë se kongresi i tyre i ardhshëm do të zhvillohej treqind metra më thellë për t'i ngjarë gjithnjë e më shumë lakuriqëve të natës.

SHËTITJET NË PARK

Ai nuk po merakosej se po vonohej, megjithëse kishin kaluar dhjetë minuta nga ora e takimit të përditshëm. Në vend që të shpejtonte hapat, Safeti përpinqej si e si të vonohej. Madje u habit kur kuptoi se nuk ishte edhe aq e lehtë të ngadalësoje hapat dhe ta zgjatje rrugën me qëllim. Kishte menduar se vetëm gjetja e rrugëve të shkurtra dhe pëershpejtimi i ritmit të ecjes kërkonin mund. Po, përfat të keq, atij po i shteronin variantet e shkaqeve për t'u vonuar gjithsesi. Safeti këtë e quante vonesë me dinjitet dhe të arsyeshme, pavarësisht se njeriu që priste mund të mërzitezj. Ai ecte midis pemëve të Parkut të Madh i ngazëllyer se diku në një stol e pristë një njeri, i cili në këto çaste, pa dyshim. ishte duke menduar vetëm për Safetin dhe për askënd tjetër në bëtë.

Safeti ecte dhe përfytyronte lëvizjet e shqetësuara të tjetrit, që herë ngruhej, herë shihte orën, duke e lodhur trurin për të gjetur shkakun e vonesës. Vërtet do të ishte shumë interesante, mendoi ai, të dija se çfarë ndien në këto minuta shoku Filip. Dje, për shembull, i kishte vajtur mendja se mos isha sëmurë papritur. I poshtri, të vdekja ime e ka mendjen! Përse nuk i shkon mendja te një gëzim apo sukses i papritur? Edhe ato të pengojnë, të vonojnë. Ç'them dhe unë, ku ka gëzime dhe suksese të papritura. Të këqijat vijnë papandehur, të mirat i pret me vite e madje edhe mund të mos vijnë.

Safeti ndaloj sepse për pak po arrinte te vendi i takimit. Pa orën dhe sytë i shkëlqyen që akrepit po i afroheshin dhjetë e njëzetës. Asnjë ditë tjetër nuk qe vonuar kaq shumë. Njëzet minuta. Safeti ndjeu se ishte i aftë për të përballuar edhe gjendje të tillë ngadhënjimi mbi vetveten. Prandaj u kthye majtas dhe nisi të ecte, në mënyrë që të largohej më tepër nga vendi i takimit. Po, pasi bëri disa hapa, vendosi të blinte një arançatë. Etja është një argument i mjaftueshëm për të justifikuar gabime të mëdha dhe jo një vonesë të rëndomtë prej disa minutash, arsyetoi ai me vete.

Ndërkaq kishte arritur te pika e shitjes së arançatave.

— Me gjithë shishe, — tha prerë Safeti duke nxjerrë paratë nga kuleta.

— Si të doni, — iu përgjigj shitësi, duke he-

qur tapën. — Ju jeni i pari klient që po blini sot. Shpresoj të jeni me shans.

Safeti ia nguli sytë shitësit.

— Unë me shans? C'do të thotë kjo? Pse jeni supersticioz ju në këtë moshë?

— Jo, xhaxha! Unë jam ateist i kulluar, por e thashë ashtu kot, për të ndërruar muhabet.

— Hë, të lumtë! Se nuk i shërbehet popullit duke mbajtur shpresën te shanset mikrobor-gjeze.

Djali qeshi lehtë, si për të miratuar fjalët e klientit të tij dhe uli kokën te banaku. Safeti u largua me arançatën në dorë. Shishja nuk qe aq e ftohtë dhe ai deshi të kthehej për t'ia bërë këtë vërejtje, por e mbajti veten. Nuk ua kishte ngenë punëve të tilla në këto çaste kur duhej të arrinte te shoku Filip. Pa orën dhe u qetësua që kishin kaluar vetëm pesë minuta. Papritur, se nga i mbiu një dyshim se mos shoku Filip qe larguar. Ka duruar sa ka duruar dhe mund të ketë ikur. Atëherë nuk do të kishte kuptim gjithë ky ecejak nëpër Park. Veç të tjerash, Safeti do të ishte i detyruar ta kërkonte shokun Filip në rruginat e Parkut, si dikur në korridoret e dikasterit apo në kafenetë e qytetit.

Kjo rrjedhë imagjinare e ngjarjeve e tronditi disi. Sot nuk duhej të ndodhë kurrsesi kështu, prandaj nxitoi hapat, si i frikësuar, nëpër një rruginë që i binte më shkurt.

Kur arriti në një si vend të sheshtë, ai i ngadalësoi hapat, sepse diku afër ishte vendi i

tákimit. U fut midis dy pishave të mëdha me vështrim të përqendruar. Pas pak çasteve ai, pa shokun Filip, që, ulur në stolin e zakonshëm, lexonte gazetën. Safeti u clirua nga ai ankth që e pushtoi befas, kur mendoi se mund të kishte ikur shoku Filip. Në fund të fundit edhe po të kishte ikur atij nuk do t'i prishej asnje punë. Megjithatë nuk guxoi t'ia thoshte vetes këtë se pastaj duhej të arsyetonte e arsyetimi jo gjithmonë është i dobishëm dhe të nxjerr në krye. Gjërat më të rëhdësishme të njeriut bëhen me intuitë, tha me vete Safeti, duke u ulur në një stol aty pranë.

Që andej dukej qartë shoku Filip. Safeti nisi ta pinte me shumë ëndje arançatën. Pas çdo gllënjkë i hidhte një vështrim ngadhënjes shpinës së shokut Filip dhe nuk po e ndiente se arançata tashmë qe bërë si një çaj i vákët. Po nuk kishte rëndësi cilësia e arançatës, ajo në këtë rast ishte vetëm një pretekst dhe asgjë më shumë.

Pa orën. Tani nuk kishin dhe aq rëndësi minutat, sepse shoku Filip ishte atje dhe ai në çdo çast mund të kontrollonte lëvizjet e tij. Ktheu edhe një gllënjkë e u ndie shumë mirë në këtë pozicion dominues.

Ju, shoku Filip, mund të jeni duke menduar se unë jam i sëmurë, në shtrat, tha me vete Safeti, jo, shoku Filip, nuk jam hiç sëmurë, bile jam shumë mirë me shëndet. Duhet ta dish se asgjë nuk më ka penguar të vij te ti në orën e caktuar. Eh! Shoku Filip, me siguri që ke nisur të mërzit-

tesh ca, po s'ke ç'i bën. Hë, si thua, a të pi dhe një gllënjkë nga kjo pije e mrekullueshme? E, nuk besoj të kesh kundërshtim. Por edhe po pate nuk ka asnje vlerë. Ju tani jeni i paaftë të më pen-goni. Kjo është gjithë çështja. Paratë janë të mi-at, arançatat të shtetit, goja dhe stomaku po të miat. Pra, me fjalë të tjera, sapo të pimë këtë pije, do të vijmë dhe te ti, o shefi im në pension. Kam mendimin se pret puna. As mbledhje kemi, as ndonjë konsultë, as ndonjë material për të përgatitur. Thjesht kemi shëtitje, ose më saktë qetësim nervash. Për të gjitha këto nuk ke arsyë të shqetësohesh apo të alarmohesh, siç bëre dje në mëngjes. Ju e dini që unë për njëzet vjet rresht asnjëherë nuk jam mërzitur duke të pritur me orë, muaj e vite. Sa kohë të dëshironit ju atë-herë.

Shoku Filip as që mund ta mendonte se diku prapa shpinës së tij ishte Safeti duke pirë arançatë. Disa herë kishte vendosur të ngrihej e ta niste shëtitjen vetëm, po kishte ndërruar mendje. Jo për hatër të Safetit, po sepse nuk mund të shëtiste vetëm. Vëtmia për të ishte gjëja që e mërziste gjer në brengosje, sidomos në një pyll të dendur me pisha të mëdha. Pikërisht midis këtyre pemëve ai e pati takuar Safetin për herë të parë pas daljes në pension. Qe habitur dhe njëherësh qe gëzuar që edhe ai, Safeti, i kishte qejf shëtitjet në ajër të pastër. Në përfytyrimin e tij ishte fiksuar vetëm portreti i zyrtarizuar, me një dosje në dorë dhe me atë ecjen e ngadal-

të e të shtruar. U çudit atëherë me entuziazmin që shfaqi kur e takoi së pari Safetin. Megjithatë pas dy-tri takimesh ndjeu se edhe me të mund të bisedoje, mund të shëtitje i qetë nëpër pemët e Parkut të Madh.

Shoku Filip pa edhe një herë orën. U çudit, prandaj mendoi të shkonte deri te birraria lart, të merrte në telefon dhe të sqaronte gjithçka. U ngrit po pa bërë tre hapa dëgjoi zërin e Safetit që e thërriste. Ktheu kokën dhe pa Safetin që po ekte ngadalë drejt tij. U habit që ai po shfaqej nga ajo anë, megjithatë u lehtësua në njëfarë mënyre dhe nisi të ndiqte si i ekzaltuar ecjen e ngadaltë të Safetit, duke menduar mos ishvartësit i kishte ndodhur ndonjë gjë. «E ai përsëri, sepse ia njoh tipin, nuk ka ngurruar të marrë rrugën drejt vendit ku e prisja unë»...

— Hyr!

— Mirëdita, shoku zëvendësministër!

— Ke ardhur për materialin?

— Po.

— Pse, fani vihet? Ke orë ti?

— Shoku Filip, po mua tani më lajmëruan, sepse isha në sekretari për të firmosur disa shkresa që do t'i nisim...

— Mjaft! Nuk dua të dëgjoj asnjë justifikim! Dilni jashtë dhe do të përgjigjeni për këtë shkelje. Morët vesh. Ikni tani!...

Ai nuk ishte i sigurt se mund të kishte ndo-

dhür pikërisht kështu me Safetin. Mbase mund të ishte një rast që lidhej me dikë tjetër. Sidoqoftë ai e vlerësoi si të gabuar sjelljen e vet në çdo kohë që mund të kishte ndodhur ajo. Safeti nuk mund të akuzohej për indisiplinim. Eh! Si kalonë vitet, tha me vete Filipi, fluturimthi. Nuk të besohet se ky është ai Safeti i djeshëm, ai Safeti që ishte i gatshëm të të jepte çdo lloj informacioni për sëktorin që mbulonte. Interesant. Ka të njëtin fizik. Ë mban veten, qerratai. Vetëm se është bërë pak demibel. Nuk ka qenë kështu, jo. Ore, vërtét ta kem nxjerrë jashtë ndonjëherë këtë njeri. Nuk e besoj. Eh, Safet! Mosha bën të vëtën, po me sa duket nuk e kuptojmë, ose edhe kur kuptojmë bëjmë sikur nuk e kuptojmë. Sa i rregullt ka tjenë ky njeri. Vërtet të ketë ndodhur ta kem nxjerrë jashtë nga zyra këtë njeri?

Safeti po afrohej me një hap të ngadaltë, i bindur se ish-shefi nuk do t'i thoshte as gjysmë fjale për vonesën. Disa metra pranë ngriti kökën dhe dalloi fytyrën e mprehtë të shokut Filip dhe u drodh lehtë. U kujtua se po kjo fytyrë vite më parë për të kishte qenë krejt gjë tjetër. Ajo atëherë i dukej ndryshe nga kjo e sotnja. Safeti ngriti dorën dhe pa pér herë të fundit orën. Akrepat kishin ecur si jo më mirë. Ai mendoi se tanë kishte ndryshuar sistemi i matjes së kohës. Tashmë nuk kishte rëndësi në ishte e shtunë apo e hënë, e martë apo e diel, janar apo guşt; tashmë nuk përdoreshin minutat, orët, javët dhe muajt pér të matur kohën. Shahatet që mbanin ai dhe shoku Filip qenë

formalë ose vëtëm për të ruajtur një zakon të vjetër, tradicional, sepse ata nuk kryenin asnjë funksion real. Për të gjitha këto arsyeshoku Filip nuk kishte pse të mërzitez për atë gjysmë ore që natyrishit nuk kishte asnjë vlerë reale.

— Mirmëngjes, — përshëndetë ftohtë Safeti, duke u ulur në stol. Shoku Filip e ndoqi me sy pa ditur së çfarë të thoshte.

— Mirmëngjes, — ia ktheu duke e parë në sy ish-vartësin e vet, i cili, shumë i qetë, me një shkop nisi të hiqte baltën nga këpucët.

— Ore Safet, përsë erdhe nga ajo anë? — pyeti papritur Filipi.

Safeti nuk e ngriti kokën dhe vazhdoi të merrje me thërrimet e baltës në këpucën e majtë. Pyetja e tjetrit nuk ishte pa logjikë, megjithatë kjo nuk do të thoshte se ishte e drejtë. Jo çdo gjë logjike është e drejtë, mendoi Safeti.

— Ashtu është, shoku Filip, sot erdha nga mbrapa, por m'u duk sikur është më shkurt t'i biesh andej, — u përgjigj Safeti me një shkujdesje të tepruar. Filipi hapi sytë nga çudia.

— Çfarë thua, Safet? Andej nga ke ardhur është dy herë më e gjatë truga.

— Jo ç'ne! Mua m'u duk shumë e shkurtër.

— Safet, mos të është prishur ora?

— Jo, shoku Filip, orën e kam fare në rregull. Përsë të shkoh mendja për keq?

— Ore Safet, se si më duke sh sot. Mos ke

qenë gjë sëmurë? — pyeti me një zë të brishtë Filipi, duke u ulur dhe ai në stol.

— «Ja te sëmundja ime e ka mendjen. Bëri ç'bëri aty doli», mendoi Safeti i nervozuar.

— Unë i sëmurë? Jo, më mirë se sot nuk kam qenë ndonjëherë tjetër. Pse, mos të dukem gjë i sëmurë?

— Jo, nuk po dalloj ndonjë shenjë të veçantë, por po të pyes sepse u vonove si shumë sot. Paştaj, nuk jemi të rinj, gjithçka mund të na ndodhë, apo jo?

— Ashtu është, nuk jemi më të rinj. Kjo më vjen gjithmonë ndër mend kur ju shikoj ju, shoku Filip, — tha Safeti duke qeshur lehtë.

Pas një pauze të shkurtër Safeti foli shpejt dhe disi me shpërfillje:

— Do të viaj në kohë, shoku Filip, por atje lart piva një arançatë të freskët. Mirë bëra, besoj?

Filipi u ngrit nga stoli tejet i tronditur, kur dëgjoi shkakun e vonesës së tjetrit.

Eci rrëth njëzet minuta pa folur, në shenjë proteste për vonesën e pamotivuar të Safetit, i cili, duke ecur, nuk harronte herë pas here të vështronë profilin e ish-shefit të tij. Shpesh habitej se si ndodhej kaq pranë, se si dëgjonte frymëmarrjen dhe hapat e tij. Nganjëherë në këto shëtitje harronte se kishte dalë në pension këtu e katër vite të shkuara. Ndoshëta kjo vinte nga që shoku Filip e takonte pothuaj çdo ditë, bisendonte me të dhe ai nuk kishte ndryshuar shumë

nga pamja e jashtme. Vishej njëlloj, si kur ishte zëvendësministër, me të njëjtën pardësy gri, e cila, kur qëndronte varur në korridorin e dikasterit, të bënte të ulje zërin e të ngadalësoje hapat. Safeti nuk harronte se si një herë qe ngri-tur nga karrigia kur kishte dëgjuar në korridor të bërtiturën e shokut Filip. Dhe tani ky njeri ecte pranë tij, me të njëjtën pardësy, madje me të njëjtën kollare, në një pyll me pisha të bukura, ku zogjtë cicëronin e fluturonin mrekullueshëm... E gjithë kjo Safetit i dukej si një përrallë shumë romantike, që ia ngatërronte disi përfytyrimin për të kaluarën dhe të sotmen. Safeti ndiente se po jetonte dy kohë njëkohësisht.

Kur i tha së shoqes se shoku Filip i kishte propozuar të shëtitnin bashkë për cdo paradite nga Parku i Madh, ajo nuk pati treguar ndonjë interes të vecantë, po kishte vazhduar qetë të lante piatat në lavapjatë. Safeti kishte ngulur këmbë gë ajo të thoshte dëcka për atë lajm, që, sipas tij, ishte me rëndësi sepse vetë shoku Filip i ishte lultur atij dhe jo ai. Tani e gjeti shoku Filip të shoqërohet me ty, qe përgjigjur ajo me shpoti. Safeti nuk e kishte duruar këtë dhe i kishte thënë së shoqes se shoku Filip dhe gjithë dikasteri e kishin respektuar gjithmonë për punën e tij. Për këtë flisnin gjithë ato fletë lavdërimi, dhe dy dekoratat. Atëherë e shocja, Manushaqja, nuk kishte folur fare, po vetëm sa kishte vënë buzën në gaz. Kjo e kishte tërbuar fare Safetin, që në hakërrim i kishte thënë se ajo nuk merrte vesh nga punët shtetërore...

Safeti nuk kishte duruar dhe kishte vajtur të flinte që në orën tetë.

— Me shije i kanë punuar këta stolat, apo jo, Safet? — foli pas një heshtjeje të gjatë shoku Filip.

— Çfarë thatë, shoku Filip, se nuk e kisha mendjen, — tha me një mospërfillje të shtirur Safeti. Filipi ndali dhe me një buzëqeshje të lehtë tha:

— Je bërë pak meditativ kohët e fundit. Ka filluar të të rrëmbejë natyra.

— Ah, jo, shoku Filip. Nuk kam vuajtur asnjëherë nga kjo sëmundje, — tha me një zë të ngritur, sikur e akuzuan pér ndonjë faj.

— Safet, e kisha fjalën pér stolat. Mua më duket se i kanë punuar me shije, apo jo?

— Aa! Stolat. Mirë, mo, mirë, po mund të bëheshin shumë më mirë. Me një fjalë mendimi im është se i kanë punuar çka.

— E mira nuk ka fund, por unë mendoj se dhe kështu i kanë punuar shumë mirë, sepse e kanë shfrytëzuar me kulturë traditën tonë të punimit në dru.

— Pse, traditë e quani këtë, shoku Filip? Një mjeshtër i punës me dru, po të shikonte, pér shembull. atë stolin atje, do të gajasej së qeshuri. Pastaj ngjyrë është kjo?

Filipi ndali në vend dhe nuk po dinte si t'i përgjigjej më tej ish-vartësit. Megjithatë nuk e pa të arsyeshme ta vazhdonte këtë diskutim pasi ishte i Sigurt se Safeti përsëri dō ta kundërshtonte.

Atëherë mendoi më mirë të mos fliste, iu kujtua një artikull i gazetës së ditës, më saktë autor i tij, që, edhe pse dukej i njojur, nuk po e kujtonte dot.

— Ore Safet, e njeh këtë Astrit Kleon? Ka shkruar një artikull në gazetë për dikasterin tonë, po nuk më kujtohet ku e kam hasur emrin e tij.

Safeti ndali hapat dhe e pa vërtet me dyshim tjetrin.

— Po më habitni, shoku Filip. Vërtet nuk e mbani mend? Astrit Kleoja është ai djali që punon në sektorin G, është dhëndri i shokut Paschal, — tha Safeti duke e parë drejt në sy Filipin.

— Ah, po, tani më kujtohet. Ku mbahen mend të gjitha, Safet... Po e ka shkruar shumë mirë artikullin. Edhe atëherë, Safet, ai djalë premtonte, apo jo?

— Nuk e di se çfarë ka shkruar sot në gazetë, po di se ka qenë një rryp që s'merrte vesh nga asgjë. Të gjithë e tallnin, kuptohet, prapa krahëve.

Filipi hapi sytë nga ky përcaktim i çuditshëm i Safetit. Mbase ishte hera e parë që e dëgjonte fjalën «rryp» në këtë përdorim. U tendos i téri dhe për pak çaste iu kujtua gjithçka:

— Ore Safet, si flet kështu ti, pa përgjegjësi, për njerëzit, për kuadrot? Ore, po harrove që ti vetë e propozove, bile me shkrim, që ai djalë të vinte si specialist në dikaster? Hë, fol!

Safeti ktheju kokën me rrëmbim nga Filipi.

— Astrit Kleoja erdhi në dikaster jo se e propozova unë, po sepse ishte dhëndri i shokut Paskal. Prandaj nuk e mbanit mend emrin e tij dhe u kujtuat apo ju kujtova se është dhëndri i shokut Paskal.

Filipi mbeti disa çaste si i topitur nga fjalët e tjetrit. U habit shumë nga vrulli me të cilin i tha ai këto fjalë dhe thellë ndjeu një boshllék.

— Safet, seriozisht flet, — shqiptoi duke mbyllur pakëz qepallat me një ndjenjë çudie të hapur.

— Po, shoku Filip. Unë me shokun Paskal nuk kisha asnjë lidhje dhe interes. Ju po.

Filipi u ngrit nga stoli. Edhe Safeti bëri të njëjtën gjë, si për të ekuilibruar gjendjen. Filipi ndjeu se ishte shumë i nervozuar, si në ato mbledhjet e dikurshme dhe nisi të ecte poshtë e lart nëpër rruginë me hap disi të shpejtë, pa ditur se çfarë të bënte. Ishte i bindur që Safeti diçka kishte, po s'po e kuptonte se me kë. Përse duhej ta komentonë në atë mënyrë ardhjen e Astrit Kleos në dikaster?

Pas pak shëtitja do të përfundonte. Ata nuk mund të ndaheshin pa i folur njëri-tjetrit, prandaj Filipi mendoi të hapte një bisedë që, sipas tij, nuk mund të ngjallte kundërshtime, zënka, diskutime.

— Kohë e bukur sot, apo jo, Safet? — tha ai me përtesë, duke i lënë të nënkopuntonte tjetrit se këtë nivel bashkëbisedimi mérítonte. Safeti

nuk foli menjëherë. Bëri disa hapa dhe, me një shkujdesje të hapur, duke mbledhur buzën dhe rrudhur mjekrën, tha:

— E, mo, se sështë ndonjë kohë kushedi se çfarë; bile, do të thosha, hiç e bukur. Ose më saktë sot është një kohë e shëmtuar.

Filipi ndali në vend duke parë me shumë çudi bëashkëbiseduesin. Pastaj ngriti kökën lart dhe pa edhe një herë diellin që ndriçonte pemët e Parkut të Madh. Edhe Safeti kishte ndalur duke ndjekur lëvizjet e shokut Filip.

— Ore Safet. Je në vete, apo jo? A nuk e shikon që sot është një ditë e mrekullueshme; që sot është një diell i shndritshëm dhe një ajër i pastër? — tha Filipi me një zë të ashpër. Safeti ndjeu një dridhje thëllë në shpirt nga timbri i zërit të tjetrit, që që ndryshuar papritur, duke i kujtuar të kaluarën, si dikur, pikërisht si atëherë, kur ai ishte ngritur pa vetëdije nga karrikia.

Për një çast Safeti nuk e dalloi dot se cilës kohë i takonte ajo e dridhur, së tashmes apo së shkuarës, po gjithsesi mendoi se kjo nuk do të ndodhë kurrë në të ardhmen.

— Unë nuk jam aspak dakord që sot është një ditë me ajër të pastër, — u përgjigj shumë qetë Safeti, me një qëndrim disi krenar.

— Nuk e di nga nisesh ti, Safet, që thua se ajri sot nuk është i pastër. Të them të drejtën nuk po ngopem dot me këtë ajër të pastër pi-shash:

— Këtu e kam fjalën dhe unë, Filip, sepse

mushkëritë, të mia u bën dëm ajri i pishave. Se, dihet, gjërat janë relative. Ju mendoni shumë ngushtë, vetëm për mushkëritë tuaja, po janë edhe mushkëritë e miliarda njerëzve që marrin frymë në këto caste. Nuk do të thotë aspak, që kur kënaqen mushkëritë e njërit me një lloj ajri, të kënaqen edhe të të tjerëve domosdo.

— Mirë, o Safet, ti ke mendimin tënd dhe unë nuk dua kurrsesi të të imponohem. Është e drejta jote të marrësh frymë me ajrin që të pëlqen, — tha me ngadalë Filipi duke menduar me keqardhje se sa absurde qenë shpjegimet e Safetit.

— E shikon, o Filip, që dole te fjala ime.

Po papritur i erdhi ndër mend se për herë të parë në jetën e tij e kishte thirrur ish-shefin thjesht Filip. Po, vetëm Filip, as më shumë e as më pak. «Si arrita ta bëja këtë?» — tha me vete dhe sikur u qetësua nga ai shqiptim i lirë shkronjash.

«Filip, Filip, Filip», përsëriti dhe mori frymë thellë. Qenka shumë e thjeshtë, Filip; qenka vërtet shumë gjë e lehtë, Filip, qenka dhe jastëzakonisht e këndshme, Filip. Si nuk më ka vajtur mendja më parë? Çudi, shumë çudi, mendoi Safeti duke ndier një lloj dehjeje, Filip... ej, Filip!

— E, mor Filip, mos u mërzit, kështu e kanë këto punë. Filip, e myllim për sot. Kur do të takohemi nesër, Filip? — tha Safeti me një zë të fortë duke i dhënë dorën tjetrit.

— Si zakonisht, në orën dhjetë te Pisha e Madhe, — tha Filipi shumë i çuditur.

— Atëherë, mirupafshim nesër në mëngjes, Filip. Dhe shiko, Filip, mos u bëj merak po u vònova nesër. Nuk më gjen gjë mua, Filip. Jam ende i fortë, Filip. Mos harro, bëju të gjithëve të fala nga ana ime, Filip. Kështu, nesër në orën dhjetë, Filip. Filip, drekën e mirë! — përfundoi Safeti. Ai e njohu atë zë të vëçantë. Ishte zëri që atë mbrëmje i kishte thënë me rreptësi: «edhe kur ishte zëvendësministër shoku Filip dilte pas-diteve shëtitje, por asnjëherë nuk të tha eja, o Safet, të dalim bashkë.»

Filipi u largua tejet i habitur nga sjellja e tjetrit dhe mendoi se Safeti patjetër duhej të vizitohej.

Por asnjë kontroll mjekësor nuk mund ta vinte re se te Safeti diçka ishte thyer. Shkronjat, që prej shumë vitesh kishin formuar me disiplinë të rreptë emrin e ish-shefit, nuk donin të bashkoheshin me njëra-tjetrën. Atc qenë larguar në mënyrë krejt të çregullt në drejtime të panjohura. Mirë po Safeti kishte dëshirë ta shqiptonte emrin e ish-shefit, ndërsa shkronjat lëviznin përsëri, duke krijuar kombinime të çuditshme dhe të pakuptueshme për vetë Safetin. Lifip... Flpi... Iflip... Ilkip... Pilfiip... Ilkipflipippi-flliii...

Safeti ndali në vend. Shkundi kokën dhe krejt trupin. Shkronjat sikur u qetësuan dhe nga dalë nisën të zinin vendet e zakonshme. Mekaniz-

mi i vjetër rinisi të punonte dhe Safeti mund ta shqiptonte sa herë të donte emrin e ish-shefit të tij, pa asnje lloj reverence, pa asnje lloj drujtjeje. I vinte të thërriste me sa fuqi kishte mënë mes të Parkut, le ta dëgjonin të gjitha pishat e Parkut, më mes të rrugës, le ta dëgjonin të gjithë kalimtarët, më mes të lagjes, le ta dëgjonin gruaja dhe gjithë qyteti. Pra ai kishte një dëshirë të jashtëzakonshme të thërriste kudo me të madhe Fililiipp...

DYQANI KU BLEJNË TË GJALLËT DHE TË VDEKURIT

Isha i treti. Pas meje prisnin në radhë edhe dy të tjerë. Sezoni i domateve të freskëta sa kishte filluar dhe njerëzit nxitonin për të blerë. Shitësja kishte qëlluar e shkathët, kështu që, me sa dukej, nuk do të vonoheshim. Po çdo gjë e prishi një grua që erdhi me nxitim dhe, pa përfillur askënd, i tha shitëses:

— O Leta! Më jep një kilogram domate pa radhë se po vij nga varrezat.

— Nga varrezat! — tha shitësja e cuditur dhe e ndërpreu punën. Të gjithëve ua tërhoqi vëmendjen fjala «varrezë» e thënë ashtu në një dyqan zarzavatesh, madje një burrë i moshuar, që rrinte pas meje, u trondit aq shumë, saqë më pyeti:

— Kush ka ardhur nga varrezat?

— Një grua e gjallë, xhaxha, ka ardhur nga varrezat dhe kërkon të marrë një kilogram domate pa radhë, — iu përgjigja unë.

— Aa, — bëri plaku me një ndjenjë lehtësimi, sepse e dinte që nuk mund të ngrihej i vdekuri nga varri për të blerë domate.

Burri që ishte para mejë ishte i vendosur për ta kundërshtuar gruan e varrezave dhe, si për t'i vënë vulën, tha:

— Dëgjo, moj shoqe, edhe nga varri të jesh ngritur, sot nuk merr pa radhë. More vesh! Të tepërt e kemi kohën ne të tjerët?

— Nuk qenkeni hiç të njerëzishëm. Mirë me mua, po të paktën respektoni të vdekurit! — tha gruaja e varrezave me një ton disi filozofik dhe pa nga ne të tjerët si për të shijuar efektin e fjalëve.

— C'punë kanë të vdekurit këtu, moj shoqe! Ne, siç e sheh, jemi të gjithë të gjallë.

Përgjigjja e burrit që qëndronte para mejë e nervozoi gruan e varrezave. Midis tyre nisi një dialog i ashpër dhe me pasoja për ne të tjerët, që prisnim të mbaronte kjo përleshje pakuptim; sepse shitësja rrinte si e shastisur, duke parë herë njérën palë, herë palën tjeter, pa ditur ç'të bënte. Edhe unë, si të tjerët, e kisha vështirë të mbaja ndonjë qëndrim të prerë. Bile thellë ndjeva sikur doja ta ndihmoja gruán e varrezave, sepse nuk kisha dëgjuar ndonjëherë një pretekst kaq origjinal për të marrë pa radhë. Mbështetje ajo ka të drejtë. Ma do mendja asnjëri prej

nesh, që jemi në rdhë, nuk e ka provuar të vijë nga varrezat drejt e në dyqanin e fruta-perimeve. Kushedi se çfarë ndien njeriu në këso rastesh.

Gruaja e varrezave dhe burri para meje vazduan të jepnin e të merrnin me njëri-tjetrin.

— Ç'bëhet aty nga fillimi? Përse nuk po ecën radha? — pyeti plaku prapa meje.

— Një grua kërkon të marrë një kilogram domate pa radhë, sepse...

— Po le të marrë, së nuk u bë kiameti.

— Xhaxha! Është ajo gruaja që ka ardhur nga varrezat, kështu që...

— Akoma nuk ka ardhur nga hëna! Le t'i marrë ato domate se po digjemi në diell! — tha plaku, me kokën e ulur sikur fliste me vete.

— Si thatë, të vete prapa diellit unë? — u hodh gruaja e varrezave duke m'u drejtuar me gisht mua. Ajo më kishte ngatërruar me plakun, por unë nuk iu përgjigja, mbështetës i gjithë sëmundjes së dëshmit. Dikush nga gratë foli:

— Punë e madhe se ke ardhur nga varrezat, po ne që vijmë nga puna?

— Si guxoni e flisni kështu, moj shoqe? Po varrezat janë një vend i nderuar, sepse aty do të vemi të gjithë, pa përjashtim. Edhe ju që flisni në këtë mënyrë. Pastaj gjyshja ime ishte shumë e mirë, po q'ë do që vdiq si sot e tri vite të shkuara. Nuk është asgjë njeriu i shkretë, jo. Sot je, nesër nuk je. Kështu i ndodhi dhe gjyshes sime. Një ditë para se të vdiste ishte gjallë. Pas-

taj të nesërmen vdiq përnjëherësh, duke na lënë
në pikëllim të patreguar të gjithëve. Ja dhe ta-
ni mua po më dalin lot!

Gruaja e varrezave nisi të qante vërtet. Si-
tuata u ndërlikua pak, sepse edhe gruaja që ish-
te e para në radhën e grave u përlot dhe, duke
mos e përmbajtur veten, tha:

— Të rroni vetë, bashkë me fëmijët dhe burrin!

— Falemnderit. Edhe ju të më rroni me ç'tju
dojë zemra!

— Të rroni vetë! — tha burri i parë në ra-
dhë, i cili, me sa duket nga halli, nuk mund të
bënte ndryshe. Burri që ishte i dyti bëri sikur
nuk po merrte vesh se çfarë po ndodhë. Ai e
afroi kokën pranë meje dhe më tregoi se gruaja
e varrezave ishte vajzë e pamartuar, domethënë
se nuk kishte as burrë e as fëmijë. Unë s'fola,
përderisa ajo vetë pranoi t'i rronin fëmijët dhe
burri, që s'i kishte patur kurrë.

— C'bëhet aty nga fillimi? — pyeti përsë-
ri plaku prapa meje.

— Po qan një grua që i ka vdekur gjyshja
para tre vjetësh dhe që sot kërkon të marrë do-
mate pa radhë.

— Te ky dyqan i ka vdekur gjyshja para
tre vjetësh, që qan këtu? — tha plaku me kokën
gjithmonë të ulur.

— Nuk e di se ku i ka vdekur gjyshja, xha-
xha, po këtu ajo ka ardhur të marrë domate pa
radhë, — thashë unë duke e ngritur pak zërin,
sepse plaku nuk dëgjonte mirë.

— Po pse nuk vjen nesër të blejë domate me radhë, po pikërisht sot, që ka trevjetorin e së ndjerës? — vazhdoi plaku. Kësaj here më vuri në vështirësi, ndaj bëra sikur nuk e dëgjova. Po plaku, ashtu si me vete, vazhdonte të thoshte:

— Kushedi, mund të jetë ndonjë zakon i ri ngushëllimesh dhe unë nuk e di, apo jo, mor bir?

— Moj Leta, a do të shesësh sot, apo jo?

Vetëm kjo thirrje na kujtoi se ekzistonte shitësja, por, kur kthyem kokën nga ajo, mbetëm të habitur nga pamja e saj. Shitësja ishte e pikëlluar, e drobitur me sa duket nga një qarje e brendshme, pa lot. Ajo, kur pa se ne po e shihnim, lëvizi dhe u bë gati të shiste, po për disa çaste e ndali vështrimin te gruaja e varrezave dhe me një zë të mekur tha:

— Edhe mua më ka vdekur nëna e nënës para shtatë vjetësh, pikërisht ashtu siç e përshkrove vdekjen e gjyshës sate. Edhe ajo ka qenë shumë e mirë. Më preke shumë. Në ç'parcelë prehet gjyshja jote?

— Te parcela e tretë, majtas, numri 77, — u përgjigj shpejt e shpejt dhe me siguri gruaja e varrezave duke parë nga të dyja anët me një ndjenjë të lehtë krenarie që kishte mundur të prekte më në fund dhe shitësen.

— Në parcelën e tretë majtas? Po aty afër është dhe gjyshja ime e shkretë. I paskemi afër. Sa mirë. Më gëzove, moj shpirte! Sa domate deshe?

— Një kilogram desha, një kilogram... At-

je, ë, dëmaethënë i kemi pranë. Është parcelë e mirë ajo, — tha gruaja e varrezave, tashmë me një qëndrim prej fitimtareje. Një copë herë asnjëri nuk po fliste. Mezi po prisnim të largohej gruaja e varrezave bashkë me rrëfimet e saj përvdekjen dhe varret, prandaj nuk kundërshtoi asnjëri kur apo po merrte pa radhë domatet. Po gruaja e varrezave nuk e duronte qetësinë, ndaj nisi të fliste përsëri me një ton gati patetik:

— E, moj gra! Si nuk m'u hap zemra kur kaloja pranë tyre. Aty ishin të gjithë, vetëm se nuk flisnin. Ah! Të falemi nderit, moj Leta! M'i ke zgjedhur shumë të mira domatet. O, se harrova! A nuk më jep dhe dy kilogramë qepë?!

— Tani e mbushe kupën, — foli burri i radhës me nervozizëm.

— Po, po, e teprove fare, — thanë gati në një zë dy gra të tjera.

— C'po ndodh nga fillimi? — më pyeti plaku prapa meje.

— Një grua që mori një kilogram domate pa radhë për shkak të varrezave kërkon të marrë pa radhë dhe dy kilogramë qepë.

— Mos është ajo që i ka vdekur gjyshja para tre vjetësh?

— Po, ajo është.

— Tani që kërkon qepët pa radhë mos kërkon t'i përkujtojmë ndonjë të vdekur tjetër nga familja e saj? — tha plaku pa e ngritur kokën, ndërsa gruaja e varrezave largohej krenare, me dy qeska në dorë dhe një hije të vdekuri në krah.

PËR SHËNDETIN TIM

Mbase e kishte fajin pranvera, që erdhi shumë e nxehjtë, aq sa njerëzit që në maj hoqën pardësytë e dolën në këmishë me mëngë të shkurtër. Si zakonisht, ky ndryshim i menjëherëshëm i motit u shoqërua me thashetheme të shumta për klimën, e cila, sipas tyre, kishte ndryshuar aq shumë, saqë kufijtë midis stinëve thuajse po zhdukeshin. Pranvera ekziston vetëm nëpër kalendarë, në tekste shkollorë e nëpër poezi, thoshin disa. Jo, pranvera s'është më një kohë reale, e prekshme, që ka të bëjë me lulet, me freskinë e këndshme, me ngjyrat e papërsëritshme të gjetheve etj., etj.

Edhe unë, si gjithë të tjerët, pasi komentova vapën e papritur të majit, hoqa pardësynë e nxora bluzën me mëngë të shkurtër. U pashë në pa-

sqyrë dhe m'u duk vetja shumë vjet më i ri. Për shembull si gjimnazist. Ia thashë këtë zbulim gruas, e cila për të mos ma prishur bëri sikur nuk dëgjoi. Por dhe unë pranova se ajo nuk e kishte dëgjuar zbulimin tim thjesht për të mos e prishur gëzimin që ndjeva.

Dola drejt e në shëtitore dhe u takova me Donin, shokun tim të vjetër, që nuk mungon në asnje stinë të vitit në shëtitore. Doni, ndryshe nga herët e tjera, nuk po fliste me gjallëri. Herë pas here më vështronë dhe fytyra e tij bëhej gjithnjë e më e zyrtë. Erdhi një çast dhe ai i nguli sytë për një kohë të gjatë te krahët e mi. S'po e kuptoja Donin, i cili me zyrtësinë e tij sikur ma fashiti edhe mua entuziazmin. Megjithatë nuk i fola, gjersa më në fund foli ai:

— Nuk i shoh dot krahët e tu, — nisi të thoshte ai me ngadalë. — A nuk të bëjnë përshtypje krahët që të janë katandisur si dy shkopinj të hollë? Edhe fytyra jote po thahet. Je bërë kokë e lëkurë. C'dreq ke?

Shtanga. Papritur m'u duk sikur isha fare pa krahë, sikur ata nga fyerja që u bëri shoku im, më lanë fare. Mbase e kishte fajin pranvera, që erdhi aq e nxehjtë, e që papritur i bëri krahët e njerëzve të rëndësishëm.

Kisha frikë t'i shihja krahët e mi aty, në mes të shëtitores dhe nö sy të Donit. Ndërsa ecnim pa i folur njëri-tjetrit, unë përpinqesha të kujtoja se si i kam pasur krahët një ose disa vite më parë, por që e kotë, sepse ata më dilnin parasysh

vetëm si kocka, madje nga ato të skeleteve pre-historike. Prandaj, pa vetëdije, i kisha fshehur pas shpine. Ndërkokë Doni po jepte disa këshilla praktike për mënyrën e të ushqyerit, për të rra-lluar duhanin, për një regjim normal pune etj. Unë dëgjoja i shushatur, si fëmijët e bindur të rriturit. Aty nga fundi u përpoqa të mbrohesha, se në fund të fundit nuk janë dhe aq të dobët, po Doni mbeti i palëkundur në mendimin e tij, saqë duket pa kuptuar fillova ta vlerësoja edhe vetë. Kështu vendosa që, me të vajtur në shtëpi, të filloja të merresha më serioizsht me veten ti-me. Kur i dhamë fund shëtitjes, ashtu me duart e lidhura prapa nxitova drejt shtëpisë, duke ndier zili për kalimtarët, të cilët, me krahët lakuriq, të lirë, ndienin gëzim. Prisja të thoshin ndonjë fjalë dhe njerëzit e shtëpisë, por ata s'u ndien. E po tëndit i dhimblesh, mendova. S'më rrihej. S'isha më i qetë. Pas disa çastesh, ashtu si më marifet, mora mënjanë gruan dhe e pyeta se si i duke-shin krahët e mi, a kishin ndonjë ndryshim nga viti i kaluar. Gruaja më pa me dyshim, pastaj, kur ndjeu se e kisha seriozisht, tha se krahët e mi ngjanin me ata të një gjimnazisti simpatik. Unë e kapërdiva shakanë e saj dhe i shpjegova se si ishte shprehur Doni për shëndetin tim dhe veçanërisht për fytyrën dhe krahët e mi. Ajo më pa me një buzëqeshje të lehtë dhe më tha se meqenëse unë isha elegant, Doni duhej të qe xhe-loz!

Vetëm gruas sime mund t'i shkonte në me-

ndje që Doni qenkerka xheloz për pamjen time elegante! Pasi më përqafoi dhe më puthi në të dyja faqet, që për mua ishin kockë e lëkurë, ajo u largua për në kuzhinë. Mbeta në mes të dhomës së gjumit, më i trishtuar se asnijëherë tjetër, duke menduar se gruaja, madje edhe pjesëtarët e tjerë të familjes, nuk mund t'i dallonin ndryshimet tek unë për dy arsyet: së pari, nga dashuria, dhe së dyti, nga ambientimi. Kështu që duhej vlerësuar mendimi i Donit; ai kishte të drejtë.

C'të bëja? Dola para pasqyrës. Një çast m'u duk se nuk kisha pikë ndryshimi. Ngrita krahun e djathët. Ai m'u duk i dobët. Ngrita dhe të majtin. Kockë e lëkurë. Preka fytyrën. Sesi m'u duk. Faqet sikur qenë thithur. Më në fund po e shihja veten time pa pasion. Kishte plotësishët të drejtë Doni. Sa më shumë shiheshët në pasqyrë, aq më shumë shquaja kockat në krahët dhe fytyrën time. Kalova edhe një herë mollëzat e duarve mbi fytyrë dhe ndjeva se nuk kisha fare mish, po vetëm kocka dhe një copë të hollë, të zbehtë. Si ka mundësi që njeriut t'i largojet mihi nga fytyra dhe krahët t'i squllen brenda ditës? Apo nuk i kisha vënë re? Erdhi një çast dhe nuk po e njihja më shëmbelltyrën time në pasqyrë. Mblidhe mendjen, se po çmendesh, fola pa zë, se në pasqyrë ti je dhe askush tjetër. Në të vërtetë nuk ishte qeshje, po një ngërdheshje e shëmtuar, që më kalli datën, dhe kushedi si do të më kishte vajtur filli sikur të mos dëgjoja

psherëtimën e gruas, e cila, e merakosur, kish-te ardhur të më thërriste. Mos më ka parë, dhe ndjeva një farë turpi kur kujtova pantomimën që kisha luajtur para pasqyrës. Ndaj në çast sa-jova një gënjeshtër.

— Vdiqa nga dhërnballa, po e shikoja në pa-sqyrë se mos më është enjtur, ja kjo majtas.

— Po ti sikur kishe problemi krahët, — më tha gruaja duke parë me kujdes nofullën time të majtë, e pas disa sekondash shtoi se vërtet ana e majtë ishte enjtur pak, por jo sa të shqetëso-hesa. Unë u afrova përsëri te pasqyra dhe, për çudi, ana e majtë m'u duk pak e fryrë. U largo-va nga pasqyra dhe mollëzt e duarve të mia ndien një lloj fryrjeje të lehtë në anën e majtë të fytyrës. Nuk i fola më gruas dhe u shtriva në shtrat me një mërzi të thellë. Çudi, vërtet çudi. Para dhjetë minutash fytyra ime ishte kockë e lëkurë. Tani fryhet vetëm ana e majtë. Ashtu i shtrirë në errësirë nisa ta përfytyroja fytyrën time të fryrë, të thumbuar nga bletët. Gishtat, mollëzat e tyre, nuk preknin më asnë kockë në fytyrën e në trupin tim, që po e kapiste gjumi.

Të nesërmen u zgjova herët, më herët se zakonisht, gjë që donte të thoshte se kisha bërë një gjumë të keq. Megjithatë vendosa t'i mbushja mendjen vetes se me mua, me krahët, me fytyrën, me nofullën e majtë nuk kishte ndodhur asgjë. Prandaj kur u ngrita nga shtrati, nuk e ndeza dritën për të mos u parë në pasqyrë dhe nuk bëra fare zhurmë për të mos e zgjuar gruan,

ë cila me siguri do të më pyeste për dhëmballën dhe kushedi si do t'i dukesha. Nuk ishte aspak çudi të thoshte se më qe enjtur dhe ana e djath-të deri te syri. Ndërsa po vishesha, u kujtova se për disa ditë nuk duhej të mbaja këmishë me mëngë të shkurtra. Kështu do të bëja derisa të harroja krahët e fytyrën time kockë e lëkurë. Pasi u lava dhe u kreha pothuajse në errësirë, dola nga shtëpia pa bërë as më të voglën zhurmë.

Freskia e mëngjesit i kishte detyruar edhe të tjerët të vishnin këmishë me mëngë të gjata. Sapo të dilte dielli ata do t'i përvishnin mëngët e këmishëve dhe krahët e tyre do të lëviznin lakuriq. «Po krahët e mi? Unë vendosa të mos merresha më me krahët?» — kritikova pa zë. Në të vërtetë m'u duk se nuk flisja unë, po dikush tjetër, ndoshta Doni. «Megjithatë, — ngula këmbë, — duhet hequr dorë nga këto mendime të ngatërruara. Pastaj, përsë duhet të kujtoj gjëra kaq të trishtuara, kur dita është kaq e burkur, kur njerëzit nxitojnë të lodhur nëpër rrugë, kur pas disa ditësh do të shkojmë përf pushime në plazh. Po sikur të bënte një mot i keq, të binte shi dhe breshër, po sikur rrugët të ishin të shkreta, po sikur të mos kisha fare grua dhe plazhi të mos ekzistonte fare? Ja këto gjëra duhet ta tri-shtojnë njeriun dhe jo ato budallallëqe...».

— Mirëmëngjes! — vetëm kjo përshëndetje më bëri të përmendesha. Ishte Tefta, shoqja ime e fakultetit, që për çdo mëngjes e takoja pikërisht në këtë pikë të qytetit.

— Mirëmëngjes! — thashë dhe unë duke ndaluar për t'i dhënë dorën, sepse ajo, ndryshe nga herët e tjera, po më shikonte e habitur. Si rregull e përshëndetënim njëri-tjetrin ekspres, sepse Tefta ishte gjithnjë vonë për punë. Këtë herë ajo diçka kishte me mua.

— Hë, Tefta, ç'kemi ndonjë të re? — nisa t'i flisja me një lloj frike, se mos edhe ajo kish-te vënë re që ftyra ime po' thahej, se unë isha shndërruar në një grumbull kockash që lëviznin. Instinktivisht krahët e mi, megjithëse të mbuluar, u fshehën pas shpinës sime dhe më dukej sikur ata ishin larg, shumë larg meje. Më në fund Tefta foli:

— Nuk kam ndonjë të re, por çudi, sot nuk të njoha që je ti. Kur u afrove, të njoha nga mënyra e ecjes, sepse ke ndryshuar shumë dhe në një mënyrë tepër të çuditshme.

Në thellësi të shpirtit ndjeva dhimbje të mprehtë. Pra gjithçka qenka e vërtetë. Ula kokën si për të marrë forcë për t'i thënë diçka:

— E di, Tefta, e di, këtë ma tha dje dhe Doni. Nuk varet gjithçka nga njeriu i shkretë, — mërmërita sikur po pohoja për një sëmundje të rëndë, të pashërueshme dhe vdekja më ishte e afërt dhe e pashmangshme.

— Kjo varet vetëm nga njeriu. Ç'ke? Ti ke qenë i rregullt, serioz.

— Çfarë thua, moj Tefta, se nuk po të marr vesh?!

— Dua të të pyes: je parë sot në mëngjes në pasqyrë apo jo?

— Sot në mëngjes jo, po mbrëmë plot një orë.

— Ah, mbrëmë! Më fal. Unë pse të dua të mirën ndala. Ditën e mirë!

Tefta u largua. Unë mbeta në udhë e nuk munda ta merrja me mend se ç'më kishte ndodhur në këtë mëngjes maji. Mos nuk u kreha në mëngjes! Asnjëherë nuk kam treguar ndonjë kujdes të veçantë për flokët e mi bishta-bishta.

Natyrisht, ashtu siç thoshte Tefta, nuk mund të shkoja në punë, prandaj vendosa të shihesha në pasqyrën më të **afërt**.

Në këto mendime e sipër e pashë veten në mes të dyqanit të berberëve. Tre veta po rru-heshin dhe tre të tjerë prisnin radhën. Në fillim u hutova. S'po dija ç'të bëja. Pas pak iu afrova një pasqyre. Më erdhi për të qeshur se, në vend që t'i krihja flokët nga e djathta, siç i kreh prej njëzet vjetësh, i kisha krehur nga e majta. Në fakt dukesha disi ndryshe dhe Teftës, që më shihte çdo ditë, kushedi si i jam dukur atë mëngjes. Meqenëse isha te berberët, i kërkova njërit një krehër. Nisa të krihesha me vendosmëri, sepse e ndieja që të pranishmit po më shikonin vetëm mua. Përfundova krehjen dhe, pasi u tha-shë «faleminderit» të gjithëve, vravova për në punë, pa vrarë mendjen se si do ta komentonin ata burra sjelljen time.

Zura vend pranë tavolinës sime të punës i lehtësuar, si të kisha shpëtuar nga një ndjekje e mundimshme. Stefani, shoku i zyrës, është fja-

lëpak, po këtë mëngjes, për çudi, bëri një konstatim të veçantë për natyrën e tij të mbyllur:

— E çuditshme, hyrë te berberi dhe nuk qenke rruar?! Megjithëse po më dukesh interesant edhe kështu:

— Jo, more Stefi, nuk shkova përt' u rruar te berberi, po përtë takuar një mikun tim të vjetër.

— Berber punon ai mikut yt?

— Ah, jo, ai është klient...

Stefi ë besoi. Atij as nuk mund t'i shkonte ndër mend që unë nuk isha rruar se nuk doja të shihesha në pasqyrë, se nuk kisha ndezur dritën, se nuk kisha veshur këmishën me mëngë të shkurtra përtë fshehir krahët e mi kockë e lëkurë. Po fytyra ime? Po Stefani a e ka parë fytyrën time kockë e lëkurë që po thahet? Ndoshta ai, si gruaja ime, është mësuar me fytyrën dhe krahët e mi. Papritur vura re se Stefi ishte shumë më i shëndetshëm se unë, bile m'u duk sikur qe shëndoshur më shumë këtë muajt e fundit.

— Ore Stefii! E di që je shëndoshur ca si tepër këta muajt e fundit?

Stefi ngriti kokën dhe më pa ndryshe nga herët e tjera. Në fytyrën e tij u krijuan ca rrudha dhe sytë iu futën më thellë se zakonisht.

— Ke të drejtë. Ashtu është, jam rënduar ca. Kam shtuar tetë kilogramë në peshë. Mjekët më kanë thënë se duhet të mbaj dietë dhe të bëj fizkulturë të rregullt. Para disa ditësh bëra analizat dhe më dolën se kam yndyrnat në gjak pak

të larta! Kam dy javë që ha gjellë pa kripë e pa yndyrë. Nuk e ke idenë se sa e tmerrshme është të mbash dietë. Sa herë ulem për të ngrënë bukë më kujtohesh ti, me trupin tënd elegant dhe mendoj me vete sa të lumtur duhet të jeni ju që keni të drejtë të hani ç'të doni. E di që të kam zili për këtë. Eh! Sot kisha vendosur ta prishja dietën, por, kur më the dhe ti që jam shëndo-shur ca si tepër, s'po ha, e lashë...

Ndërsa Stefi vazhdoi të fliste gjatë për shëndetin e tij, unë përvisha mëngët e këmishës.

the first time, and I am sure it will be the last. I have been to the same place twice before, and I have never seen such a sight as I did there yesterday. The country is very flat, and the trees are all dead or dying. The ground is covered with a thick layer of sand, and the water is very shallow. The people are all poor and hungry, and they are living on whatever they can find. The government has done nothing to help them, and they are left to their own devices. I hope that something will be done soon to help these people.

220. *Adavida* is a genus of small, pale, yellowish, or
white, annual or perennial herbs, with opposite, entire, linear
leaves, and small, terminal cymes of flowers. The genus
contains about 15 species, all of which are found in
temperate America, and one in Europe. The species
of *Adavida* are easily distinguished by their
yellowish, or white, flowers, which are produced in
terminal cymes, and by their opposite, linear leaves.

NJË LODËR PËR TË RRITUR

— O babi! A e kam të bukur makinën? — tha Niku, fëmija më i vogël i shtëpisë, që nuk i kishte mbushur ende të pesë vjetët, duke e parë të atin drejt në sy.

— Oo! Sa të bukur e paske bërë, mor Niku! Të lumtë! — tha i ati me një entuziazëm të shtirë, ndërsa mbante në dorë një copë letër të zhubrosur, ku djali pretendonte se kishte vizatuar një makinë. Pas kësaj, burri u zhyt përsëri në leximin e një libri të trashë, ndërsa Niku nxitoi për te Mira, motra e madhe, për të marrë edhe mendimin e saj për veprën e tij të fundit.

— O Mira! O Mira! A e kam bërë të bukur makinën? Babai tha «bukur», po ti?

— Për kokën e babit, makinë më të bukur

se kjo nuk më kanë parë sytë. Ë mrekullueshme, — tha Mira duke dashur ta largonte të vëllanë, pasi mendjen e kishte te mësimi i fizikës. Pothuaj të njëjtat fjalë i thanë Nikut dhe eëma, dhe Lola, motra tjetër, dhe ai u ndie krenar përmakinën që kishte vizatuar me aq mund e përpjekje. Me atë makinë ai kishte vendosur të bënte udhëtime të largëta, të bukura dhe të guximshme, prandaj me zë shumë të lartë ai tha:

— Ej! Unë do të bëhem shofer!

Asnjëri nga pjesëtarët e familjes nuk u habit ngå ky vendim i papritur i Nikut të vogël, ndonëse para dhjetë minutave ai kishte shprehur dëshirën të bëhej piktor i madh. Pa e zgjatur Niku u kthye te vendi i tij i zakonshëm, poshtë tryezës, ku ndihej i sigurt dhe i pavarur, ku mund të ndërronte profesionet sa herë të donte, pa pyetur askënd.

Niku e pa edhe një herë makinën e vet dhe mendoi se ajo ishte aq e mrekullueshme dhe e fortë, sa mund të kalojë dhe lumenj të mëdhenj. U gëzua pa masë që makina e tij mund të bënte udhëtime kaq të vështira, prandaj nuk kishte së çfarë të priste, dhe aty nga nëntryeza ai shpallli së së shpejti do të nisej për në qytetin e Përmëtit me makinën e tij të paparë ndonjëherë. Vështirë të gjendej ndonjë arsyё përsë Niku zgjodhi pikërisht atë qytét për udhëtimin e tij të parë.

Nuk kaloj shumë dhe kuzhina nisi të oshëtinte nga një zhurmë e padurueshme, e cilat fi-

lloj tē shtohej, se Niku, sipas tij, po ecte, me njëqind kilometra në orë. Kur përkulej majtas ose djathtas, domethënë kur merrte kthesat imajjinare, zhurma e ë-ve tē zgjatûra arrinte këlmin. Megjithatë pjesëtarët e familjes nuk shqetësoheshin dhe aq. Ata qenë mësuar me trillet e më tē voglit tē shtëpisë.

Pas disa minutave, udhëtimi shtëpi-Përmet dhe Përmet-shtëpi mbaroi. Kjo u kuptua nga pushimi i ë-ve tē zgjatura dhe tē gjithë uruan me mend që Niku tē zgjidhte ndonjë profesion tjeter, më pak tē zhurmshëm. Niku bëri sikur hapi dhe mbylli dyert e makinës dhe doli nga vendi i vet i zakonshëm plot triumf, por asnjëri prej pjesëtarëve tē familjes nuk e përfilli, ata nuk lëvizën fare nga vendi për t'i uruar djalit tē vogël mirëseardhjen nga udhëtimi i parë. Megjithatë djalit tē mësuar nuk i bëri aspak përshtypje kjo pritje akull e ftohtë e tē tjerëve. U mendua një copë herë dhe i erdhi ndër mend se njerëzit, kur kthehen nga udhëtime tē gjata, i merr mälli përbabanë, mamanë, motrat etj., ndaj, pa e zgjatur, thirri:

— Ej! Mua më ka marrë malli për ju sepse kam qenë shumë larg!

Të rriturit e familjes përsëri nuk ia varën tē voglit. Niku nuk e dha veten dhe ndoqi pikë për pikë planin e lodrës. Ai shkoi në drejtim të së ëmës dhe, duke e kapur nga duart, i tha:

— Mama! Erdha unë. Më ka marrë malli shumë për ty.

— Edhe mua, — tha eëma dhe duart e Nikut të vogël e përqafuan aq fort atë, sikur ai të kishte ardhur nga Poli i Veriut dhe jo nga mesi i kuzhinës. Më pas i erdhi radha të atit për t'u përqafuar. Ky e pyeti Nikun për peripecitë e udhëtimit. Niku i tregoi me shumë fantazi se rruga kishte qenë e gjatë dhe shumë e vështirë. Babai e përqafoi edhe një herë Nikun dhe përsëri uli sytë te libri i trashë.

— Pse, kështu vihet nga udhëtimet e largëta, duarbosh?! — e ngacmoi Nikun e motra.

Fëmija u topit nga fjalët e së motrës. Entuziazmi i kthimit triumfator befas iu shua dhe ai pa duart e tij të vogla. Nuk arriti ta perceptonte atë fjalën «duarbosh» dhe duart i mbeten në ajër pa ditur se ku t'i conte. Lola iu afroa të vëllait, e mori në krahë dhe duke qeshur i pëshpëriti në vesh:

— Hajde, Niku, hajde! Të bësh gjithë atë rrugë dhe të vish në shtëpi duarbosh, pa asnjë dhuratë, nuk ka hiç lezet!

Niku e pa në sy motrën dhe kuptoi se përsë ishte fjala dhe pa humbur kohë vrapi te vendi i tij i zakonshëm, poshtë tryezës dhe pas disa sekondave thirri me zë të lartë:

— Ej! Ju kam sjellë të gjithëve dhurata shumë të bukura!

Nikut i qe kthyer gjallëria e fillimit dhe sytë i shkëlqenin nga gëzimi kur doli me duart e shtrira përpëra, sikur po mbante një peshë shumë të rëndë. Atë çast të rriturve u bëri përshty-

pje inskenimi i të voglit dhe lanë punët e tyre për të ndjekur lojën e tij.

— Mama! Ty të kam sjellë një palë çorape ngjyrë lila, — foli Niku me një zë të ndryshuar, disi ceremonial, duke i afruar duart e shtrira drejt saj. E ëma nisi të queshte dhe shihte më habi djalin e vogël. Pastaj ajo imitoi marrjen e diçkaje nga duart e Nikut dhe bëri sikur po i shikonte ato me këershëri. Pas pak ajo tha:

— Ua, mor Niku, sa të bukura këto çorape! Edhe ngjyra është shumë e bukur. Ku të vajti mendja te kjo ngjyrë!

— Po deshe ngjyrë tjetër, i ndërrojmë, se kam plot të tiera atje poshtë tavolinës, te makina. — tha Niku plot siguri dhe shumë i gëzuar që lodra po vazhdonte për bukuri.

— Jo, shumë të mira janë këto. — ia ktheu e ëma duke parë nga vajzat me një nënqeshje të lehtë.

— Ndërsa ty, babi, të kam sjellë një kapele aë kokën tënde të mos e lagë shiu. Babai i Kolit mban gjithmonë kapele, përsë të mos e mbash dhe ti një?

— Oo! Sa mirë e ke bërë. mor Niku! Vërtet që shiu e lag kokën time. Falemnderit! Shumë të falemnderit!

Ndërkohë të motrat kishin lënë mënjanë mësimet dhe po ndiqnin me interes ceremoninë e shpërndarjes së dhuratave. Niku vazhdonte t'i mbante duart e shtrira përpëra. Dhuratat ende nuk ishin mbaruar. Niku iu afrua Mirës dhe Lo-

lës dhe ndjeu një gëzim të papërshkruar kur mendoi se ato po prisnin dhuratat e tij e nuk po merrishin me asgjë tjetër. Mbështetëherë parë lodra e tij i kishte tërhequr të rriturit. Nuk i kishte ndodhur kështu asnjëherë, edhe kur kishte luajtur me komça, me anije prej letre, luftash etj.

— Tý, Míra, tē kam sjellë një ari tē madh, vija-vija, se tē pëlqejnë shumë ata ty.

— Ua, mor Niku, sa simpatik qenka! Falem-
nderit shumë, të keqen motra. Po, meqë është
me vija, duhet të jetë zebër dhe jo ari, — tha
Mira duke shikuar duart e veta, sikur tek ato
ndodhej një diçka shumë e çmuar, shumë e rra-
llë. Niku nguli këmbë me seriozitet se dhurata
e tij ishte dhe ari edhe zebër. Ky po him e hutoi
pak Nikun e vogël, sa desh harroi se i kishte
mbetur dhe një pjesëtar tjetër i familjes për t'i
dhënë dhuratë. Lola ia kujtoi këtë me një kolli-
tje të lehtë. Niku u kthyte nga ajo dhe i qeshi
duke i dhënë të kuptonte se edhe pör atë kish-
te menduar. Ai ndenji një copë herë në vend, si
për të kujtuar dhuratën që kishte për Lolën dhe
pas pak u nis drejt saj, me duart e shtrira për-
para.

— Kurse ty, Lola, tē kam sjellë, tē kam sjellë plot gjëra tē bokura. Tē kam sjellë një bor, një violinë, një anije me vela dhe një shami tē qëndisur me lulka blu. Tē pëlqejnë, Lola, këto?

— Niku foli shpejt e shpejt dhe për çdo dhuratë bënte nga një lëvizje, sikur po i jepte Lolës në

dorë diçka. Edhe Lola iu përgjigj lëvizjeve të Nikut thuajse, grumbullonte dhuratat në prehër.

— Si nuk më pëlqejnë, — tha ajo, duke qeshur e puthur Nikun në faqet e skuqura flakë nga emocioni. — Pastaj shih sa shumë mora unë. Pjesëtarët e tjerë të familjes sikur stepën nga ajo listë e gjatë sendesh që Niku i dhuroi vajzës më të vogël. Pikërisht në këtë çast Mira, motra e madhe, e pa disi me seriozitet lodrën e Nikut, sepse ai krejt papritur kishte bërë një dallim të madh midis saj dhe motrës tjetër. Kjo nuk ishte aspak e drejtë. Përse Niku të mbante ndaj saj një qëndrim të tillë? Me duart e tij të vogla ai kishte shpërfillur keq motrën e dashur, që kishte bërë aq shumë për të.

— Pse, more Niku, vetëm një ari i sillet motrëstë madhe? Mbaje mend! Kaq shpejt i harrova shëtitjet në park, Teatrin e Kukullave, akulloret e pastat që të kam blerë sa e sa herë?! Mbaje mend!

Niku e dëgjoi Mirën tejet i habitur dhe thellë ndjeu një tronditje. Ai nuk po kuptonte as gjë nga ato që thoshte ajo, sepse nuk mundi të krijonte ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë logjike midis ariut vija-vija dhe akulloreve, Teatrit të Kukullave, pastave, midis shëtitjeve në park. E gjithë kjo iu duk tepër e ngatërruar, aq sa ia prishi krejt gëzimin që i kishte dhënë gjer atë çast lodra. Megjithatë, si për tu mbrojtur, tha:

— O Mira! Po ariu vija-vija është edhe zebër.

— S'të vjen turp ty, Mira, që flet kështu, — ndërhyri me rreptësi e ëma, duke iu drejtuar asaj me gisht. — Mirë e ka djali. Nuk meriton më tepër ti se një ari-vija-vija. Bile tepër e ke dhetatë. Shiko mësimet, atë bëj ti! S'po më mbetet qejfi mua, që më solli vetëm një palë çorapë me një ngjyrë të shpifur. Dhe mos harroni se ju kam bërë kokën të treve.

— Po jo, o mama! Unë nuk e kisha me ty, po më Lolën...

— Çfarë ke me mua ti, Mira? Unë nuk kam faj. Unë nuk i kërkova gjë Nikut. Ai vetë, me dëshirën e tij m'i dha.

— Aa! Ç'na the. Tani na e mbushe mendjen!

— Në qoftë se të vika kaq keq, atëherë po ia kthej Nikut të gjitha dhuratat. Kënaqesh tanë ti? — thà Lola gati për të shpërthyer në lota.

— Ngai ato je ti, që të fal gjëra kot së koti. Rri aty dhe mos fol!

— Ore! Lërini këto muhabete! — ndërhyri babai, i revoltuar nga fjalët e vajzave. — Në vend që të gëzoheni e t'i thoni djalit falemndërit, dërdëllisni budallallëqe. Më keni parë ndonjëherë të vë kapele? Jo. Bile unë s'i honeps kapelet, po si t'i them djalit: përsë më solle kapele? Pse s'më solle aeroplan? Gabim, vajza, shumë gabim dhe ti, grua. Kur nuk flas unë, që jam babai juaj, ju të tjerët duhet ta qepni gojën. Morët vesh?!

Ndërkohë, si i zënë në një faj të rëndë, Niku rrinte me kokën ulur dhe duart e lidhura prapa, megjithëse ato që thuheshin rrëth lodrës së tij

ai nuk po i merrte vesh. Vetëm një gjë e kishte të qartë: lodra e tij qe prishur përfare, ajo nuk mund të vazhdonte më, prandaj, me hap të ngadaltë, ai shkoi te vendi i vet, poshtë tryezës, atje ku ndodhej makina e tij e udhëtimeve të largëta e të guximshme. E mori edhe një herë në dorë makinën e mrekullueshme dhe aq të fortë, sa të ka-përcente lumenj të mëdhenj, dhe i erdhi shumë keq që nuk mund të udhëtonte më me të në qytete të tjera. Kur mendoi këtë, në gjoks iu mbloq një si lëmsh dhe me sy të përlotur e me një zë të do-bët aty nga poshtë tryezës tha:

— Unë nuk do të bëhem shofer!

KËPUCËT E REJA

KËPUCËT E REJA

Kur gruaja më tha se përsëri duhej të visha
ja këpucët e reja, një drithërimë e përshkoi krejt
trupin tim, megjithëse bëhej fjalë për diçka që
lidhej vetëm me këmbët. Sipas gruas duhesin ve-
shur patjetër këpucët e reja sepse po shkonin në
dasëm dhe jo në arë për të prashitur misër dhe
se ngjyra e këpucëve shkonte për bukuri me ko-
stumin etj. Gruaja e dinte se herën e fundit për
shkak të këpucëve të reja këmbët më qenë bërë
copë dhe plagët ende nuk më qenë shëruar; se
kisha bredhur me ditë të tëra andej këtej për të
gjetur një lloj ilaçi popullor që përdorej vetëm në
kësi rastesh, e megjithatë këmbëngulte se duhej
t'i provoja edhe një herë se mbapse ato hapeshin.
Me këtë shpresë kisha muaj që jetoja, po, me sa
dukej, perspektivat qenë më shumë se të zymta.
Megjithatë janë disa gjëra që kërkojnë durim për

t'u realizuar, prandaj përse të mos e provoj edhe një herë, mendova për më tepër që herën e fundit shëtita me këpucët e reja edhe nëpër shi.

— Mirë, silli, — i thashë gruas. Ajo vajti t'i merrte në koridor, me atë kënaqësinë kaarkteristike që shkëlqen në fytyrat e grave kur burrat i dëgjojnë. Po sa u çudit kur vuri re se këpucët e mia të sarta nuk ishin në vendin e zakonshëm. Fytyrën e saj e përshkoi menjëherë një si paraalarm, ndërsa unë, që prisja zbathur te dera e dhomës, mbajta gjakftohtësinë. I kërkuaam në raft, poshtë krevatit, te qoshku në të majtë të komosë dhe në të gjitha vendet e tjera të mundshme, por ato nuk ishin.

Kush t'i ketë lëvizur? Kush t'i ketë marrë? Filloi të më brente meraku. Nuk e dija se do të më vinte aq keq për ato këpucë që ma kishin sjellë në majë të hundës. Gruaja dha alarmin: na kanë humbur këpucët e reja! Nëna erdhi pothuaj me vrap nga kuzhina dhe na qetësoi. Këpucët, tha ajo, duhet t'i ketë veshur Sandri, se për ku nxittonte nuk e di, po di që kërkonte këpucët e tij dhe nuk po i gjente. Kështu që them se duhet t'i ketë veshur ai. Sandri është vëllai im i vogël. Unë shoh gruan në sy dhe pamja e saj sikur thotë: a do të kthehet gjallë nga udhëtimi Sandri? Edhe unë thellë po mendoj se Sandri nuk mund të shkojë shumë larg me ato këpucë. Kur ishim të vegjël, ai shpesh vishte këpucët e mia, por ato ishin këpucët të tjera, jo si këto, që unë i pati porositur me shumë kënaqësi pa më shkuar ndërmend se

ç'do të hiqjá. Në të vërtetë atë ditë unë nuk porosita këpucë, po dhimbje, flluska, plagë dhe ilaqe popullore.

... Ishte é diel paradite, kur bashkë me gruan vajtëm pér të marrë këpucë të reja, dhe unë qeshë shumë i gëzuar. I thashë gruas se një herë e një kohë, kur isha fëmijë, blerja e këpucëve të reja ishte pér mua një ngjarje e jashtëzakonshme. Disa net rresht flija me këpucët e veshura dhe shihja ëndrra sikur ecja, zbatohur mbi copëra xhamash të thyera, e kur më dilte gjumi i trembur, mrekullohesha kur ndjeja së në këmbë kisha këpucët e reja. Mbase ky kujtim i fëmijërisë më nxiti që t'i vishja këpucët e reja qysh në dyqan. I mbështolla të vjetrat me një copë letër dhe morëm rrugën pér në shtëpi me një gëzim që mund ta pikaste edhe kalimtari më indiferent i qytetit. Por gëzimi nuk do të vazhdonte gjatë. Nuk kishim bërë as njëqind metra kur nisa të ndjej disa dhimbje të forta, të padurueshme, të papërfytyrueshme. I thashë gruas të ndaleshim diku se nuk mund të ecja asnje metër më tepër. U ndalëm dhe pér disa minuta sikur u qetësova, ndërsa ime shoqe më ngushëllonte duke thënë se kështu e kanë këpucët e reja ditën e parë, pastaj.... Dhimbjet atë ditë më vazhduan edhe pasi i hoqa këpucët. Vetëm në ujë të ngrohtë me kripë këmbët gjetën prehje. Menjëherë vendosa t'i kthej ato këpucë, po gruaja vazhdonte të thoshte se kështu ndodh gjithmonë me këpucët e reja në fillim. Pas disa veshjeve ato do të hapeshin vetvetiu. I besova dhe e pësova shu-

më keq. Herën e tretë apo të katërt thembrat m'u enjtën dhe më pas u qelbzuan. Qëndrova në shëpi tre ditë me raport mjekësor. Ditën e katërt nuk mund të vishja asnje lloj këpuce, as të re e as të vjetër, të çdo lloj madhësie. Kështu që u detyrova të shkoj në punë me sandale pikërisht kur të ftohit e dhjetorit kishte nisur të bëhej i padurueshëm. Ecja rrugës dhe njerëzit më ndiqnin me sy për shkak të sandaleve, ndërsa unë ndihesha i qetë nga dhimbjet. Një shoku im i punës ma kuptoi hallin dhe më këshilloi që t'i lagia këpucët me ujë, sepse sipas tij lagështira e zbut lëkurën. Kur ia tregova gruas këtë mënyrë ajo u habit me naivitetin tim. Po të ishte që këpucët e duronin ujin atëherë ato do të quheshin çizme! tha ajo me ironi. Epo mirë, thashë unë, le të rrinë aty derisa të kalben se unë nuk i vë më në këmbë sikur prej argjendi të jenë.

Kaluan kështu afër një muaj e gjysmë dhe një ditë prej ditësh gruaja u kujtua përsëri përkëpucët e reja. Sikur t'i provoja edhe njëherë. Plagët qenë shëruar dhe ndihesha në përgjithësi mirë. I vesha këpucët me një mosbesim të hapur, ndonëse në fillim m'u duk sikur qenë hapur, sepse nuk po ndjeja ndonjë dhimbje. Dola në rrugë dhe gati harrova sa kisha vuajtur nga ato këpucë. Ecëm njëqind, dyqind metra dhe nuk po ndjeja më dhimbje. Po pikërisht kur gruaja po më thoshte se këpucët qenkan ndrequr dhe se më në fund shpëtuam, mua më filluan disa të therrura që nuk i kisha provuar herët e tjera. Er-

dhi një çast që nuk mund të ecja. Nisa të çaloj nga këmba e majtë. Këpuca e majtë ishte më aggressive. Me siguri që ajo kishte filluar rrjepjen e Këmbës. Gruaja kishte kohë që më mbante prej krahu për të zbutur sado pak dhimbjet e padurueshme që sa vini është shtoheshin. Kalimtarët ecnin pranë nesh dhe nuk donin t'ia dinin se këmbët e mia ishin nën sundimin e dy këpucëve prej... hekuri. Asnjëri prej tyre nuk merrte guximin të thoshte: të vrasin këpucët? Po. Atëherë hiqi menjëherë, këtu në mes të rrugës. Përse i mban kur të vrásin?! Por jo, në rrugë nuk mund të ecet këmbëzbathur, kështu që dëshira për të shpëtuar nga dhimbjet mbeti një èndërr e asaj nate dimri.

Të nesërmend shoku im i ngushtë më tha që t'i dërgoja këpucët në këpucari për t'i futur në një kallëp me numër më të madh. Edhe gruas i pëlqeu kjo zgjidhje kështu pa e zgjatur u nisëm bashkë me këpucët për te këpucaria e lagjes sonë. Po ecnim me një besim që tani e tutje nuk do të merrësim më më plagë dhe ilaqe popullore, bile po na vinte dhe paksa turp nga vetja se si nuk e dinim më parë këtë zgjidhje. Diku pranë këpucarisë se nga na mbiu një shoqe e punës së gruas. Pasi na pyeti dhe e pyetëm për të gjitha çështjet familjare, sikur kishim lënë takim pikërisht për këto probleme, dhe sikur në nuk ishim nisur për te këpucaria dhe ajo te dyqani i ushqimeve, asaj i bëri shumë përshtypje letra e bardhë ku dergjeshin këpucët e mia të reja ose më saktë armiket e mia.

— Oo! Paskeni blerë këpucë të reja. T'i gë-zoni! I grisshi me shëndet! — tha ajo duke respektuar një zakon.

— Çfarë shëndeti?! Ato po më vdesin, po më shkurtojnë jetën! — thashë unë pak me të qeshur dhe pak seriozisht. Kur ajo mori vesh se për se ishim nisur me këpucët në dorë heshti pak si për të marrë veten nga ndonjë lajm i kobshëm dhe tha:

— Po të më dëgjoni mua nuk duhet ta bëni këtë veprim. Unë dhe im shoq e kemi pësuar para disa vitesh nga kjo mënyrë e hapjes së këpucëve. Na thanë se duhet t'i linim këpucët dy ditë në një kallëp dhe ne pranuam. Kur i veshi burri ato nuk e vrishnin hiç sepse lëkura e këmbëve nuk e prekte fare lëkurën e këpucëve. Në ato këpucë mund të hynin dy këmbë njëherësh.

Kaq u desh që ne të kthehem prapa me këpucët e reja të mbështjella në letër dhe të mërzitur që nuk mundëm të bënim diçka për to. E pleqëruam edhe një herë me gruan fatin e këpucëve të reja, që dalëngadalë po bëheshin të vjetra, dhe më në fund vendosëm t'i shitnim. Nuk pas ka qenë e thënë që ato këpucët e reja të qëndronin në këmbët e mia. Fundja do të blinim një palë të tjera në dyqanin e këpucëve, nga ato të gatshmet. U duk sikur i dhamë rrugë problemit, po nuk ishte krejt ashtu. Kush do t'i blinte ato këpucë? Cili ishte ai njeri që kishte këmbë të përshtatshme për këto lloj këpucësh? Ato ishin këpucë unikale, nuk mund të shërbenin për këm-

bët e të tjerëve. Pastaj edhe ajo na duhej që t'a shitnim ndonjë klienti, — i cili edhe mund të gjenë po t'a shisnim me gjysmë çmimi, — që pas disa javësh të na vinte te porta e shtëpisë me paterica nga plagët e shkaktuara prej këpucëve. Pra këpucët e reja do të vjetëroheshin në shtëpinë time pa u përdorur.

Ia tregova si rastësisht një mikut tim të vjetër këtë histori dhe ai u habit se si unë nuk e dija se këpucët e reja hapen duke ecur me to në shi. Vishi në një ditë me shi, më shpjegoi ai, dhe do të shohësh se si do të zbutet lëkura, se si ato nuk do të vrasin fare. Nuk do ta kisha besuar në qoftë se nuk do të më kujtohej se edhe një tjetër më kishte propozuar që t'i fusja në ujë këpucët. Ah, jo, më tha miku im i vjetër. Ka një dallim midis lagies artificialisht me ujë dhe lagies me shi. Në rastin e parë këpucët mund të prishen dhe të mos hapen, ndërsa në rastin e dytë, domethënë kur vishen në shi, këpuca hapet sepse është në lëvizje etj. Nuk e zgjata shumë këtë diskutim me mikun tim sepse nuk ia vlente përderisa atë ditë nuk binte shi.

Kaluan ditë të tjera, kaluan edhe javë e muaj dhe asnëjë re nuk po dukej në horizont.

Po shiu më në fund erdhi me mjaft zhurmë e me erë. Tamam siç thotë një shprehje e njojur: djalli po zbret shkallët. Ishte ora katër e mëngjesit kur mora vesh rënien e shiut. Më zgjoi grua ja dhe unë kërceva nga shtrati menjëherë. Hapa dritaren dhe pasqë me kënaqësi që rrugët qenë

mbushur me pellgje uji. Pra ai shi nuk do të zbuloste vetëm tokën, nuk do të pastronte vetëm ajrin nga pluhuri disamujor, por dhe do të zbushte këpucët e mia të reja. Ato nuk do të më vritnin, ato do t'i vishja sa herë të më donte qejfi. Me këtë gjëzim u shtriva në krevat duke pritur me ëndje zbardhjen e ditës. Po pas pak gruaja më ngriti mendjen duke më thënë: sikur të pushonte shiu dhe toka deri në orën gjashtë e gjysmë, kur unë shkoja në punë, të thithë krejt ujin, atëherë si do t'i zbusja lëkurën e këpucëve? Nuk duhej humbur ky rast. Ndërkaq më mirë do të ishte, vazhdoi gruaja, që të dilja qysh herët në mëngjes se pse do të kisha mundësi të ecja më shumë bashkë me këpucët e mia. Kështu u ngrita përsëri nga krevati; u vesha dhe dola drejt e në rrugët pa njerez e të ndriçuara nga neonet. Ishte hera e parë që po dilja në rrugë për të shëtitur këpucët. Pak e çuditshme, por dhe e domosdoshme për funksionimin normal të këpucëve. I durova me një lloj përkushtimi dhimbjet e njoitura të këpucëve, ndërsa ecja në drejtime të papërcaktuara. Pothuaj gjithë qyteti flinte. Rrugët e shkretuara dhe, në përgjithësi, qetësia kolektive i jepnin veprimit tim një pamje ceremoniale të veçantë. Përpinqesha të zgjidhja ato vende ku pellgjet ishin më të bollshme në mënyrë që uji të përfshinte sa më shumë nga lëkura e këpucëve. Me një fjalë si fëmijët e vegjël të cilët duan me çdo kusht t'i lagin sa më shumë këpucët dhe rrobat. Megjithëse dhimbjet sa vinin e shtoheshin unë vetëm ecja e ecja dhe shi-

koja me kënaqësi se si këpucët e mia të reja çanin ujin e shumëpritur.

Pasi kisha shëtitur ndonja gjysmë ore në një kthesë vura re se dikush po më ndiqte. Të them të drejtën u frika disi. Prandaj i harrova dhe këpucët dhe dhimbjet. Ç'të jetë ky njeri që po më ndjek?! Kjo pyetje endej brenda meje plot shqetësim, dhe nuk po i jepja asnje përgjigje. I vetmi reagim imi ishte shpejtimi i hapave, por dhe ndjekësi nuk e kishte të vështirë të bënte të njëjtën gjë. Më në fund vendosa të ndalem për të parë se cili ishte ai njeri që po më ndiqte. Ishte një polic. Ai eci drejt meje dhe nisi të flasë:

— Mirmëngjes! Më falni mos ju ka humbur ndonjë gjë.

— Jo, nuk më ka humbur asgjë, po... po shëtis ashtu kot. U mërzita në shtëpi dhe dola, a më kupton? — fola unë i druajtur pa ditur në fakt se çfarë do të thosha.

— Në rregull, — tha polici, — mendova se mos kërkonit diçka të humbur, sepse keni rreth treçerek ore që bëni të njëjtën rrugë. Mirupafshim!

Epo, thashë me vete, edhe kjo më duhej, të përfundoja në polici kot së koti. Kush të beson se po shëtisja për të zbutur lëkurën e këpucëve. Bile mund të merrej si një fakt i dyshimit. Sapo u largua polici ndjeva dhimbjet karakteristike të këmbëve dhe ujin që qe futur brenda këpucëve të mia të reja. U ktheva në shtëpi dhe veç plagëve të zakonshme m'u desh të qëndroja në shtë-

pi dhe nga një ftohje e lehtë për shkak të lagështirës.

Qysh nga ajo ditë nuk i kisha provuar më këpucët e reja. Dhe ja tani Sandri, im vëlla, ka guxuar të provojë forcën e këpucëve të mia. U dëgjuan hapa në korridor dhe ai po vinte i qetë, të paktën nuk po ankohej, siç bëja unë kur hyja në shtëpi nga shëtitjet me këpucët e reja. U ngrita për të parë Sandrin. Pas meje vinte dhe gruaja. Sandri ishte duke hequr pardesynë dhe këmbët i kish në rregull, sepse po t'i vrissnin këpucët nuk do t'i binte ndërmend se ka veshur një pardesy.

— Mirëmbërëma! Ç'ka ndodhur që keni dalë të më prisni kolektivisht, — foli ai i shkujdesur.

— Asgjë, — i thashë unë duke e parë nga këmbët; ashtu si dhe gruaja. — Mirë je me shëndet.

— Shumë mirë jam — u përgjigj ai disi i habitur. — Pse morët vesh se jam sëmurë?

— Jo. Po ishe larg?

— Deri në punë dhe pastaj bëra pesë-gjashëtë xhiro në bulevard.

— Pesë-gjashtë xhiro?! — u hodh gruaja e çuditur. — Me makinë?

— Jo me aeroplan! Me këmbë bëhen shëtitjet, jo me makinë. Se si qenkeni sonte ju të dy. Nuk po ju marr vesh fare.

— Ore Sandri, si ka mundësi që nuk të kanë vrarë këpucët e mia të reja?

— Ah! Harrova se kam veshur këpucët e

tua. Nuk i gjeta të miat. Jo, nuk më vranë, bile një shok m'i pëlqeu shumë. Shumë të rehatshme janë.

— Të rehatshme! — gati sa nuk bërtiti gruaja.

— Atëherë me siguri duhet të kesh veshur çorape metalike — thashë unë për të zbutur disi atmosferën.

Bashkë me Sandrin qesha dhe unë pak, duke menduar se përse nuk e kanë vrarë këpucët atë. Dy variante janë: ose Sandri ka një këmbë të veçantë, ose shiu atë mëngjes i ka zbutur këpucët e mia të reja. Duhej vërtetuar hipoteza e dytë.

SIKUR TË MOS ISHA ULUR

Hyra me nxitim në vagonin tim të zakonshëm dhe, për çudi, atë ditë ai ishte pothuaj bosh. Zura vend, nxora nga çanta një libër dhe fillova të lexoja me ëndje. Por pas disa minutash kuptova se nuk duhej të isha ulur, nuk duhej të kisha vepruar kundër zakonit tim të përhershëm për ta kapur trenin në sekondat e fundit, kështu që atë ditë gjatë gjithë udhëtimit i thashë vetes «sikur të mos isha ulur».

Sapo kisha lexuar dy-tri faqe nga një libër me tregime dhe përballë meje vjen e ulet një burrë rrëth të dyzetave.

— Patjetër që ju e pini shumë duhanin, — filloi të fliste ai me një zë autoritar e të kumbueshëm, duke më zgjatur pranë hundëve paketën. — E marr me mend, — vazhdoi ai me bind-

jen e njerëzve që hiqen kompetentë, — që ju po vrisni mendjen nga e kuptova se e pini me hundë. E qartë! Jo nga paketa që shihet në xhepin e këmishës suaj, jo, i dashur bashkudhëtar. Për konkluzionet e mia unë asnijëherë nuk nisem nga gjëra apo elementë të jashtëm, që shihen nga ku-shdo, sepse konkluzioni atëherë do të quhej empirik a mediokër. Dhe unë për këto lloj konkluzionesh kam neveri gjer në urejtje. Sapo ju pa-shë nga larg e kuptova se ju pini shumë duhan. Jam njeri me intuitë të thellë. Këtë e pranon edhe Zana, gruaja ime, veç se ajo e ekzagjeron kur thotë se intuita ime është fenomenale. Unë e kundërshtoj duke i shpjeguar se intuita ime është krejt e zakonshme, domethënë e lindur dhe jo e fituar... A mos doni një cigare? Pse nuk merrni? Ju mund të habiteni se unë kam njëzet e një vjet e shtatë muaj që pi vetëm nga ky lloj. Janë shumë të mira... Nuk keni asnijë arsyë të ngri-heni. Ajo gruaja e moshuar mund të ulet më tej. Treni ka vende plot. Jo, faleminderit! Unë pi vetëm nga ky lloj duhani. Interesant, shpeshherë kam dëshirë të kujtoj si e nisa cigaren. I fshihja në xhepin e majtë të xhaketës blu. Ishte copë e mirë. Qind për qind lesh. Tri herë e ktheva dhe dukej si e re. Vangjeli, rrobaqepësi, ishte usta e shkuar ustait. Herën e parë më mori pesëqind lë-kë, të dytën treqind dhe të tretën asnijë lek. Kam respekt, më thoshte, i shkreti Vangjel, për ata që dinë t'i ruajnë rrobat. Por ç'e do, nuk i ecin mbarë fëmijët në shkollë. Në fakt Astriti, djali i madh,

ishte inteligjent, po dembel i madh. Pastaj edhe Qamili, mësuesi i matematikës, e kishte inat. Nuk do ta besoja, por e provova te djali im, Arbeni. Beni i thérresim pér shkurt. E kam të shkathët djalin. Në këtë drejtim i ka ngjarë Zanës. Ndërsa pér zgjuarsi Kadriut, gjyshit tim. Gjysh Kadriu ka qenë burrë i urtë e mendjemprehtë dhe më done shumë mua, pérherë më blinte kallama sheqeri. Kjo është arsyje që gjashtë dhëmbë e dhëmballë i kam të vëna. Ja, mund t'i shohësh, e shtata poshtë, majtas, treshi sipër, djathtas, katra... Doni ta hapim dritaren? Ju pérzihet? Jo. Shumë mirë. Doni të freskoheni? Mirë. Jeta pa ajër të pastër në tren nuk ka kuptim. Nuk e di se cili shkrimtar i madh e ka thënë këtë. Më duket se Shekspiri. Ah, po, e kuptoj! E di, në kohën e Shekspirit, nuk ka pasur hekurudha. Ishte e natyrshme që të mos kishte as trena. Kjo është logjike. Por unë jam i sigurt se atë shprehje e ka thënë Shekspiri, veçse jo pér trenin, po pér karrocat e postës. Po, po. Jeta pa aiër të pastër as në karrocë nuk ka kuptim. Interesant, ai e ka thënë pér karrocat dhe pas pesëqind e ca vjetësh ajo shprehje gjen zbatim edhe në ditët tona. Jo vetëm shkrimtar i madh, por dhe filozof. Gjeni, s'ke c'i thua. U qetësuat? Shumë mirë! Ndizeni një nga të miat. Nuk të jep kollë. Prandaj dhe pi vetëm nga ky lloj. Ju nuk mund ta merrni me mend se cfarë presionesh kam përballuar pér të mos nisur duhanin. Gjyshi më thoshte «lëprij kallama më mirë, mor bir, sesa të thithësh helm». Babai, Hakiu, fliste

me orë të tëra për dobinë e madhe të karamaleve. Ndërsa 'nëna, Ganimetja, dhjetë ditë me radhë më bëri petulla. E shkreta, kujtonte se njëzet petullat do të më detyronin të hiqja dorë nga njëzet cigaret. Kur një mëngjes ajo i pa petullat në ko-shin e plehrave të pallatit tonë, hoqi dorë nga ky presion. Ndërsa unë vazhdova të pija cigare duke u treguar të gjithëve se kam qenë, jam e do të mbetem njeri me vullnet, se unë... se mua, po i vura vetes një qëllim, nuk ka pengesë që të më thyejë. I dhashë fjalën vetes dhe e mbajta, se ai që nuk respekton veten, nuk respekton dhe famili, komshinjtë, shokët... Bile mbaj mend se atëherë ra dhe shumë shi, njëzet e tri ditë rresht. Xhaxhai, bashkë me dajën e nënës, shkuant vullnetarë në një zonë që ishte përmbytur. Të dy u kthyen me fletë lavdërimi. Janë punëtorë të më-dhenj. E, kur mendon se u bënë shtatëdhjetë ditë pa rënë asnjë pikë shi dhe bujqësia ka nevojë përtë sa s'thuhet, të vjen inat që ai shi ra në gjashtë-dhjetepesën dhe jo tani. Natyrisht, gjë që s'bëhet. Natyra ka ligje të hekurta. Po, dëshira bën çudira. Ore, se fjalë nxjerr fjalën, si shpjegohet që bie më shumë shi në dimër sesa në verë? Në fakt kë-të probleme kam diskutuar dhe me Zanën. Dy ditë u konsultuam me njëri-tjetrin dhe vendosëm përsiguri t'i bënim një letër revistës «Shkenca dhe jeta». Letrën e nënshkruam me pseudonim. Zana ishte e këtij mendimi dhe unë e miratova me njëherë. Shkojmë shumë mirë me njëri-tjetrin, në harmoni, si i thonë. Një herë qollova në dyqanin

e metrazheve kur apo kishte dalë një copë e mirë për kostum. Para kisha me vete, po nuk mund ta merrja copën pa pyetur Zanën. Vajta në shtëpi, u konsultuam dhe, me të thënë ajo po, vrapova në dyqan, po copa ishte mbaruar. Nuk u mërzita fare. Ka rëndësi të madhe familja, harmonia. Doni të hapni dritaren? Ju përzihet? Po. Shumë keq! E çuditshme! Çfarë koincidencash. Ka disa muaj që udhëtoj me njerëz që i zë treni. U qetësuat? Po? Shumë mirë! Në mos gabohem, ju ishit duke lexuar Çehovin. Jam skandalizuar kur dëgjova një ditë që ky shkrimtar i dëgjuar paskësh jetuar i ndarë me të shoqen. Të më besosh, i fola rëndë atij që ma tha këtë fakt. Ç't'i bësh, mungesë kulture, erudicioni. Ju mund të mendoni se kam mbaruar për letërsi. Jo, po më pëlqen shumë letërsia. Çehovin e kam lexuar para tre muajve, pikërisht kur mësova thashethemin e mësipërm.

Ou! Paskemi arritur në Durrës. Me muhabet nuk ndihet fare rruga. Ja dhe konduktorët. Po bëhen tridhjetë e ca vjet dhe kështu i mbaj mend të veshura këto, me të njëjtën ngjyrë, me të njëtin model. Mungon fantazia? Do të ishte bukur dhe me vlera praktike që konduktoret e linjës Shkodër-Vlorë të visheshin me uniformë ngjyrë lila dhe ato të linjës Tiranë-Pogradec me një ngjyrë tulle. Kjo jo vetëm do t'i bënte më interesante vetë konduktoret, po dhe do të krijonte një thyerje estetike në stacionet e trenit. Udhëtarët do ta kishin më të lehtë për të dalluar se cili është treni i Shkodrës dhe cili i Pogradecit. E kuptoj se

çfarë doni të thoni, po më duket se trenat nuk mund t'i lyejmë me ngjyra të ndryshme. Nuk është serioze. Pastaj, është dhe antiekonomike. Doni ta hapni përsëri dritaren? Po! Mos lëvizni, jua hap unë. Me sa duket nuk jeni mësuar të udhëtoni me tren. Ju qenkeni njëlloj si Teuta, kunata ime, së cilës, po të udhëtojë pesëdhjetë metra, i përzihet. Është vizituar te mjekët dhe ata i kanë thënë se duhet ta shmangë udhëtimin e gjatë. Interesant. A mund t'i thuhet njeriut të mos udhëtojë? A do të punojë ky njeri? A do të shkojë në plazh për pushime? Udhëtimet para së gjithash janë kulturë. Po hajde mbushua mendjen mjekëve. Në vend aë të vrasin mendjen se cfarë ilaci duhet për të shëruar, i bien shkurt. Nuk u mjaf-tojnë dietat ushqimore, po japid edhe dieta transporti, ose më saktë kuota transporti. U qetësuat? Mos lëvizni, se e mbyll unë dritaren. Edhe për të mbyllur dritaret duhet pakëz përvojë. Kam dhjetë vjet që e bëj rregullisht këtë rrugë dhe kuptohet se më ka rastisur shpesh të merrem me dritaret e trenave. Ky tren nuk është dhe aq keq nga pikëpamja e dritareve. Xheviti, përgjegjësi i trenit, është i rreptë, kërkon llogari deri në një. Por është një tren tjetër që i ka dritaret shumë defektoze. Mirë se dritaret nuk prishin ndonjë punë të madhe, po. -. e dini, kjo fushë ka vite që mbillet me luledielli. Habitëm me drejtuesit e kësaj ekonomie bujqësore që nuk e kuptojnë se kjo tokë është shumë e përshtatshme për misër. E kuptoj se ç'doni të thoni. Po më mirë le të presim sa të ka-

lojmë Fierin, që të të tregoj një shembull më flagrant...

Po, ashtu është, biletën e kam deri në Rrogozhinë, po, meqenëse po më hahet muhabeti me këtë shokun, po shkoj deri në Vlorë. Kthehem prapë, po me këtë tren... Nuk më pëlqen të udhëtoj vetëm, bile trishtohem kur shikoj dhe të tjerët që udhëtojnë vetëm... S'të lënë dhe konduktoret rehat... Përsëri doni ta hapni dritaren? Ju përzihet?...

Unë zbrita në atë stacion. Dhe prita trenin tjetër.

SEZONI I FEJESËS

Nuk jam supersticioz, po më duhet ta pranoj, me shumë keqardhje, se jam një njeri krejt pa fat. Nuk ka si shpjegohet ndryshe, sepse kam mbi tre vjet që dua të fejohem dhe nuk po mundem. Ndokush mund të rrudhë buzët dhe të thotë: kaq e vështirë të jetë, kur rrugët janë plot me vajza, shkollat gjithashtu. E po nuk qenka i zoti, vë pikën ai. E çuditshme! Çfarë njerëzish ka në këtë botë!

Kështu duken gjërat nga larg, të thjeshta dhe të lehta, sidomos kur është fjala për të tjerët. Të gjithë bëhen trima pas betejës dhe profesorë kur japid këshilla. Në të vërtetë edhe unë pak a shumë kështu mendoja para katër-pesë vjetësh. Të mbaroj njëherë shkollën, t'ia marr dorën punës, të jap edhe provimet pasuniversitare, të mbroj

disertacionin, pastaj, mendova me naivitet, vjen fejesa, që, për mua, ishte çështje javësh, shumë-shumë muajsh. E kush nuk do të më pëlqente mua! «Mjafton një shëtitje nëpër bulevard dhe gjithçka do të marrë fund.»

Po për fatin tim të keq doli se nuk isha unë i vetmi në botë që shëtitja nëpër shëtitore. Vajzat nuk më prisnin te porta e shtëpisë sime. Mëdje, për fat të keq, pas njëzet vjetësh vura re se lagjja ime ishte nga më të varfrat e qytetit me vajza të mira. Pa folur se pallati im qe mbushur i téri me djem e burra. Krejt pa fat! Por ajo që më tronditi më shumë ishte se edhe ndërmarrja ime kishte pothuaj vetëm burra, djem dhe gra të martuara. Vetëm pas dhjetë vjetësh do ta merrja vesh këtë statistikë që qe e dhimbshme përmua.

Familja, kur pa që më në fund po kërkoja të fejohesha, nisi nga rekomandimet. Mirëpo, kuptohet, unë nuk mund të pranoja që fati im të përcaktohej nga të tjerët.

Si fillim u përpoqa të sillja ndër mend të gjitha vajzat që kisha njohur në gjimnaz e në fakultet. Veçova tri prej tyre dhe vendosa t'i kërkoja. Natyrishët nuk doja të bija në sy si ata adoleshentët që ndjekin në mënyrë demonstrative vajzat në shëtitore. Tani isha djalë i pjekur. Pra, duke respektuar vetveten, u nisa një ditë për të vëzhuar disi nga larg variantin e parë. Rrugës m'u kujtua se si ajo ulej me shumë kënaqësi në një bankë me mua, më buzëqeshte dhe nganjëherë më

ngacmonëte. Ajo me siguri do të ketë pasur ndonjë qëllim, por atëherë nuk mund ta parashikoja fatin tim të tanishëm. Kur ajo u shfaq fare pranë meje, unë u drodha i tëri. Ajo prej vitesh qe bërë nënë e dy fëmijve. Kjo qe e mjaftueshme që të hiqja dorë përfundimisht dhe nga dy variantet e tjera. Se mos ato më kanë pritur mua!

I trishtuar disi nga dështimi i parë, vendosa t'u nënshtrohesha ligjeve të rastësisë. Lidhja ime me shoqen e ardhshme të jetës duhej të ishte sa më e natyrshme. Prandaj vendosa të dilja çdo pastite në shëtitje në ato rrugë ku dilnin më shumë vajza. Që në javën e parë përjetova çaste emocionuese kur hasa vështrimin e një vajze të mrekullueshme. Ajo sikur kishte dalë nga ëndrrat e mia më të guximshme. Për një kohë të shkurtër i mësova të gjitha lëvizjet e saj dhe nisa ta vëzhgoja. Nga dita në ditë më shtohej dëshira për ta njohur nga afër. Çdo mëngjes zgjohesha me portretin e saj dhe sillja nëpër mend mënyrën se si ecte, se si buzëqeshte etj. Pikërisht në një prej këtyre mëngjeseve vendosa ta ndaloja, nuk kisha përsë të prisja. Dola për ta mbaruar shpejt e shpejt këtë punë. Arrita te vendi ku kalonte zakonisht dhe prita afër një orë, por ajo nuk erdhi. Natyrisht me mua nuk e kishte, sepse nuk e dinte se unë e prisja. Kushedi pse atë ditë nuk kaloi nga rruga e saj e përditshme. E po, mendova me vete, edhe këtu të më ndjekë tersi. Megjithatë të nesërmen ajo erdhi, domethënë po vinte në rrugën e saj

të zakonshme. Unë i dola përparrë dhe i fola diçka që as vetë nuk e dëgjova. Ajo ndali pak hapat, më pa tejet e habitur, rrudhi buzët me një mospërfisillje të hapur dhe me një zë të qartë e të prerë tha: «Dukesh dhe me kulturë pale!» Pastaj u kthyë me vrull dhe iku me një hap të nxituar. Unë mbe-ta gati pa frymë, në mes të rrugës. Edhe tani nuk e marr me mend pse ajo vajzë u largua në atë-mënyrë. Unë vërtet nuk e mbaj mend se çfarë tamam-tamam i thashë asaj, po jam i bindur se asnë fjalë fyeze nuk kam përdorur. A mos, përfatim tim të keq, ajo i ka dëgjuar gabim fjalët e mia?

Disa javë nuk mendova asgjë rreth vajzave e fejesës sime. Nuk doja t'i futja vetes siklete që më prishnin humorin tim dhe të krejt familjes. Madje, një miku im i vjetër më tronditi kur, pasi më pyeti nëse isha fejuar, më tha:

— Ti kujton se unë bashkë me njerëzit e tjerë shqetësohem që ti nuk je fejuar ende?! Të paktën unë, — vazhdoi ai, — të pyes gjithmonë kur jam bosh e nuk di se çfarë të të them, njëlloj si ata njerëzit që, kur nuk kanë ç'të thonë, nisin e flasin përmotin.

Pas asaj dite vendosa të merresha energjisht me gjetjen e bashkëshortes sime. Po, po termi bashkëshort i shkonte më shumë odisësë sime. Që njojja të ishte sa më e rastit dhe interesante, duhej që diçka të më lidhte me të panjohurën. Përkëtë arsyen mendova se më e përshtatshme do të ishte që të frekuentoja kinematë, madje jo ve-

tëm pasditeve, po dhe paraditeve, sepse mbajë mend, ose më saktë m'u kujtua krejt papritur, se, kur isha gjimnazist, dhe më vonë student, shkoni në rëndom, bashkë me shoqet e shokët e klasës, nëpër kinema. Kështu çdo të martë vrapoja te reklamat dhe bëja me mend një grafik, të cilin ë zbatoja me përpikmëri.

Sapo blija biletën shpresoja që pranë meje të ulej, ashtu rastësisht, një vajzë e mirë, e bukur, simpatike etj. Përfytyroja si do ta vështroja pakëz me mospërfillje në fillim, pastaj do ta pyesja, gjoja shkarazi, për ndonjë gjë krejt të kottë, bie fjala për orën dhe se si ajo do të përgjigjet e unë do të buzëqeshja lehtë, në formë falenderimi e kështu me radhë. Po për dy muaj rrësht mua nuk m'u realizua asnjëra prej këtyre dëshirave. Vajzat të gjitha sikur e kishin bërë me fjalë të më bojkotonin pikërisht vetëm mua, sepse të tjerëve shikoja që u uleshin në krah lloj-lloj vajzash. Ndërsa mua shorti më sillte në krah herë ushtarë, herë djem harrakatë, nga ata që hyjnë në kinema vetëm për të prishur qetësinë, herë pensionistë, familjarë, fëmijë etj. Megjithse më ndodhë përherë kështu, nuk e di pse vazhdoja të kisha shpresë. Mbështetëse para se të hyja në kinema shikoja vajza simpatike... I lodhur nga shansi, vendosa të bëhesha i guximshëm. Ndaj një natë u ula pranë disa vajzave, në kundërshtim me fatin tim, domethënë jo sipas radhës dhe karriges së shënuar në biletë. Personi që kishte vendin erdhi disa minuta pasi kishte filluar filmi,

dhe, kur pa se vendi i tij qe zënë, nisi të bërtiste. Një grua e personelit erdhi thuajse me vrap dhe, pasi vuri re se unë isha fajtor, më urdhëroi të dilja përjashta. Unë nuk fola dhe dola me kokën ulur, ndërsa njerëzit thërritnin: Jashtë! Jaaashtë! Nuk ka turp, goxha djalë! etj. etj. Veshët më buçitnin dhe kur dola në rrugë.

Ja kështu u largova përgjithmonë nga kine-matë, duke u betuar se këtë fyterje do ta paguan-te ajo, vetëm ajo, gruaja ime e ardhshme, që fshihej qosheve.

Një mbrëmje mbaj mend se motra më erdhi e shqetësuar në dhomë, sepse mamaja ishte e shqetësuar nga pamja ime. «Shtriga, — kishte shfryrë ajo, — po ma lodi djalin në mënyrë të tmerrshme, të pacipë!». Unë shtanga. M'u duk shumë e çuditshme se si mund të sulmohej kësh-tu një njeri që nuk dihej se kush ishte. Ndërsa motra, nga ana e saj, u përpooq të më ngushëllonte, duke thënë se ka plot vajza të tjera, shumë më të bukura se ajo shtriga e poshtër! Pra ata mendonin se unë duhej të isha ndarë! U habita se si mund të ndahet njeriu pa u bashkuar një he-rë. Ula kokën dhe gati e besova se vërtet unë isha ndarë me dikë, po se me cilën, nuk e dija. Pjesë-tarët e familjes nuk mund ta merrnin me mend se shkoja i vetëm në kinema. Ata besonin se shko-

ja me një vajzë. Po këtu qëndronte keqkuptimi, të cilin unë nuk mund ta ndreqja. Në shumë raste enigmat janë më interesante sesa të vërtetat. M'u kujtuan disa shokë në fakultet që mbaheshin se kishin sukses me vajzat, por asnjëherë nuk tregonin se me cilat konkretisht. Atë mbrëmje, me heshtjen time, edhe unë këtë pozë mora, që në sytë e motrës u shndërrua në simbolin e një ndarjeje shumë të trishtuar. Motra m'u afrua pranë dhe me një zë të brishtë më tha se kishte blerë dy bileta për në një koncert simfënik. Unë e pranova ftesën e saj pa asnjë pikë dëshire, sepse ende më rrinte para syve ndarja me gruan e shërbimit të kinemasë. Pastaj isha më se i bindur se në krahun tim do të ulej një mashkull. Dhe vërtet, ai nuk vonoi dhe erdhi e u ul pranë meje. Nuk e ktheva kokën për ta parë. Po atë çast pranë motrës sime u ul një vajzë. Nuk kishte si të ndodhë ndryshe. E hoqa mendjen prej saj dhe nisa të shihja përqark. Salla qe mbushur plot me njerëz. M'u krijua përshtypja se më shumë qenë vajza, por ato, si gjithmonë, qenë ulur larg meje. Sidqoftë mendova se nuk do të ishte keq që herë pas here të viaj këtu. Mbase fati im këtu ndodhej. Koncerti, sipas motrës, korri shumë sukses, por unë nuk e mora vesh, sepse gjatë gjithë kohës përfytyroja vendin ku do të njiheshë më atë, me atë... Fundja dhe unë nuk dola pa gjë nga ai koncert.

Dhe ja, pas dy-tri ditësh u ndodha në po atë sallë. U ulë në një qoshe krejt i vetmuar. Njeriu

më i afërt ishte rreth 15 metra larg. Edhe muzika që u luajt atë mbrëmje që shumë e trishtuar, si të donte të shprehet gjendjen time shpirtërore. Kaloi pak kohë dhe unë nisa të dëgjoja muzikën dhe gati harrova qëllimin kryesor të ardhjes në këtë koncert. Kur mbaroi shfaqja, m'u kujtua gjithçka dhe e ndjeva veten të zhgënjiyer. Duke dalë prej koncertit, se nga mbinë një mizéri me vajza një zot e di! Pra ia vlentë që të vije këtu rregullisht, sepse nuk i dihej, mbase mund të më buzëqeshte fati.

Po nuk ndodhi asgjë që të mund të mendojat sadopak se fati do të më shfaqejet diku atje, midis karrigeve. Pak a shumë i njëjtë fat, si në kinema, vecse në sallën e koncerteve vinin pothuat të njëjtët shikues, një pjësë e të cilëve qenë prindër, të afërm të artistëve. Nuk më harrohet një mbrëmje, kur m'u afrua një mesoburrë dhe më pyeti me shumë seriozitet:

— Ju, kë keni këtu, se ju shoh shpesh?!

Unë hapa sytë.

— Jo, mor shok, nuk kám njeri këtu. Unë kam ardhur të ndjek shfaqjen.

— E! Më fal, mendova sé mos ke të fejuarën në orkestër. Unë kam gruan në balet dhe jam i detyruar tri-katër herë në javë të vij këtu. Torturë! I di përmendsh të gjitha lëvizjet e baletit të aktit të fundit.

Ai vazhdoi të fliste dhe një copë herë, si e sita hiqte vëmendjen nga baleti, ndërsa unë dridhesha nga inati që kisha rënë kaq shumë në sy,

sa më kishin martuar me dikë në orkestër. . . Ndaj,
pa mbaruar ende shfaqja, u ngrita.

Pranvera kishte kaluar dhe po hynte vera e
nxehjtë. Nuk e mbaje mend se në çfarë romani
kisha lexuar për një dashuri të fuqishme në plazh.
Përse të mos e provoja edhe unë një herë. Ju nuk
mund ta besoni që s'kam lënë plazh pa bredhur.
Kam hedhur një mal me para në detin Adriatik
dhe në detin Jon! Unë nuk e kam pasur shumë
qejf detin, po halli të çon në fund të botës dhe jo
më në breg të detit.

Kuptohet që si fillim vajta në Durrës. Mora,
pas shumë përpjekjesh, një fletë kampi dhe u ni-
sa plot shpresë, si ata eksploruesit e vendeve të
panjohura. E ndieja diku thellë se nuk do të kthe-
hesha bosh. Këtë gjë e pashë edhe në sytë e pri-
ndërve dhe të motrës.

Dita e parë e plazhit nisi me një shi të rrë-
mbyeshëm. Nëndrejtori i kampit me të drejtë po-
hoi se kjo ndërresë duhej të kishte pasur ndonjë
këmbëters, sepse nuk kishte si shpjegohej që pas
tre muajsh thatësirë të binte shi pikërisht ditën
e parë të pesëmbëdhjetëdëshit të dytë të korri-
kut. Unë nuk fola, sepse me siguri do të tradhтоja
veten, dhe të gjithë do ta kuptionin se isha unë, ai
këmbëtersi!

Kjo gjë u vërtetua dhe kur u ndanë tryezat

në sallën e ngrënies. Mua më takoi me një çift pensionistësh, diku nga fundi, ku një shtyllë betoni ma pengonte pamjen plotësisht. Megjithatë, nëse tërhiqesha disi prapa, mund të shikoja se, disa metra më tutje, katër vajza hanin bashkë në një tryezë. Vendosa t'i nënshtrohesha fatit, se ndryshe ai nuk të vjen. Pra duhej t'u përshtatesha këtyre rr Ethanave në mënyrë që të përfitoja prej tyre. Në të vërtetë asnijëherë këtë vit nuk kisha qenë kaq pranë një grapi vajzash simpatike, prandaj e qetësova pak veten. Pas dy-tre ditësh ndjeva me kënaqësi se njëra prej tyre ishte vërtet e mirë. Pra më të duhej afruar. Mirëpo, si më ngatërohen mua gjërat, edhe këtë radhë më ndodhi diçka vërtet e çuditshme. Dhjetë ditë rreshth unë nuk munda ta shihja tërë ditën e ditës, as në breg të detit, as te trampolina. I mërzitur dilja bregut të detit për ta kërkuar në grumbullin e madh të njerëzve që shëtitnin dhe luanin me top. Ndonjëherë, për variacion, ecja mes për mes rërës dhe çadraive se mos rastësisht gjeja atë. Por ajo nuk dukej gjëkundi. Kur vinte dreka apo darka, atëherë po, ajo ulej në tryezë duke më kthyer shpinën. Nuk doja ta besoja se e bënte me qëllim, po gjithsesi qëndrimi i saj ishte krejt i papërshtatshëm për synimet e mia. Prandaj, në ditët e fundit, prita që ajo të vinte në tryezën e saj dhe unë do të bëja diçka që ta detyronte të kthente kokën e që të merrte vesh se ekzistoja. Nuk kishte rrugë tjetër. Kur ù sigurova që ajo ndodhej në mensë, me shumë kujdes shtyva broken e ujit me bërryl

dhe ajo ra e u thye me shumë zhurmë. Të gjithë kthyen kokat me alarm nga tryeza ime. Edhe ajo. E kapa menjëherë vështrimin e saj, po nuk ndjeva asgjë intime. Ajo më shikonte për herë të parë. Nuk e di, po pikërisht atë çast mendova se të gjitha që shkruhen nëpër libra, se ajo ose ai ranë në dashuri qysh në vështrimin e parë, janë përralla. Më lehtë është të urresh me shikimin e parë, sesa të dashurosh. Kjo ide m'u përforcua kur dëgjova njérën prej tyre të thoshte: Idioti! Na ngriu gjakun!

Megjithatë, unë u ngrita dhe nisa t'i mblidhja copat me shumë qetësi, po pas pak me nxitim erdhi, duke bërtitur, kamerierja. Nuk la gjë pa thënë kundër meje, si një njeri i pakujdeshëm dhe i parregullt. Sipas saj, s'ishte brokja e parë që thyhej në këtë sezoni plazhi. Unë nuk fola, po me shpejtësi u largova nga vendi i ngjarjes, sepse kisha rënë më tepër se sa duhej në sy. Pra edhe kësaj radhe nuk më eci, sepse në darkë vajza nuk tregoi ndonjë vëmendje për mua.

Ajo vazhdonte të ulej me shpinë nga tryeza ime. Se mos unë kisha bërë ndonjë heroizëm. Për fatin tim të keq këtë e kuptova me shumë vonësë, kur brokja që thyer, kur kisha paguar atë me dyfishin e çmimit dhe kur po mblidhja rrobat për t'u kthyer në shtëpi.

— Po hë, mor djalë, si ia kalove andej nga plazhi, — e nisi bisedën babai kur arrita në shtëpi. Unë e kuptova se ata prisnin që unë t'u thosha ndonjë gjë larg e larg, por unë, si me të qeshur,

u. tregova se ditën e parafundit kisha thyer një broke uji. Babai dhe nëna panë njëri-tjetrin të vrenjtur dhe me siguri menduan se djali i tyre ose nuk duhej të qe mirë nga trutë e kokës ose përsëri qe ndarë me ndonjë vajzë tjetër dhe brokja e thyer ishte me siguri simboli i saj. Prandaj nuk e zunë më me gojë plazhin, madje edhe kur e përmendte ndonjëri prej tyre, ashtu si rastësish, kafshonin buzën dhe bënин me shenjë që ajo bisedë të mos vazhdohej.

Megjithatë verën e ardhshme unë shkova përsëri në plazh. Kësaj here zgjodha Pogradecin. Para tre vjetësh një shoku im atje qe njohur dhe fejuar me një vajzë shumë të mirë. Por as ky udhëtim nuk më ndihmoi, megjithëse atje vërtet kish te shumë vajza. Po, si zakonisht, kur unë shfaqesh, ato zhdukeshin.

Kështu është kur nuk të ecën, kur je pa fat. Edhe sot e kësaj dite vazhdoj ta kërkoj rastin e natyrshëm për të gjetur bashkëshorten.